



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Masteri Shkencave në:
“E Drejtë Penale”
Kolegji Universitar “I Biznesit”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Jola BODE

Prof. Asoc. Dr. Ëngjëll LIKMETA

Shtator / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “I Biznesit”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Drejtësisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “E drejtë penale”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr. 651, datë 14.09.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MAS nr. 6, datë 06.01.2016
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 78, datë 27.10.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shatatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2022-2023– 5 PAE / 8 PAK Viti akademik 2023-2024– 4 PAE / 6 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2022-2023–10 studentë Viti akademik 2023-2024–7 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë Penale” është program i ciklit të dytë të studimeve i cili realizohet në 2 (dy) vite akademike me 120 ECTS. Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë Penale” është program në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë.

Ky program studim zhvillohet në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Politike si një nga njësitë kryesore në përbërje të Kolegjit Universitar i Biznesit (KUB). KUB është i licencuar me VKM nr. 651, datë 14.09.2011, “Për licencimin si Institucion i Arsimit të Lartë”. Me urdhërin nr. 3, datë 04.01.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës ka filluar aktivitetin mësimor për vitin akademik 2011-2012, fillimisht me emërtimin “Akademia Profesionale e Biznesit” me një përbërje prej dy fakultetesh. Me Urdhërin nr 39, datë 30.01.2018, është riorganizuar duke shtuar në përbërje edhe një njësi tjetër, Kolegjin e Studimeve të Larta Profesionale. Aktualisht KUB ka në përbërje të tij 3 (tre) njësi kryesore (fakultete), Fakultetin Ekonomik, Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Politike, si dhe Kolegjin e Studimeve të Larta Profesionale. KUB ka realizuar akreditimin institucional në vitin 2012 dhe më tej, akreditimet periodike në vitin 2017 dhe 2022. Me vendim nr. 3, datë 07.01.2022, “Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar i Biznesit” është akredituar institucionalisht për 4 vite akademike. Vlefshmëria e akreditimit është deri më datë 06.01.2026.

Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë Penale”, është një program studimi i cili ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Politike. Ky program është hapur me VKM nr. 651, datë 14.09.2011 “Për licencimin si institucion i arsimit të lartë mësimor 2011-2012”. Akreditimi i parë i këtij programi studimi është bërë me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 545, datë 13.11.2012. Ky program është riakreditua me 6 vite me VBA nr. 78, datë 27.10.2018 të Bordit të Akreditimit. Procesi i akreditimit që po zhvillohet ndaj këtij programi studimi është proces i akreditimit periodik të programit.

Ky program studimi ka kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike me kohë të plotë (4 semestra), në përfundim me sukses të të cilit studenti fiton 120 kredite. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë : Master i Shkencave në “E drejtë Penale”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi i studimit synon paisjen e studentëve me njohuritë themelore teorike, njohjen e thelluar të debateve dhe praktikave bashkëkohore ndërkombëtare si dhe eksperiencës shqiptare në fushën e të drejtës ndërkombëtare penale, kriminalistikës, kriminalogjisë, penalogjisë, dinamikave të krimit në kohën moderne, veprave penale në fushën e kibernetikës etj.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe standarteve shtetërore të cilësisë që referohen akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit që ata ofrojnë, KUBika kërkuar ASCAL, nisjen e procedurës të akreditimit periodik të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë Penale”.

ASCAL, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga KUB, për të realizuar vizitën në institucion dhe për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) ka në përbërje: **Prof. Asoc. Dr. Jola Bode** dhe **Prof. Asoc. Dr. Ëngjëll Likmeta**. Gjatë vizitës në institucion dhe procedurës lidhur me vlerësimin e jashtëm, ky grup pune u asistua nga përfaqëuesja e ASCAL Majlinda Demirmeli.

Faza e Procedurës së vlerësimit të jashtëm filloi me trajnimin e grupit të vlerësimit të jashtëm, shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni, ndarjen e punës, organizimin e vizitës në institucion si dhe hartimin e axhendës së takimeve.

Vizita në Kolegjin Universitar të Biznesit, u realizua në datën 26 dhe 27 Shkurt 2024. Në përputhje me axhendën e takimeve, GVJ, gjatë vizitës dy ditore realizoi takimet me: Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Politike, si dhe Përgjegjësen e Departamentit të Drejtësisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi, studentët, anëtarët e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zyrën e Burimeve Njerëzore, etj. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi gjithashtu vizita pranë Sekretarisë Mësimore, bibliotekës si dhe vëzhgoi në tërësi ambientet e zhvillimit të mësimin për këtë program studimit

Pas vizitës në IAL, pasi shqyrtoi në tërësi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm. Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve të institucionit për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë Penale” zhvilluar pranë Departamentit të Drejtësisë të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Politike të Kolegjit të Studimeve të Larta Profesionale. Raporti i Vlerësimit të Jashtëm bazohet në dokumentacionin e dosjes së vetvlerësimit depozituar nga institucioni, e aksesueshme në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e marrë gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara nga GVJ në institucion.

Kolegji Universitar “I Biznesit” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 16.07.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 81/12 Prot, datë 16.07.2024. Kolegji Universitar “I Biznesit” njofton më datë 22.07.2024, nëpërmjet shkresës me nr. 326, prot, datë 18.07.2024, “*Dërgohen komente mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm...*”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimii Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.78, datë 27.10.2018 është:

1. “Institucioni të shohë mundësinë e shtimit të lëndëve të fushës penale në vitin e parë të këtij program studimi”;

II. Plotësimi i rekomandimit nga Institucioni

Nga të dhënat e depozituar nga institucioni, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi ka realizuar ndërhyrje në kurrikulën e këtij programi duke shtuar në kurrikul lëndë të fushës penale në vitin e parë të studimit.

Në periudhën e akreditimit të parë të këtij programi, në vitin e parë të programit të Studimit MSC në “E drejtë penale” zhvilloheshin lëndët:

Metodat e kërkimit, Sistemet e Informacionit në menaxhim, E drejtë civile e krahasuar, E drejtë ndërkombëtare penale, E drejta dhe procedura administrative, E drejta bankare financiare, E drejta penale e avancuar dhe E drejta e konkurrencës.

Në përshtaje të rekomandimeve të Bordit të Akreditimit me ndryshimet që ka pësuar kurrikula e këtij programi në vitin e parë të këtij programi zhvillohen lëndët:

Metodat e kërkimit, E drejta penale e avancuar, Sistemet e Informacionit në menaxhim, E drejtë ndërkombëtare penale, E drejtë civile e krahasuar, E drejta dhe procedura administrative, Drejtësi penale për të mitur dhe kriminalistike.

GVJ konstaton se: Edhe pse ka një përmirësim të përmbajtjes së kurrikulës Master i Shkencave në “E drejtë Penale”, në raport me përmbajtjen në periudhën e akreditimit të mëparshëm, ende ka lëndë në kurrikulën e këtij programi të cilat nuk përshtaten me natyrën dhe fushën penale. GVJ e konsideron këtë rekomandim të **përbushur kryesisht**.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT.

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit (DVV) si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në E Drejtë Penale, ofruar nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike dhe Departamenti i Drejtësisë, në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit. Kolegji Universitar “I Biznesit”, ka në përbërjen e tij 3 (tre) njësi kryesore (fakultete), ndër të cilat Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike. Ky fakultet ofron gjashtë programe studimi. Këto programe studimi janë në përputhje me interesat kombëtarë dhe përputhje me nevojat e tregut të punës. <i>Evidenca nr. 13 “Rregullore e Programit të Studimit Msc në “E Drejtë Penale”</i> <i>Evidenca nr.5 “Statuti i Kolegjit Universitar të Biznesit”</i> <i>Evidenca nr.6 “Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026”</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” është hartuar në mbështetje të qëllimit dhe misionit të KUB dhe Fakultetit, të shprehura në Statutin e KUB. Kolegji Universitar “I Biznesit”, synon t’u japë studentëve një edukim cilësor të qëndrueshëm, për të konkuruar dhe punuar në një treg pune me standartet dhe eksperiencat më të përparuara në nivel kombëtar, rajonal dhe në nivel të Bashkimit Evropian, ku synon të shkojë shoqëria shqiptare. <i>Evidenca nr. 6 “Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026”</i> <i>Evidenca nr. 13 “Rregullore e Programit të Studimit Msc në “E Drejtë Penale”</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit	Në nenin 3 të Rregullores së programit të studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” theksohet se misioni i programit të studimit synon formimin e ekspertëve dhe specialistëve cilësorë si në aspektet teorike ashtu edhe në aftësishtë aplikative në fushën e të drejtës penale. Programi ka si qëllim të pajisë



dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	studentët me njohuritë themelore teorike, njohje e thelluar e debateve dhe praktikave bashkëkohore ndërkombëtare si dhe eksperiencës shqiptare në fushën e së drejtës ndërkombëtare penale, kriminalistikës dhe penalogjisë të drejtës financiare penale veprave penale në fushën e kibernetikës. Kjo veprimtari realizohet me anë të arsimit dhe kërkimit shkencor, në përputhje me Statutin e institucionit që qartëson se KUB ushtron veprimtarinë në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale. <i>Evidenca nr. 6 "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr. 13 "Rregullore e Programit të Studimit Msc në "E Drejtë Penale"</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	KUB me anë të programit të studimit ka për qëllim të përgatisë specialist për tregun e punës shqiptar dhe ndërkombëtar, të formojë shkencëtar të rinj, të realizojë kualifikime shkencore të stafit akademik, etj. Programi i studimit zhvillohet në përputhje me Strategjinë kombëtare të zhvillimit të Arsimit të lartë, e cila synon arsim të lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. <i>Evidenca nr. 6 "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se, KUB ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe synon të ruajë vlerat akademike kulturore kombëtare. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. Programi i studimit zhvillohet në përputhje me Strategjinë kombëtare të zhvillimit të Arsimit të lartë, e cila synon arsim të lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi																				
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit Master i Shkencave në E Drejtë Penale, ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë Shkencave Politike,i cili përbëhet nga tre njësi bazë:																				
	1. Departamenti i Drejtësisë;																				
	2. Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare;																				
	3. Departamenti i Shkencave Politike;																				
	FDSHPër vitin akademik 2023-2024 ka angazhuar gjithsej 32 staf akademik nga të cilët 21 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 11 staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikim:																				
	<table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Fakulteti i Drejtësisë Shkencave Politike</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>-</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.Asoc</td><td>2</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>14</td><td>7</td></tr><tr><td>Msc</td><td>5</td><td>3</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>21</td><td>11</td></tr></table>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Drejtësisë Shkencave Politike		PAE	PAK	Prof.Dr	-	1	Prof.Asoc	2	-	Dr/PhD	14	7	Msc	5	3	Gjithsej	21	11
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Drejtësisë Shkencave Politike																				
	PAE	PAK																			
Prof.Dr	-	1																			
Prof.Asoc	2	-																			
Dr/PhD	14	7																			
Msc	5	3																			
Gjithsej	21	11																			
	Ndërsa Departamenti i Drejtësisë si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit në vitin akademik 2023-2024 ka angazhuar gjithsej 13 staf akademik nga të cilët 7 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 6 staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikim:																				
	<table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Departamenti i Drejtësisë</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>-</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.Asoc</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>6</td><td>2</td></tr><tr><td>Msc</td><td>1</td><td>3</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>7</td><td>6</td></tr></table>	Kualifikimi i stafit	Departamenti i Drejtësisë		PAE	PAK	Prof.Dr	-	1	Prof.Asoc	-	-	Dr/PhD	6	2	Msc	1	3	Gjithsej	7	6
Kualifikimi i stafit	Departamenti i Drejtësisë																				
	PAE	PAK																			
Prof.Dr	-	1																			
Prof.Asoc	-	-																			
Dr/PhD	6	2																			
Msc	1	3																			
Gjithsej	7	6																			

	Gjykojmë që institucioni në rang institucional por edhe njësie kryesore / bazë, ka kapacitete të plota në fushën e burimeve njerëzore dhe akademike për ofrimin e këtij programi studimi. <i>Evidenca nr. 161 "Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB MSc. "Në E drejtë Penale" 1-10"</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale" ofrohet në një nga fushat e studimit akademik të njësisë kryesore dhe njësisë bazë (FDSHP& Departamenti i Drejtësisë). FDSHP (njësia kryesore) ofron programe studimi akademike dhe kërkimore në fushën e të drejtës, marrëdhënieve ndërkombëtare, diplomaci dhe studime evropiane. Fusha e përgjithshme e studimit dhe fushat specifike të këtij programi studimi janë në përputhje me fushën kryesore, në të cilën zhvillon aktivitetin akademik njësia bazë, pranë të cilit ofrohet dhe ky program studimi. Fusha bazë e studimit është fusha e drejtësisë dhe ajo specifike është në të drejtën penale. Ky program studimi klasifikohet në nivelin 7 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, sipas direktivave dhe udhëzimeve përkatëse kombëtare dhe evropiane. Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale" nuk është një program multidisiplinar. Ky program studimi ofrohet vetëm nga një njësi bazë (Departamenti i Drejtësisë). <i>Evidenca nr. 5 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr. 12 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i> <i>Evidenca nr. 13 "Rregullore e Programit të Studimit Msc në "E Drejtë Penale"</i> <i>Evidenca nr. 51 "Shkresa dërguar në MAS për kodifikimin e programeve të studimi"</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohe	N / A

nga institucionet partnere.				
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	KUB me përvojën e duhur akademike dhe kërkimore në fushën e arsimit të lartë, ofron në vijimësi mbështetje profesionale për stafin akademik në formën e trajnimeve apo dhe të auditoreve të hapura akademike. Pranë KUB është krijuar Instituti për Studime dhe Aplikime në Biznes (ISAB), që funksionon si një organizatë jofitimprurëse me statusin e një qendre studimore dhe trajnimesh. ISAB është licencuar nga Ministria e Financave (Bordi i Mbikqyrjes Publike të Profesioneve), dhe synon vazhdimësi trajnimi gjatë gjithë jetës, të specialistëve, ekspertëve dhe profesionistëve përmes, kurseve afatshkurtër për përditësimin e njohurive, të kapaciteteve dhe ekspertizës profesionale, përgatitjen e profesionistëve për dhënien e Provimeve nga strukturat e Ministrisë së Financave, për specialistët që kanë interes për të Fituar Tituj profesionale, “Kontabilist i Miratuar” ose “Auditues Ligjor”. <i>Evidenca nr. 76 “Program trajnimi ISAB SKK/SNK & Çertifikatë”</i> <i>Evidenca nr. 144 “Urdhër i Ministrit të Drejtësisë që autorizon KUB për realizimin e programit të detyrueshëm të trajnimit për Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme”</i> <i>Evidenca nr. 145 “Programi i trajnimi për Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme & Çertifikatë”</i> <i>Evidenca nr. 15 “Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës”</i>			
Konkluzione	<i>KUB ofron programe të studimit në ciklet përkatëse të studimeve, sikundër është dhe programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale”, mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë, si dhe në aktet e brendshme të organizimit dhe funksionimit të institucionit, duke synuar realizimin e misionit dhe qëllimeve në fushat përkatëse të studimit (statuti, rregullorja e përgjithshme dhe rregullorja përkatëse për këtë program studimi).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të

realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatese dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	KUB ka hartuar dhe miratuar aktet e brendshme për mbarëvajtjen dhe funksionimin e njësive akademike dhe ndihmës-akademike. Aktet e brendshme në formën e rregulloreve për çdo njësi akademike kanë të përcaktuara qartë detyrat, funksionet dhe bashkëpunimin akademik ndërmjet tyre. Rregullorja e njësive bazë, pranë të cilit ofrohet dhe programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale”, ka të përcaktuar detyrat e drejtuesit të njësive, të koordinatorit të programit, të stafit akademik dhe bashkëpunimit apo koordinimit ndërmjet aktorëve përkatës në procesin akademik. <i>Evidenca nr. 11 “Rregullore e Njësive Kryesore FDSHP”</i> <i>Evidenca nr. 43 “Model orari mësimor i programit të studimit”</i> <i>Evidenca nr. 12 “Rregullore e Departamentit të Drejtësisë”</i> <i>Evidenca nr. 36 “Raporti vjetor i veprimtarive FDSHP, Viti Akademik 2022-2023”</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Në funksion të veprimtarisë akademike të institucionit, por edhe të këtij programi studimi, institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. KUB ka nënshkruar 43 marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve, në kuadër të programit Erasmus +, ku mund të përmendim Universitetin Lumsa në Itali, Akademinë ndërkombëtare në Riga, Letoni, Universitetin e Novi Pazar në Serbi, Universitetin Andrei Saguna në Rumani, etj. Këto marrëveshje bashkëpunimi kanë mundësuar shkëmbimin e përvojave akademike të stafit, duke mundësuar dhe rritjen e kapaciteteve akademike. Nëpërmjet programit Erasmus+ është mundësuar mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve. <i>Evidenca nr. 30 “Marrëveshje bashkëpunimi KUB-UAMD”</i> <i>Evidenca nr. 29 “Model Marrëveshjeje TIP-KUB me IAL/Biznes, Sipërmarrje, OJF”</i> <i>Evidenca nr. 27 “Lista e marrëveshjeve me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë”</i> <i>Evidenca nr. 32 “Marrëveshje bashkëpunimi Projekti Co-HOST”</i> <i>Evidenca nr. 28 “Raport i Përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara në kuadër të projekteve”</i>

Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, në nivelin e njësisë kryesore dhe bazë, janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet publike dhe private. Këto marrëveshje janë dhe në funksion të realizimit të praktikave profesionale dhe të bashkëpunimit akademik. Marrëveshjet janë dhe në funksion të krijimit të kontakteve të institucionit me aktorët e tregut të punës për vijimin e bashkëpunimit dhe të punësimit të studentëve pas diplomimit të tyre. Në këto marrëveshje është parashikuar që punëdhënësit të mundësojnë studentët për realizimin me efikasitet të praktikës profesionale dhe në përfundim të nënshkruajnë raportin tip. <i>Evidenca nr. 33 “Udhëzues për Përgatitjen Praktikës Profesionale”</i> <i>Evidenca nr.160 “Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në “E drejtë Penale”</i> <i>Evidenca nr. 33 “Model raporti TIP për kryerjen e Praktikës Profesionale”</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, harton raportin vjetor në fund të vitit akademik. Raporti vjetor i hartuar nga njësia bazë (Departamenti i Drejtësisë) përmban elemente të analizës së punës akademike dhe administrative të kësaj njësie, në funksion të procesit mësimor. Pjesë e kësaj analize janë dhe dobishmëritë nga marrëveshjet e bashkëpunimit, por jo si një komponent i mëvetshëm. Praktikant Mësimorë të studentëve mbikëqyren nga punëdhënësit e qendrave ku kryhet praktika, i cili nënshkruan edhe Raportin e Praktikës që paraqitet më tej në KUB për vlerësim nga Komisioni i Vlerësimit. <i>Evidenca nr. 34 “Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022”</i> <i>Evidenca nr. 36 “Raporti vjetor i veprimtarive FDSHP, Viti Akademik 2022-2023”</i> <i>Evidenca nr.37” Raporti vjetor i veprimtarive Departamenti i Drejtësisë”</i> <i>Evidenca nr.28 “Raport i Përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara në kuadër të projekteve”</i> <i>Evidenca nr.3 “Marrëveshje bashkëpunimi TIP për Praktikant Profesionale”</i>



Konkluzione	Në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", KUB (në nivelin e njësisë kryesore dhe bazë) ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet publike dhe private në funksion të realizimit të praktikave profesionale, të krijimit të kontakteve të institucionit me aktorët e tregut të punës për vijimin e bashkëpunimit dhe të punësimit të studentëve pas diplomimit të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1				
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.				
Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale" është i organizuar në bazë të krediteve ECTS. Ky program studimi përbëhet nga 120 ECTS përgjatë dy viteve akademike të ndara në 60 ECTS në cdo vit akademik. Lëndët/modulet që janë pjesë e këtij program studimi janë të grupuara sipas kategorive karakterizuese, bazuar në ndarjet përkatëse sipas akteve nënligjore në fuqi në fushën e arsimit të lartë (A,B,C,D dhe E). Niveli i kualifikimit është sipas përcaktimeve të KSH dhe KEK (niveli 7).Veprimtaria formuese e programit të studimit sipas kategorive A,B,C,D dhe E është:			
	Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Sipas VKM 41/2018, e ndryshuar	Sipas programit të studimit
	A	Lëndë bazë	5 % - 10 % (kredite)	10%

	B	Lëndë karakterizuese	50% -60% (kredite)	58.3%
	C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12% -20% (kredite)	10%
	D	Lëndë Plotësuese	10% (kredite)	8.3%
	E	Detyrime përmbyllëse	10% -15% (kredite)	13.3%
Nga sa më sipër vërehet një % e ulët mospërputhshmërie tek kategoritë C dhe D, që ndoshta nuk e çënojnë programin. <i>Evidenca nr.38 "Dosja e Programit të Studimit Msc në "E drejtë Penale"</i> <i>Evidenca nr.11 "Rregullore e Njesisë Kryesore FDSHP"</i> <i>Evidenca nr.12 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i> <i>Evidenca nr.13 "Rregullore e Programit të Studimit"</i> <i>Evidenca nr.40 "Kurrikula e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr.41 "Planet Mësimore të programit të studimit"</i>				
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të	Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale" synon përgatitjen e specialistëve me një formim të thelluar teorik në fushën e së drejtës penale dhe kriminologjisë, të aftë të jenë pjesë e zgjidhjeve të problematikave që shfaqen për parandalimin e fenomenit të kriminalitetit. Ky program studimi ka si qëllim të pajisë studentët me formim teorik të thelluar si dhe t'i aftësojë ata në zgjidhjen e çështjeve specifike si dhe të kryejnë studime të thelluara në fushën e të drejtës penale. <i>Ndonëse në tërësinë e saj, kurrikula e programit Msc në "E drejtë Penale" synon të japë njohuri në fushën penale, disa lëndë në përmbajtjen e kurikulës si: E drejta kushtetuese e avancuar, E drejta civile e avancuar, E drejta dhe procedura administrative, E drejta e konkurrencës, nuk përputhen plotësisht me profilin penal të këtij programi studimi si dhe objektivat e programit të studimit për formimin e ekspertëve dhe specialistëve në fushën e së drejtës penale.</i> <i>Evidenca nr.60 "Studim Tregu për programin e studimit Msc në "E drejtë Penale"</i>			

specializuar studimi ose profesionale.	<i>Evidenca nr.50 "Punim studenti nga IAL partnere në Konferencën Studentore"</i> <i>Evidenca nr.13 "Rregullore e Programit të Studimit"</i> <i>Evidenca nr.38 "Struktura Mësimore programit të studimit"</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale" është i organizuar sipas sistemit të krediteve ECTS. Pjesë e këtij program studimi janë dhe kreditet ECTS të përcaktuara për praktikën profesionale, e cila bën pjesë në kategorinë D. Kjo lëndë përbëhet nga 10 ECTS dhe zhvillohet përgjatë vitit të dytë akademik. Në semestrin e dytë të vitit të dytë akademik studentët përgatisin dhe detyrimin përmbyllës në formën e punimit të diplomës, e cila përbëhet nga 16 ECTS. <i>Evidenca nr.13 "Rregullore e Programit të Studimit"</i> <i>Evidenca nr.12 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i> <i>Evidenca nr.33 "Udhëzues për Përgatitjen Praktikës Profesionale"</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	N / A
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të	N / A

mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” është i organizuar në aspektin strukturor dhe akademik sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë. Mënyra e pranimi të studentëve është përcaktuar në rregulloren e përgjithshme të kolegjit si dhe në rregulloren e këtij program studimi. Ky program studimi është i organizuar me 120 ECTS, në dy vite akademike, në formën e studimeve me kohë të plotë që në fund të studimeve lëshohet diploma e ciklit të dytë të studimeve (sipas modelit të miratuar nga MAS). <i>Evidenca nr.150 “Vendim BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimi të studentëve 2022-2023”</i> <i>Evidenca nr.153 “Lista e studentëve që përfitojnë Bursa Viti Akademik 2022-2023”</i> <i>Evidenca. 7. Rregullore e Programit të Studimit;</i> <i>Evidenca. 4. Rregullore e KUB;</i>
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit MSc në “E Drejtë Penale” është i njëjtë me programe studimi në të njëjtën fushë dhe me të njëjtën emërtësë, të ofruar nga Universiteti Luarasi, Universiteti Privat Albanian University, Universiteti Ismail Qemali. Kjo lehtëson mobilitetin e studentëve.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Referuar RVB, kodi i programeve të studimit, është dërguar në MAS. <i>Evidenca nr.51 “Shkresa dërguar MAS për kodifikimin e programeve të studimit”</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të	Programi i studimit MSc në “E Drejtë Penale” nuk është program studimi i përbashkët.

përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” është i organizuar sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë. Mënyra e strukturimit të këtij program studimi (në 120 ECTS, në katër semestra, në dy vite akademike) është përcaktuar në rregulloren e këtij program studimi. Ky program studimi synon përgatitjen e specialistëve me formim të thelluar teorik në fushën e së drejtës penale.</i> <u><i>Konstatohen disa lëndë në kurrikul, që nuk përputhen plotësisht me profilin penal të këtij program studimi si dhe objektivat e programit të studimit për formimin e ekspertëve dhe specialistëve në fushën e së drejtës penale.</i></u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi								
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Kolegji Universitar “I Biznesit”, përmbush kriteret e përcaktuara në pikën nr. 2 neni 20, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. KUB është i përbërë nga tre njësi kryesore: 1. Fakulteti i Ekonomisë; 2. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike; 3. Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale (KSLP) FDSHP për vitin akademik 2023-2024 ka angazhuar gjithsej 32 staf akademik nga të cilët 21 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 11 staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikim: <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Fakulteti i Drejtësisë Shkencave Politike</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td></td><td></td><td></td></tr></table>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Drejtësisë Shkencave Politike		PAE	PAK			
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Drejtësisë Shkencave Politike								
	PAE	PAK							

	Prof.Dr	-	1
	Prof.Asoc	2	-
	Dr/PhD	14	7
	Msc	5	3
	Gjithsej	21	11

Departamenti i Drejtësisë përgjegjë për programin e studimit përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas tre viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	2	-	1
Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	-
Dr./PhD.	3	4	4	4	6	2
Msc.	4	3	3	2	1	3
Totali	7	7	7	8	7	6

Evidenca nr.26 “Organigrama e KUB & Vendimi i Senatit Akademik”

Evidenca nr.11”Rregullore e Njesisë Kryesore FDSHP”

Evidenca- nr.40 “Kurrikula e programit të studimit”

Evidenca nr.41 “Planet Mësimore të programit të studimit”

Evidenca. 116. Tabelat Përmbledhëse Aneks RVB Msc në “E drejtë Penale”

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave	Njësia kryesore dhe njësia bazë, pranë të cilit ofrohet dhe ky program studimi janë të organizuara në aspektin strukturor-akademik, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se Fakulteti dhe departamenti, nuk kanë personel ndihmës akademik / administrativ. Evidenca nr.160 “Tabelat Përmbledhëse Aneks RVB MSc në “E drejtë Penale” Evidenca nr.33 “Udhëzues për Përgatitjen Praktikës Profesionale”
--	--

mësimore, laboratorike e klinike, etj.				
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” ka një koordinator, detyrat e të cilit janë të përcaktuara në rregulloren e njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Drejtuesi i departamentit është koordinatori i programit të studimit i cili ka detyra të mirëpërcaktuara në aktet e brendshme të institucionit. Ai mbikqyr veprimtaritë mësimore shkencore në përputhje me planin vjetor të stafit, dhe monitoron gjithë procesin e përgatitjes, rishikimit, përmirësimit dhe realizimit të programit të studimit. <i>Evidenca nr.12 “Rregullore e Departamentit të Drejtësisë”</i> <i>Evidenca. 5. Rregullore e Njësisë Kryesore FDSHP;</i> <i>Evidenca nr.43 “Model orari mësimor i programit të studimit”</i>			
Konkluzione	<i>Njësia kryesore FDSHP, pranë të cilit ofrohet programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, përbëhet nga tre njësi bazë, të cilat drejtohen nga drejtuesit përkatës. Departamenti i Drejtësisë, pranë të cilit është i organizuar dhe ofrohet dhe ky program studimit, drejtohet nga drejtuesi i departamentit i cili është emëruar/caktuar koordinator i programit, detyrat dhe funksionet e të cilit janë të përcaktuara në aktet e brendshme të institucionit.</i> <i>GVJ gjykon se njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kriteret ligjore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e	Bazuar në pikën 2, neni 11, të Statutit të Kolegjit Universitar të Biznesit, FDSHP, është njësia kryesore që bashkërendon veprimtarinë mësimore dhe atë kërkimore shkencore si dhe veprimtarinë me karakter profesional dhe krijues në fushën e drejtësisë. FDSHP, pranë të cilit ofrohet programi i ciklit të studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” ofron

nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	informacionin e duhur mbi strukturën akademike dhe organizative të këtij programit. Ky program studimi është i organizuar në 120 ECTS, në dy vite akademike (katër semestra akademik). Bazuar në <i>nenin 30</i> të Statutit, Drejtuesi i Departamentit është autoriteti drejtues akademik i njësisë dhe e përfaqëson atë. Ndër detyrat e specifikuar: - drejton dhe kontrollon punën mësimore dhe kërkimore - shkencore; - miraton planet kalendarike, komisionet e provimeve si dhe tezat; - miraton programet e lëndëve përkatëse dhe ndjek planifikimin e veprimtarive shkencore; <i>Evidenca nr.12 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i> <i>Evidenca nr.41 "Planet Mësimore të programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr.13 "Rregullore e Programit të Studimit"</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Msc në "E Drejtë Penale" është strukturuar në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë. Lëndët që janë pjesë e kurrikulës së këtij programi studimi të ciklit të dytë janë të organizuara në bazë të krediteve me orë të përcaktuara në auditor (në formën e leksioneve dhe seminareve) dhe orëve të pavarura të studentit jashtë auditorit. Pjesë e kurrikulës janë dhe praktikë profesionale dhe detyrimet përmbyllëse. <i>Evidenca nr.41 "Planet Mësimore të programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr.160 "Tabelat Përmbledhëse Aneks RVB MSc në "E drejtë Penale"</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në Rregulloren e programit të studimit, <i>nenin 5</i>, janë të përcaktuara procedurat e pranimi të studentëve. Pranimi i studentëve në këtë program bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në ligj dhe në udhëzimet përkatëse të MASR. Kriteri bazë për pranimin e studentëve në programin e studimit është përfundimi i studimeve të ciklit të parë. Kriteret shtesë për pranimin në ciklin e dytë të studimeve miratohen dhe shpallen cdo vit nga KU "I Biznesit", dhe i dërgohen ministrisë përgjegjëse. Kriteret bëhen publike edhe në web-in zyrtar të KUB www.kub.edu.al, gjithashtu ato përcillen edhe në QSHA. Programi i studimit ofron mundësi për njohjen dhe transferimin e krediteve, bazuar në <i>nenin 12</i>, të Rregullores të programit të studimit. KUB pranon transferime të studentëve në

	këtë program studimi në vitet ndërmjetëse nga institucionet e tjera të arsimit të lartë vendase ose të huaja, dhe lejon transferimin e studentëve të saj në institucionet të tjera. <i>Evidenca nr.10 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr.13 "Rregullore e Programit të Studimit"</i> <i>Evidenca nr.55 "Rregullore për ekuivalentimin e studimeve"</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Informacioni mbi strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi është përcaktuar në rregulloren e programit (<i>neni 4</i>). Sipas <i>nenit 7</i> të kësaj rregulloreje janë të përcaktuara kategoritë karakterizuese të programit, të ndara dhe të përcaktuara sipas akteve nën ligjore në fushën e arsimit të lartë. Kreditet për çdo grup lëndësh karakterizuese janë njëkohësisht të përcaktuara, në bazë të numrit të krediteve ECTS. Informacioni mbi përmbajtjen e rregullores së programit është i aksesueshëm për studentët dhe stafin akademik. Përmbajtja e lëndëve të kurrikulës së programit të studimit është pjesë e informacionit të aksesueshëm për studentët. Syllabuset e lëndëve janë të hartuara nga pedagogët përgjegjës dhe firmosur nga drejtuesi i njësisë përkatëse. <i>Evidenca nr.161 "Tabelat Përmbledhëse Aneks RVB MSc në "E drejtë Penale"</i> <i>Evidenca nr.13 "Rregullore e Programit të Studimit"</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni i administruar, GVJ konstaton se rishikimi i syllabuseve për përditësimin e materialeve bëhet në fillim të çdo viti akademik. Në çdo fillim të vitit akademik/semestri akademik, stafi akademik përgjegjës për hartimin e syllabus-eve të lëndëve përmirëson/rishikon përmbajtjen e programeve të lëndëve, të cilat më pas miratohen nga njësia përkatëse. Përditësimet propozohen nga Departamenti i Drejtësisë dhe miratohen në Senatin Akademik.Me vendim Senati, realizohet ndryshimi dhe përmirësimi i programeve ekzistuese në atë madhësi që lejohen sipas udhëzimeve përkatëse të MAS. <i>Evidenca nr.11 "Rregullore e Njësisë Kryesore FDSHP"</i> <i>Evidenca nr.62 "Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023"</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit është në përputhje me kriteret ligjore, i strukturuar si dhe përmban objektiva formues të qartë e të përshtatshëm për ciklin e dytë të studimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi përmban lëndë që u mundësojnë studentëve njohuri mbi zhvillimet më të fundit në fushën penale në përputhje me emërtimin e programit. Elementët e programit të studimit, emërtimi i lëndëve, struktura e vitit akademik, ndarja në orë e kredite është në përputhje me parshikimet ligjore të nenit 70, të ligjit nr. 80/2015 dhe të VKM 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar në VKM nr. 879 datë 18.12.2019. Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” është organizuar në bazë të krediteve ECTS, përgjatë dy viteve akademike. Numri i krediteve ECTS varion nga 6 deri në 7, për praktikën profesionale 10 ECTS, dhe detyrimet përmbyllëse janë 16 ECTS. <i>Evidenca nr.41 “Planet Mësimore të programit të studimit”</i> <i>Evidenca nr.33 “Udhëzues për Përgatitjen Praktikës Profesionale”</i> <i>Evidenca nr.58 “Raporti vjetor i veprimtarive të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës”</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se programi i studimit është i shpërndarë në dy vite akademike, me dy semestra secili vit, me një ngarkesë totale 120 ECTS, ku në çdo vit akademik dhe semestër ka një shpërndaje të barabartë të krediteve. Lëndët dhe veprimtaritë formuese janë të shpërndara në bazë të përmbajtjes karakterizuese përkatëse. Në semestrin e parë janë kryesisht lëndët e formimit të përgjithshëm dhe në semestrat në vijim ato karakterizuese të programit të studimeve, të cilat ofrojnë njohuri të thelluara në fushën e të drejtës penale. Njohuritë e ofruara nga ky program studimi mundësojnë studime të mëtejshme për studentët dhe punësim në fushat përkatëse të tregut të punës. <i>Evidenca nr.41 “Planet Mësimore të programit të studimit”</i> <i>Evidenca nr.160 “Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në “E drejtë Penale”</i> <i>Evidenca nr. 13 “Rregullore e Programit të Studimit”</i>

Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” është strukturuar në bazë të oreve që zhvillohen në auditor në formën e leksioneve dhe seminareve dhe orëve të punës së pavarur. Shpërndarja e ngarkesës akademike për studentët është e balancuar përgjatë të katër semestrave akademik. Përgjatë një viti akademik janë shpërndarë 60 ECTS. Në semestrin e katër realizohet praktika profesionale dhe detyrimi përmbyllës. <i>Evidenca nr.41 “Planet Mësimore të programit të studimit”</i> <i>Evidenca nr.13 “Rregullore e Programit të Studimit Msc në “E Drejtë Penale”</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Në këtë program studimi janë të përcaktuara veprimtaritë formuese teorike dhe praktike. Këto veprimtari janë të shpërndara përgjatë të katër semestrave akademike. Qëllimi i përmbajtjes së lëndeve është formimi teorik dhe praktik i studentëve. Njësia bazë ka rishikuar dhe përmbajtjen e kurrikulës për ta lidhur atë më shumë me tregun e punës dhe ofrimin e njohurive të thelluara teorike. <i>Evidenca nr.160 “Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në “E drejtë Penale”</i> <i>Evidenca nr.58 “Raporti vjetor i veprimtarive të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës</i> <i>Evidenca nr.57 “Plani i vjetor i veprimtarive të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës”</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Lëndët e këtij programi studimi përmbajnë elementet e nevojshëm akademik. Në të gjitha lëndët e programit të studimit është përfshirë literatura e detyrueshme dhe literatura e rekomanduar/këshillueshme. Literatura është një nga elementet e programit të lëndëve që rishikohet dhe pasurohet në vijimësi. <i>Evidenca nr.42 “Syllabus-et e Lëndëve/Moduleve të programit të studimit”</i> <i>Evidenca nr.63 “Relacion për Realizimin e Buxhetit 2022 dhe Planifikimi 2023 KUB”</i> <i>Evidenca nr.64 “Lista e teksteve të reja për programin e studimit”</i> <i>Evidenca nr.107 “Marrëveshje bashkëpunimi JSTOR/e-biblioteka”</i>

Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” përmban lëndë, të cilat mundësojnë një formim të thelluar në të drejtën penale, duke nxitur dhe aftësimin profesional të të diplomuarve. Përmes lëndëve përkatësi si p.sh., “E drejta penale e avancuar”; “Procedurë penale e avancuar”, “E drejta ndërkombëtare penale”; ”Kriminalistikë”; “Krimet e botës moderne”, etj, studentët përgatiten për në tregun e punës. <i>Evidenca nr.13 “Rregullore e Programit të Studimit Msc në “E Drejtë Penale”</i> <i>Evidenca nr.60 “Studim Tregu për programin e studimit Msc në “E drejtë Penale”</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit Msc “E Drejtë Penale”, mundëson për të diplomuarit vijimësinë e studimeve në ciklin e tretë të studimeve si dhe daljen e tyre në tregun e punës për ushtrimin e profesionit të juristit. Ky program i jep mundësi studentëve edhe për vijimin e studimeve në fushën e avokatisë dhe magistratures. Përfshirja në platformën GRADUA, i cili u financua nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian, ofroi një mbështetje për universitetet shqiptare duke krijuar një model të integruar kërkesë-ofertë punësimi, të bazuar mbi të dhënat e databazës së të diplomuarve, përmes mbledhjes së të dhënave lidhur me performancën e tyre lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet IAL-ve dhe bizneseve lehtësimin e pozicionimit të të diplomuarve në tregun e punës. <i>Evidenca nr.13 “Rregullore e Programit të Studimit Msc në “E Drejtë Penale”</i> <i>Evidenca nr.60 “Studim Tregu për programin e studimit Msc në “E drejtë Penale”</i> <i>Evidenca nr.161 “Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në “E drejtë Penale”</i> <i>Evidenca nr.65 “Marrëveshja dhe regjistrimi në Platformën GRADUA”</i>
Konkluzione	Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” përmban lëndë, të cilat mundësojnë një formim të thelluar në të drejtën penale, duke nxitur dhe aftësimin profesional të të diplomuarve. Në këtë program studimi janë të përcaktuara veprimtaritë formuese teorike dhe praktike të shpërndara përgjatë të katër semestrave akademik. Qëllimi i përmbajtjes së lëndëve është formimi teorik dhe praktik i studentëve. Njësia bazë ka rishikuar dhe përmbajtjen e kurrikulës për ta lidhur atë me shumë me tregun e punës dhe ofrimin e njohurive të thelluara teorike.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” është rishikuar dhe përmirësuar në funksion të kërkesave të tregut të punës. Ky përmirësim i kurrikulës në këtë program studimi është realizuar përmes bashkëpunimit me stafin akademik dhe bashkëpunëtorëve të tregut të punës. KUB sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partneritetit, jo vetëm zhvillon praktikat profesionale, por edhe merr feedback nga ekspertët e këtyre institucioneve mbi cilësinë e programit të studimit dhe kërkesat e tregut të punës. <i>Evidenca nr.6 “Studim Tregu për programin e studimit Msc në “E drejtë Penale”</i> <i>Evidenca nr.160 “Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në “E drejtë Penale”</i> <i>Evidenca nr.58 “Raporti vjetor i veprimtarive të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës”</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Pëfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse të institucionit realizohet përmes procesit të zgjedhjes së tyre. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në këto organe. Studentët janë anëtarë të disa prej strukturave më të rëndësishme drejtuese në KUB si psh: Senati Akademik, NjSBC, GVB-të, etj, në të cilat kontributi i tyre është i drejtpërdrejtë pasi këta studentë janë në këto struktura zëri më i rëndësishëm përfaqësues i Këshillit të Studentëve dhe Qeverisë Studentore. Mendimet dhe opinionet e studentëve janë pjesë e pyetsorëve dhe sondazheve, që realizohen nga zyrat përkatëse të institucionit. Aktet e brendashme të institucionit kanë të përcaktuara të drejtat e studentëve. <i>Evidenca nr.58 “Raporti vjetor i veprimtarive të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës”</i> <i>Evidenca nr. 57 “Plani vjetor i veprimtarive të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës”</i>

	<i>Evidenca nr.19 "Rregullore e Senatit Akademik të KUB"</i> <i>Evidenca nr.161 "Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në "E drejtë Penale"</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Institucioni dhe njësia bazë (Departamenti i Drejtësisë) për këtë program studimi realizon takime me grupet e profesionistëve të fushave të ndryshme për të marrë mendimin dhe vlerësimin e tyre për komponentët e procesit mësimor dhe për shërbimet që mund të ofrohen nga institucioni. Gjithashtu njësia bazë në të cilën ofrohet ky program studimi, përditëson përmbajtjen e programit dhe në bazë të akteve të brendshme të institucionit, duke marrë në konsideratë dhe vlerësimet e studentëve. <i>Evidenca nr.160 "Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në "E drejtë Penale"</i> <i>Evidenca nr.60 "Studim Tregu për programin e studimit Msc në "E drejtë Penale"</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka të përcaktuar në dokumentat bazë për realizimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit e aktorët e tregut të punës në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve akademike.</i> <i>KUB ka marrëdhënie të konsoliduara me aktorët e tregut të punës të cilët, ndër të tjera mund të angazhohen edhe në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", janë të përcaktuara objektivat akademike dhe shkencore, të cilat janë në përputhje me objektivat strategjik të institucionit. Objekti kryesor i programit të studimit të ciklit të dytë Msc në "E Drejtë Penale" është formimi i ekspertëve dhe specialistëve cilësorë si në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë aplikative në fushën e të drejtës penale. Ky program studimi është i orjentuar drejt studimeve të thelluara në fushën e të drejtës

	penale dhe punimet e temave të diplomës së studentëve janë të orjentuar drejt kësaj fushe studimore dhe kërkimore. <i>Evidenca nr.13 "Rregullore e Programit të Studimit Msc në "E Drejtë Penale"</i> <i>Evidenca nr.6 "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca nr.41 "Planet Mësimore të programit të studimit"</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia kryesore për këtë program studimi (FDSHP) bashkërendon punën akademike dhe administrative nëpërmjet strukturave përkatëse. Njësia bazë, pranë të cilit ofrohet dhe ky program studimi, respekton lirinë akademike të stafit akademik efektiv, duke mundësuar vendimarrjen e tyre në lidhje me përmbajtjen e syllabuseve dhe propozimet për veprimtaritë e ndryshme akademike. Njësia bazë ju mundëson pedagogë pjesëmarrjen në projekte kërkimore. <i>Evidenca nr.36 "Raporti vjetor i veprimtarive FDSHP, Viti Akademik 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr.37 "Raporti vjetor i veprimtarive Departamenti i Drejtësisë, Viti Akademik 2022-2023"</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale" mundëson për studentët përfshirjen në aktivitetet akademike dhe kërkimore që organizohen nga Departamenti i Drejtësisë. Institucioni është i anagazhuar në projekte studimore dhe kërkimore. Studentët kryesisht angazhohen në çështjet e temave të diplomës, duke bërë të mundur që ata të jenë më të fokusuar në fushën e tyre specifike të studimit. <i>Evidenca nr.49 "Program i Konferencës Shkencore Studentore"</i> <i>Evidenca nr.58 "Raporti vjetor i veprimtarive të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës"</i> <i>Evidenca nr.93 "Raport mbi aktivitetet e zhvilluara me stafin dhe studentët në KUB dhe me përfaqësues të IAL-të"</i> <i>Evidenca nr.85 "Raporti Vjetor i Punës Kërkimore Shkencore dhe Projektet, KUB"</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Aktivitetet kërkimore dhe studimore që mund të mbështeten nga njësia bazë realizohen përmes financimit në nivel institucional. Administratori i institucionit ndjek zbatimin e mbështetjes financiare për të gjitha strukturat përkatëse. Sipas RVB KUB ka alokuar buxhet për të financuar të gjithë artikujt e stafit akademik që botohen në Revista me faktor impakti dhe SCOPUS, në kuadër të kualifikimit dhe promovimit të stafit për të fituar grada dhe tituj akademike. Gjithashtu mbështet me financim kërkimin shkencor për rreth 7 deri 8% të shpenzimeve gjithsej.

	<i>Evidenca nr.86 "Rregullore e zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve"</i> <i>Evidenca nr.73 "Vendim BA për mbështetjen financiare për Kërkimin Shkencor të stafit akademik KUB"</i> <i>Evidenca nr.63 "Relacion për Realizimin e Buxhetit 2022 dhe Planifikimi 2023 KUB"</i>			
Konkluzione	<i>Ky program studimi është i orjentuar drejt studimeve të thelluara në fushën penale dhe punimet e temave të diplomës së studentëve janë të orjentuar drejt kësaj fushe studimore dhe kërkimore.</i> <i>Programi i studimit është përshtatur dhe me objektivat bazë strategjike të institucionit, të cilat lidhen me ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Departamenti i Drejtësisë (si njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi) bashkëpunon me zyrat përkatëse për projektet kërkimore-shkencore. Nga takimi me stafin akademik u konstatua se KUB mbështet financiarisht personelin akademik për materialet e referatat e përgatitura dhe prezantuara në Konferencat Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare. Institucioni nxit pjesëmarrjen e stafit në trajnime, leksione të hapura apo aktivitete shkencore brenda apo jashtë vendit. Për këtë qëllim, KUB ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione homologe si dhe është pjesë e programeve të shkëmbimit të stafit dhe studentëve. Personeli akademik i KUB mund të botojë pa pagesë punime shkencore në "Revisten Shkencore të Studimeve Profesionale", botim periodik i KUB. Gjithashtu KUB financon botimet për personelin akademik i cili boton punimet në revista të tjera shkencore ndërkombëtare me Faktor Impakti dhe të indeksuara në Scopus. <i>Evidenca nr.146 "Relacion për Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare që janë zhvilluar në KUB përgjatë viteve akademike 2020-2023"</i>

	<i>Evidenca nr.147 "Rankimi i Universiteteve për punën shkencore, 2022"</i> <i>Evidenca nr.125 "Proceedings të Konferencës së IX-të Shkencore Ndërkombëtare KUB"</i> <i>Evidenc nr.160 "Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në "E drejtë Penale"</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Departamenti i Drejtësisë, si njësia bazë për këtë program studimi, mbështet anëtarët e departamentit për pjesëmarrjen në projekte kërkimore. Referuar RVB, dy pedagogë janë angazhuar si udhëheqës i një grupi studentësh në konkursin University Law Competition 2023 2nd Edition, të organizuar nga Halimi Foundation Institute me pjesëmarrjen e mbi 10 Fakulteteve të Drejtësisë të Universiteteve brenda vendit. <i>Evidenca nr.93 "Raport mbi aktivitetet e zhvilluara me stafin dhe studentët në KUB dhe me përfaqësues të IAL-të"</i> <i>Evidenca nr.92 "Raport i planifikimit të aktiviteve të KUB nga Marrëveshjet Erasmus"</i> <i>Evidenca nr.161 "Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në "E drejtë Penale"</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Departamenti i Drejtësisë organizon leksione të hapura, të cilat lidhen me temat që janë pjesë e këtij programi studimi. Këto orë të hapura lidhen dhe me tema të aktualitetit në fushën e drejtësisë. Njësia bazë përgjegjëse ka organizuar edhe konferenca për ti ardhur në ndihmë stafit dhe studentëve në këtë program studimi. <i>Evidenca nr.146 "Relacion për Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare që janë zhvilluar në KUB përgjatë viteve akademike 2020-2023"</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale" përmban lëndë që mundësojnë njohuri të thelluara në fushat respektive të së drejtës. Njohuritë e ofruara në këtë program studimi lidhen me tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Studentët të cilët përfundojnë me sukses studimet në këtë program studimi mund të punësohen si: ekspertë të fushës së së drejtës penale, zyra avokatie dhe konsulence ligjore, zyrë noterie, sektorë të ndryshëm publikë dhe privatë etj.). <i>Evidenca nr.60 "Studim Tregu programi i studimit Msc në E drejtë Penale"</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat	Referaur RVB dhe takimeve në institucion, KUB sipas Urdhërimit Ministrit të Drejtësisë Nr. 619, datë 23.11.2022, ka fituar të drejtën për të kryer trajnime dhe kualifikime me Kandidatët që kërkojnë të Licencohen për Profesionin e Ndërmjetësit të Pasurive të Paluajtshme, në bazë të Ligjit Nr. 9, dt. 27.01.2022 "Për

profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	<i>Profesionin e Ndërmjetësit të Pasurive të Paluajtshme</i>". Studentët të cilët përfundojnë me sukses studimet në këtë program studimi mund të punësohen si: ekspertë të fushës së drejtës penale, zyra avokatie dhe konsulence ligjore, zyrë noterie, sektorë të ndryshëm publikë dhe privatë etj.). <i>Evidenca nr.144 "Urdhër i Ministrit të Drejtësisë në RSh, që autorizon KUB për realizimin e "Programit të detyrueshem të trajnimit për NPP"</i> <i>Evidenca nr.145 "Program trajnimi për Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme & Çertifikatë"</i>			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Referaur RVB, programi i studimit Msc në "E Drejtë Penale", përputhet me programin për profesionet e rregulluara në RSh dhe rekomandimeve ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian. Ky program studimi është në përputhje dhe në fokusin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit në vend. Njëkohësisht ky program studimi është zhvilluar në mbështetje të Planit Strategjik të KUB (1). <i>Evidenca nr.6 "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Departamenti i Drejtësisë përmbush kërkesat e ligjit për udhëheqjen e realizimit të programit të studimit me cilësinë dhe sasinë e disiplinave të planifikuara. Në përbërje të tij është angazhuar një personel me përvojë të pasur në jetën akademike.</i> <i>Syllabuset e programit të studimit janë në përditësim të vazhdueshëm me literaturë të detyruar dhe këshilluese bashkëkohore.</i> <i>KUB stimulon nxitjen e debatit dhe diskutimeve me studentët dhe strukturat e tyre. GVJ konstaton se KUB në vazhdimësi këshillohet me studentët e diplomuar për reflektimin në programin e studimit të të rejave të shkencës dhe praktikës juridike. Takimet dhe veprimtaritë me natyrë shkencore e kërkimore evidentohen me shumë sukses në vitet akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë pjesë e rregullimeve në aktet rregullatore të institucionit dhe në përputhje me objektivat formues të këtij programi. Referuar Rregullores së programit të studimit, një nga komponentët e vlerësimit përfundimtar është vlerësimi i vazhduar, i cili përfshin angazhimin e studentëve në detyrat e kursit, projektet e kursit si dhe angazhimin në orën e mësimi. <i>Neni 41 i Rregullores së Njësisë Kryesore FDSHP sanksionon rregullime mbi komponentët e procesit mësimor. Procesi mësimor përbëhet nga leksionet, seminarët, punimet në laborator, punimet në terren, seminare dhe punime të tjera të ngjashme të parashikura në programin mësimor, detyrat e kursit, provimet e formimit dhe teza e diplomës.</i> Këta komponentë detajohen dhe përshtaten me natyrën e programeve mësimore të ofruara nga kjo njësi. Komponentët e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë edhe pjesë e syllabuseve dhe planeve mësimore të lëndëve/moduleve. Ato depozitohen në departament si dhe në acaountin personal të pedagogëve në portalin e KUB. Nga RVB konstatohet se ky dokumentacion është pjesë e dosjes së plotë të programit të studimit të administruar nga Departamenti i Drejtësisë. Kjo dosje përditësohet çdo vit akademik. <i>Evidenca nr.32.3 "Planet Mësimore të programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr.161 "Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në "E drejtë Penale"</i> <i>Evidenca nr.42 'Syllabus-et e Lëndëve/Moduleve të programit të studimit'</i>

Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Rritja e cilësisë së mësimdhënies është pjesë e vizionit, politikave bazë të cilësisë dhe strategjive zhvillimore në KUB. Institucioni nxit dhe mbështet personelin akademik në përdorimin e formave dhe metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Përdorimi i metodave interaktive dhe alternative të mësimdhënies mbështetet nga një infrastrukturë e përshtatshme në të gjitha mjediset e mësimdhënies. Klasat e leksioneve dhe seminareve janë të paisura me të gjitha mjetet e nevojshme didaktike dhe teknologjike si: mjete audiovizive, power point, kompjutera, etj. Këto mjedise kanë gjithashtu akses të palimituar në internet. Kjo infrastrukturë mundëson përdorimin e metodave inovative të tilla si prezantim me power-poin, video etj. Në përputhje me objektivat dhe qëllimin e programit të studimit për të përgatitur specialistë në fushën penale, metodat e mësimdhënies mundësojnë kombinimin e aspektve teorike me ato praktike në fushën penale. Gjithashtu sisteme teknologjike të tilla si, Portali i Studentit, Microsoft Teams, e-mail zyrtar, biblioteka onlineJSTOR/e-biblioteka, etj, mundësojnë rritjen e bashkëveprimit ndërmjet pedagogut dhe studentit si dhe përdorimin e formave e metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. <i>Evidenca nr. 2 “Plani Strategjik i Zhvillimit 2021-2026”</i> <i>Evidenca nr. 80 “Relacion mbi infrastrukturën e KUB”</i> <i>Evidenca nr. 74 “Guida e stafit për përdorimin e platformës Classroom KUB”</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.	KUB mbështet rritjen profesionale si dhe kualifikimin e stafit akademik nëpërmjet trajnimeve apo aktiviteteve akademike të vazhdueshme. Institucioni ka nxitur dhe mundësuar pjesëmarrjen e stafit në trajnime, leksione të hapura apo aktivitete shkencore jashtë vendit. Për këtë qëllim, KUB ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione homologe si dhe është pjesë e programeve të shkëmbimit të stafit dhe studentëve. Nëpërmjet programit Erasmus+ është mundësuar bashkëpunimi me një sërë universitetesh në vende të tilla si Itali, Ruamani etj si Universiteti Lumsa, Universiteti Andrei Saguna etj. Shkëmbimi i përvojave i shërben rritjes së kapaciteteve akademike të stafit si dhe kompetencave didaktike. Për këtë qëllim KUB bashkëpunon edhe me institucione të tjera të specializuara si ISAB (Instituti për Studime dhe Aplikime në Biznes) i cili ka mundësuar përfshirjen si trajnerë edhe të personelit akademik të KUB. Nxitja dhe promovimi i aktiviteteve dhe veprimtarive shkencore e profesionale i shërben

	kualifikimit akademik, por edhe përmirësimit të kompetencave didaktike të personelit akademik. Kompetenca didaktike dhe cilësia e mësimdhënies janë pjesë e vlerësimit periodik nëpërmjet pyetësorëve të studentëve në kuadrin e vlerësimit të standarteve të cilësisë. Për të mundur standarte më të mira në vlerësimin e cilësisë, KUB bashkëpunon me Institutin për Cilësi në Arsim (IQE)), një institut privat i specializuar në vlerësimin e komponentëve të cilësisë. <i>Evidenca nr.27 "Lista e marrëveshjeve me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë"</i> <i>Evidenca nr.75 "Marrëveshje bashkëpunimi KUB-IQE"</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personali akademik i angazhuar në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi përmbush kriteret ligjore lidhur me kualifikimin akademik. Si i tillë, anëtarët e këtij personeli kanë kompetencat e nevojshme akademike dhe didaktike në përcjelljen e njohurive dhe koncepteve të së drejtës penale si dhe përdorimin e metodave interaktive që nxisin mendimin kritik dhe aftësinë analitike të studentëve. Pedagogët part-time të cilët janë të punësuar në institucione të rëndësishme të drejtësisë, sjellin eksperiencën e tyre profesionale duke nxitur aftësitë praktike tek studentët. Cilësia e mësimdhënies monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga Departamenti i Drejtësisë dhe strukturat e sigurimit të cilësisë. Ajo vlerësohet në mënyrë periodike nëpërmjet pyetësorëve të studenteve ku reflektohet edhe përceptimi i tyre mbi performancën e pedagogëve dhe cilësinë e mësimdhënies. <i>Evidenca nr.62 "Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr.181 "Raporti i IQE për studentët, 2021"</i> <i>Evidenca nr.77"Lista e stafit akademik të arsimuar dhe kualifikuar jashtë vendit"</i> <i>Evidenca nr.161 "Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në "E drejtë Penale"</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar	Njësia bazë përgjegjëse për administrimin e programit të nivelit të dytë Msc në "E drejtë Penale" është Departamenti i Drejtësisë. Referuar rregullores së funksionimit të veprimtarisë së tij, Departamenti luan një rol të rëndësishëm për ruajtjen e standarteve të cilësisë, si në procesin e hartimit të materialeve mësimore, literaturës së programeve mësimore, si dhe metodologjinë e zhvillimit të orës mësimore. Departamenti i Drejtësisë rregullon veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe administrative që lidhet me këtë program studimi. Një nga

mendimet e sugjerimet e tyre.	objektivat e veprimtarisë së tij, është të ofrojë standarte akademike dhe profesionale të përafërta me programet analoge të institucioneve të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Për arritjen e objektivave të tij, Departamenti bashkërendon veprimtarinë e mbikqyrjes së cilësisë me njësinë kryesore FDSHP si dhe strukturat e dedikuara në fushën e cilësisë. <i>Evidenca nr. 11 "Rregullore e Njesisë Kryesore FDSHP"</i> <i>Evidenca nr.6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Cilësia e mësimdhënies si një nga nga komponentët më të rëndësishëm të cilësisë, i nështrohet veprimtarisë periodike të monitorimit. Ajo është pjesë e monitorimit nga strukturat e sigurimit të cilësisë. Institucioni ka ngritur dhe bërë funksionale struktura që mbikqyrin performancën e stafit dhe cilësinë e mësimdhënies dhe promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Struktura bazë në këtë drejtim është Departamenti i Drejtësisë, që ndjek dhe monitoron realizimin e programit të studimit si dhe vlerëson aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. Departamenti harton raporte vjetore mbi veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore të personelit akademik. KUB ka nstitucionalizuar sistemin e cilësisë duke ngritur në nivel institucional struktura të dedikura në këtë drejtim si Senati Akademik apo NJSBC. NJSBC në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore të stafit akademik. Njëkohësisht, nëpërmjet pyetësorëve, vlerëson performancën dhe aftësitë akademike dhe didaktike të personelit akademik. <i>Evidenca nr.179 "Format Pyetësori i Studentëve IQE"</i> <i>Evidenca nr.180 "Raporti i IQE për Stafin Akademik, 2021"</i> <i>Evidenca nr.81 "Vlerësim Performance stafi_TIP"</i> <i>Evidenca nr.182 "Vlerësim Performance stafi personalizuar"</i>
Konkluzione	<i>Nëpërmjet këtij programi studimi, KUB synon aftësimin profesional të studentëve në fushën e të drejtës penale. Personeli akademik i angazhuar në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi përmbush kriteret ligjore lidhur me kualifikimin akademik.</i> <i>Si i tillë, stafi akademik posedon kompetencat e nevojshme akademike dhe didaktike në përcjelljen e njohurive dhe koncepteve të së drejtës penale, si dhe përdorimin e metodave</i>

	<i>interaktive që nxisin mendimin kritik dhe aftësinë analitike të studentëve.</i> <i>Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë përgjegjëse, si dhe strukturat e dedikuara të cilësisë në nivel institucional, monitorojnë cilësinë e mësimdhënies si një nga komponentët më të rëndësishëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e programit në nenin 10 parashikon rregullime lidhur me kontrollin e dijeve dhe instrumentat e vlerësimit. Shkalla e përvetësimit të dijeve me shkrim ose me gojë, bëhet me pikë nga 0-100 pikë, dhe rezultati përfundimtar konvertohet me notë nga (katër) në 10 (dhjetë). Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit në çdo lëndë/modul mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Vlerësimi përfundimtar është rezultat i dy komponentëve, vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit në provimin përfundimtar. Përcaktimet në rregullore janë të detajuara dhe të qarta. Parashikime që lidhen me kontrollin e dijeve dhe format e vlerësimit të njohurive janë pjesë përbërëse edhe e Rregullores së Njesisë Kryesore FDSHP, si dhe Rregullores së KUB. Nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare web të KUB, www.kub.edu.al, ato bëhen të njohura dhe janë lehtësisht të kuptueshme për studentët. Këto kriterë pasqyrohen edhe në formatin e syllabusit të lëndës. Studentët e aksesojnë informacionin edhe nga pedagogët e lëndëve/moduleve ose pranë Sekretarisë Mësimore. <i>Evidenca nr.11 "Rregullore e Njesisë Kryesore FDSHP"</i> <i>Evidenca nr.13 "Rregullore e Programit të Studimit Msc në "E Drejtë Penale"</i> <i>Evidenca nr.80 "Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB"</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët	Studentët vihen në dijeni që në fillim të vitit akademik mbi format e kontrollit të njohurive, metodologjinë e testimit si dhe

informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	sistemin e vlerësimit. Metodologjia e testimit dhe vlerësimit të njohurive parashikohet në një sërë aktesh rregullatore si Rregullorja e KUB, Rregullorja e njësisë kryesore FDSHP, etj. Gjithashtu institucioni ka hartuar dhe vë në zbatim një rregullore të posaçme për zhvillimin e provimeve. Publikimi i akteve rregullatore në faqen web të institucionit lehtëson njohjen dhe aksesimin nga studentët. Metodologjia e testimit dhe vlerësimit të njohurive është komponent i syllbusit të lëndëve me të cilën studentët paisen nga pedagogët e lëndëve që në fillim të procesit akademik. <i>Evidenca nr. 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e Njësisë Kryesore FDSHP"</i> <i>Evidenca nr. 32.4 "Syllabuset e lëndëve moduleve të programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr.161 "Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në "E drejtë Penale"</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Mënyra e kontrollit të dijeve parashikohet në aktet rregullatore si dhe syllabusin/modulet e lëndëve dhe planin mësimor të programit. Sistemi i testimit dhe vlerësimit të dijeve në këtë program, është i tillë që mundëson vlerësimin e studentit dhe angazhimin e tij gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit. Vlerësimi përfundimtar ka si pjesë të tij edhe elementët e vlerësimit të vazhduar. Këta komponentë kanë një ngarkesë prej 40 pikësh. Vlerësimi i vazhduar i jep mundësi studentit të demonstrojë njohuritë e fituara nëpërmjet përgatitje së eseve/detyrave të kursit, pjesëmarrjes dhe angazhimit aktiv në leksione dhe seminare. Në këtë mënyrë studentit i jepet mundësia të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. <i>Evidenca nr.151 "Formular i vlerësimit të vazhduar TIP"</i> <i>Evidenca nr. 161 "Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në "E drejtë Penale"</i> <i>Evidenca nr.13 "Rregullore e Programit të Studimit Msc në "E Drejtë Penale"</i>
Konkluzione	<i>Testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve në këtë program studimi është objekt rregullimesh nga një sërë aktesh rregullatore.</i> <i>Institucioni ka hartuar dhe vë në zbatim edhe një rregullore të posaçme mbi zhvillimin e provimeve.</i>

	<i>Institucioni zbaton procedurat e testimit të njohurive në lëndët/modulet përkatëse si dhe informon studentët mbi to që në fillim të procesit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentit ka gjetur sanksionim në një bazë të gjerë rregullatore. Një sërë rregulloresh si Rregullorja e FDSHP, Rregullorja e Departamentit të Drejtësisë dhe ajo e programit të studimit Msc në “E drejtë Penale”, përcaktojnë qartë menyrat e vlerësimit të studentëve. Në këtë program studimi vlerësimi i studentëve bazohet në vlerësimin e vazhdueshëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së lëndës si dhe vlerësimin në provimin përfundimtar. Format e testimit/vlerësimit të njohurive janë: zhvillimi i kolokiumit, testimi i ndërmjetëm, detyra kursi/ese, angazhime në seminare dhe frekuentim lënde, të cilat kanë një peshë prej 40 % të totalit të rezultatit të lëndës. Në këtë mënyrë sistemi i vlerësimit teston studentin gjatë gjithë procesit akademik dhe i jep atij mundësinë të shfaqë njohuritë dhe dijet e tij gjatë këtij procesi. Më tej ky vlerësim i shtohet vlerësimit në provimin përfundimtar të lëndës, me një peshë prej 60% të rezultatit të lëndës. Sistemi i testimit dhe vlerësimit të njohurive është pjesë dhe detajohet në syllabuset/modulet e lëndëve të këtij programi. <i>Evidenca nr.151 “Rregullore e Programit të Studimit”</i> <i>Evidenca nr.152 “Procesverbal i provimit përfundimtar_TIP”</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Mënyra dhe procedura e zhvillimit të testeve parashikohet në një rregullore të veçantë, Rregullorja për zhvillimin e provimeve në KUB. Kjo rregullore përcakton në nivel institucional procedurat dhe modalitetet e zhvillimit të provimeve. Institucioni nuk ka në dispozicion sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, por zbaton procedurat e përcaktuara në rregullore për të mundësuar shmangien e abuzimeve dhe rritjen e transparencës.

	Tezat e provimit përgatiten nga pedagogu përkatës, dhe miratohen nga Pergjegjësi i Departamentit. Mbas shpërndarjes në sallën e provimeve, tezat sekretohen nga Sekretaria Mësimore. Në procesin e provimit nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i telefonave, kopjimi dhe raste të tjera që çenojnë integritetin e provimit. Rezultate e provimit nxirren dhe u bëhen të njohura studentëve në afate të përcaktuara. <i>GVJ i sugjeron institucionit vënien në një kohë sa më të shpejtë në përdorim të sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit të provimeve si një mjet për ritjen e efektivitetit dhe transparencës në këtë proces.</i> <i>Evidenca nr.13 “Rregullore e Programit të Studimit”</i> <i>Evidenca nr.80 “Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB”</i> <i>Evidenca nr.82 “Rregullore e Sekretarisë Mësimore”</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Sistemi i vlerësimit në këtë program studimi është në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi. Komponentë mbi vlerësimin e lëndës/modulit parashikuar në Statut, Rregulloren e KUB, Rregulloren e Programit, Rregulloren e Provimeve, Rregulloren e Sekretarisë Mësimore janë hartuar në frymën e legjislacionit në fuqi. Sistemi i vlerësimit është pjesë e syllabuseve të lëndëve si një rubrike e veçantë “Vlerësimi i Studentit” në të cilin përcaktohet mënyra e vlerësimit përfundimtar. Komponentët e vlerësimit përfundimtar janë vlerësimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi në provimin përfundimtar në raportin 40/60 pikë. Sistemi i vlerësimit i bëhet i njohur studentëve të këtij programi master që në fillim të procesit akademik. <i>Evidenca-nr.-161- Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në “E drejtë Penale”</i> <i>Evidenca nr.13 “Rregullore e Programit të Studimit Msc në “E Drejtë Penale”</i> <i>Evidenca nr.152 “Procesverbal i provimit përfundimtar _TIP”</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi	Korigjimi i tezave dhe vlerësimi i njohurive realizohet nga pedagogët përgjegjës të lëndëve. Pedagogët përgjegjës duhet të nxjerrin rezultatin përfundimtar brenda afateve të përcaktuara. Nga RVB evidentohet se korigjimi i tezave të provimit shoqërohet me komente të pedagogut ku evidentohen pasaktësitë që lidhen me trajtimin e tezës së realizuar nga çdo student. Vlerësimi bëhet për secilin element të tezës dhe më tej,

procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	nxirret rezultati përfundimtar. Në tezë pasqyrohet totali i pikëve të vlerësimit, si shumë e vlerësimit të secilit element të tezës. Gjithashtu në komunikimin e tezës, pedagogu informon studentin për rezultatin dhe mangësitë. <i>Evidenca nr.152 "Procesverbal i provimit përfundimtar_TIP"</i> <i>Evidenca nr.80 "Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB"</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Procesi i testimi të njohurive të studentëve nëpërmjet provimeve përfundimtare apo të ndërmjetme, i nënshtrohet një sërë procedurash për të evituar kopjimin dhe mbarëvajtjen e gjithë procesit. Këto procedura parashikohen në Rregulloren e posaçme mbi zhvillimin e provimeve. Kjo rregullore parashikon një sërë masash që lidhen me vendin e zhvillimit të provimit, fotokopjimin dhe shumëfishimin e tezës së provimit, sekretimin e tezës si dhe mbikqyrjen dhe asistencën në provim, të cilat mundësojnë zhvillimin e provimeve në përputhje me parimet bazë të një procesi të drejtë dhe transparent, si dhe në respekt të parimeve të etikës dhe standarteve akademike. Prezantimi në PPT i detyrave të kursit individualisht ose në grup, eviton gjithashtu fenomenin e kopjimit ose plagjiaturës. Pedagogu i ngarkuar në cilësinë e udhëheqësit shkencor gjithashtu merr masat e nevojshme për të evituar plagjiaturën në punimet e diplomës. <i>Evidenca nr.80 "Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB"</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Procedurat që lidhen me kontrollin e dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve parashikohen në aktet regullatore. Rregullorja e posaçme për zhvillimin e provimeve përcakton se qëllimi i organizimit të provimeve është vlerësimi në mënyrë objektive i dijeve të përfituara nga studentët në përputhje me objektivat e përcaktuar në programet/syllabuset e lëndëve për secilin nga programet që zhvillohen pranë KUB. Për të mundësuar objektivitetin, tezat e provimit përfundimtar përfshijnë elementë mbi dijet e marra gjatë kohëzgjatjes së lëndës/modulit. Tezat e provimit duhet të korrigjohen të sekretuara dhe çsekretohen pasi pedagogu sjell në Sekretarinë Mësimore vlerësimet e studentëve. Rregullorja e posaçme ka përcaktuar edhe afate për korrigjimin e provimeve dhe informimin e studentëve mbi rezultatet e provimit. <i>Evidenca nr.11 "Rregullore e Njesisë Kryesore FDSHP"</i>

	<i>Evidenca nr.80 "Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB"</i> <i>Evidenca nr.10 "Rregullore e KUB"</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	KUB garanton të drejtën e studentëve për tu njohur me rezultatet e vlerësimeve, si dhe të drejtën për rishikimin e tezës apo ankimimin në përputhje me parashikimet e akteve rregullatore. Rregullorja e posaçme mbi zhvillimin e provimeve sanksionon një sërë parashikimesh që lidhen me procesin e provimit dhe vlerësimit, si dhe procedurat dhe autoritet përgjegjësë për zbatimin e tyre. Që në fazën e zhvillimit të provimit, pas marrjes së tezës, studenti ka të drejtë të pyese pedagogun mbi paqartësitë lidhur me kërkesat e tezës dhe të marrë shpjegime. Studentët informohen mbi rezultate e provimit jo më vonë se një javë nga data e provimit. Studentëve u garantohej gjithashtu edhe e drejta për të kërkuar rishikimin e vlerësimit. <i>Evidenca nr.80 "Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB"</i> <i>Evidenca nr.10 "Rregullore e KUB"</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Çdo studenti, i garantohej e drejta për një proces objektiv dhe transparent për rishikim të vlerësimit në përputhje me procedurat e përcaktuara në rregullore. Rregullorja e posaçme mbi zhvillimin e provimeve si dhe Rregullorja e KUB, parashikojnë të gjitha procedurat mbi procesin e ankimimit të rezultateve të provimit deri në arkivimin e dokumentacionit. Studenti ka të drejtë të ankimojë rezultatin brënda 3 ditëve nga data e komunikimit të rezultatit. Ankimimet mbi rezultatet e marra bëhet me shkrim dhe paraqitet në Sekretarinë Mësimore. Më tej, ato depozitohen pranë departamenteve përkatës. Departamentet marrin në shqyrtim kërkesat e studentëve dhe i trajtojnë ato duke ngritur edhe komisionet <i>ad hoc</i> përkatëse për rishqyrtimin e tezave të provimit. Studentët informohen sërish mbi rezultatet e rishikimit të vlerësimit. <i>Evidenca nr.80 "Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB"</i> <i>Evidenca nr.10 "Rregullore e KUB"</i>
Konkluzione	<i>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Sistemi i</i>

	<i>vlerësimit në këtë program studimi është pjesë e syllabuseve të lëndëve në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi.</i> <i>KUB garanton të drejtën e studentëve për tu njohur me rezultate e vlerësimeve, si dhe të drejtën për rishikimin e tezës apo ankimimin në përputhje me parashikimet e akteve rregullatore.</i> <i>GVJ i sugjeron institucionit vënien në një kohë sa më shpejtë në përdorim të sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit të provimeve si një mjet për ritjen e efektivitetit dhe transparencës në këtë proces.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit Mcs në “E Drejtë Penale” ofruar nga Departamenti i Drejtësisë i FDSHP synon të garantojë thellimin e njohurive dhe zhvillojë aftësitë profesionale të studentëve në fushën penale. Ky program ka si objektiv kryesor formimin e ekspertëve dhe specialistëve cilësorë si në aspektet teorike, ashtu edhe në aftësitë aplikative në fushën e të drejtës penale. Në funksion të këtij objektivi kryesor, programi synon pajisjen e studentëve me njohuritë themelore teorike, njohje e thelluar të debateve dhe praktikave bashkëkohore ndërkombëtare si dhe eksperiencës shqiptare në fushën e së drejtës ndërkombëtare penale, kriminalistikës dhe penalogjisë, të drejtës financiare penale, veprave penale në fushën e kibernetikës etj. Në përputhje me objektivat e programit, kurrikula e këtij programi studimi ka në përbërje lëndë ku merren njohuri të thelluara/specializuara në fushën penale si: E Drejta Penale e Avancuar, Procedurë Penale e Avancuar, Kriminologji/ Viktimologji, Kriminalistikë, E Drejta Penale Ndërkombëtare etj. <i>Evidenca nr. 5 “Statuti i KUB”</i> <i>Evidenca nr.40 “Kurrikula e programit të studimit”</i> <i>Evidenca nr.13 “Rregullore e Programit të Studimit”</i>

	<i>Evidenca nr.12 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i>
"Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Ky program studimi është hartuar dhe synon zhvillim të aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve në fushën e të drejtës penale. Programi synon të pregatisë specialistë të aftë për të punuar në sektorin publik dhe atë privat, si dhe specialistë të aftë për vazhdimin e studimeve të mëtejshme në ciklin e tretë të së njëjtës fushë. Programi i studimit Msc në "E drejtë Penale", ka të përfshira në kurrikulën e tij një sërë lëndësh që mundësojnë njohuri të përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në të drejtën penale. Këto njohuri i japin mundësi studentit të aftësohet në fushën e të drejtës penale dhe të fitojë terminologjinë e duhur juridike si dhe aftësinë praktike në këtë fushë. Këtij qëllimi i shërben edhe ndërthurja e njohurive teorike me shprehitë praktike të fushës. Studentët gjatë orëve të mësimi përfshihen në raste studimore; studime në grup; diskutime; organizime dhe hartime të shkresave të ndryshme etj. <i>Evidenca nr.40 "Kurrikula e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr.8 'Plani Strategjik i zhvillimit të programit të studimit'</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Syllbuset e lëndëve kanë në përmbajtje komponentë mbi përmbajtjen e lëndëve, temat e leksioneve si dhe kompetencat dhe aftësitë që synohet të përfitojë studenti. Gjatë gjithë mbarëvajtjes së procesit mësimor, personeli akademik përgjegjës për zbatimin e programit të studimit Msc në "E drejtë Penale" kujdeset që të zbatojë me rigorozitet të gjitha detyrimet e syllabusit të lëndës. Pedagogu përgjegjës nëpërmjet leksioneve dhe seminareve i jep studentit gjithë informacionin e duhur që të jetë i përgatitur për detyrimet përmbyllëse. Elementët që lidhen me përmbajtjen e lëndës, format e kontrollit të dijeve dhe detyrimet përmbyllëse u bëhen të njohura studentëve që që në fillim të procesit akademik. Në fund të procesit të mesimit pedagogu përgjegjës bën një përmbledhje të të gjithë procesit dhe njohurive të fituara gjatë lëndës si dhe orienten studentët për zbatimin dhe plotësimin e detyrimeve përmbyllëse. <i>Evidenca nr.42 "Syllabus-et e Lëndëve/Moduleve të programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr.161 "Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në "E drejtë Penale"</i> <i>Evidenca nr.11 "Rregullore e Njësisë Kryesore FDSHP"</i>

	<i>Evidenca nr.13 "Rregullore e Programit të Studimit"</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Ky program ka si objektiv formimin e specialistëve cilësorë si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik në fushën e të drejtës penale. Në përputhje me këtë objektiv, mësimdhënia në këtë program realizohet mbi bazë kompetencash që synojnë tu mundësojnë studentëve fitimin e njohurive teorike dhe shprehive profesionale. Infrastruktura e përshtatshme e institucionit dhe paisja me mjetet teknologjike mundëson përdorimin e metodave të reja në mësimdhënie si: përdorimi i mjeteve audio-vizive; paraqitja e detyrave të kursit në PPT etj. Institucioni nxit metodat innovative të të nxënësve si ndërthurja e teorive me shembuj praktikë për të rritur nivelin dhe cilësinë; nxitjen e ideve nëpërmjet punës në grup, përshtirjen në projekte kurse apo vizitave në zyrë profesionale etj. Për të mundësuar përgatitjen praktike të studentit, KUB i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të praktikave profesionale, falë bashkëpunimit që ka me institucione publike e private. <i>Evidenca nr.146 "Relacion për Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare që janë zhvilluar në KUB përgjatë"</i> <i>Evidenca nr.23 "Model marrëveshjeje TIP-KUB me ALBiznes, Sipërmarrje, OJF, etj"</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Një aspekt i rëndësishëm i vëmëritarisë akademike të KUB është kërkimi shkencor. Si pjesë e trupës pedagogjike të KUB, anëtarët e Departamentit të Drejtësi që mbulojnë programin Msc në "E Drejtë Penale", krahas procesit mësimor-akademik, fokusohen individualisht edhe në kërkimin shkencor. Ata marrin pjesë me punime dhe prezantime në konferencat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare që organizohen nga KUB. Personali akademik i KUB mund të botojë pa pagesë punime shkencore në "Revisten Shkencore të Studimeve Profesionale", në "proceedings", botim periodik i KUB. Gjithashtu KUB mbështet personelin akademik i cili boton punimet në revista të tjera shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Nëse botimet realizohen në revista me Faktor Impakti dhe të indeksuara në Scopus, kostot e botimit të tyre mbulohen nga KUB. Nga takimi i GVJ me personelin akademik u pohua se pedagogët angazhohen në zhvillimin e orëve të hapura dhe seminareve. Gjithashtu KUB ka bashkëpunim edhe me institucione të tjera të specializuara si ISAB (Instituti për Studime dhe Aplikime në Biznes) i cili ka

	mundësuar përfshirjen si trajnerë edhe të personelit akademik të KUB. <i>Evidenca nr.105 "Lista e personaliteteve të ftuar për Leksione të Hapura KUB"</i> <i>Evidenca nr.68 "Udhëzues institucional për zhvillimin dhe përdorimin e "GOOGLE APPS", portali KUB"</i> <i>Evidenca nr.146 "Relacion për Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare që janë zhvilluar në KUB përgjatë"</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	KUB nxit zhvillimin e ideve inovative, si dhe veprimtarive kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet ato. Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës ka në fokus të veprimtarisë së saj ofrimin e informacioneve reth mundësive që institucioni në bashkëpunim me partnerët ofron, përfshirë trajnimet apo aktivitete shkencore të ndryshme. Kjo zyrë ka një rubrikë të dedikuar në web si dhe në rrjetin social Facebook ku shpërndan informacione. Nëpërmjet bashkëpunimit midis Qeverisë Studentore dhe ZKSHP, studentëve u jepet mundësia të angazhohen në programet Erasmus+ për mobilitetin e studentëve. KUB organizon konferencave studentore dhe u mundëson studentëve paraqitjen mendimeve dhe ideve të tyre. <i>Evidenca nr. 14 "Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës"</i> <i>Evidenca nr.49 "Program i Konferencës Shkencore Studentore"</i> <i>Evidenca nr.98 "Botime Proceedings i Konferencës së IX-të Shkencore Ndërkombëtare"</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Mcs në "E Drejtë Penale" ofruar nga Departamenti i Drejtësisë i FDSHP synon të garantojë thellimin e njohurive dhe zhvillojë aftësitë profesionale të studentëve në fushën penale.</i> <i>Në përputhje me kriteret ligjore, kompetencat dhe aftësitë që synohet të përfillojë studenti nga ky program janë pjesë e përmbajtjes së programit dhe syllbuseve të lëndëve/moduleve.</i> <i>KUB nxit dhe mbështet zhvillimin veprimtarive kërkimore e shkencore për personelin akademik dhe studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Në aktet rregullatore të brendshme, KUB ka hartuar procedura që mbulojnë gjithë ciklin akademik të studentëve deri në diplomim. Procedurat që lidhen me përmbylljen e detyrimeve dhe diplomimin e studentëve, si pjesë e akteve rregullatore, bëhen të njohura e publike për studentët. Studentët marrin dijeni që në fillim të procesit akademik mbi të gjitha aspektet dhe detyrimet që lidhen me procesin dhe veprimtarinë mësimore deri në përmbylljen e këtij procesi. Gjithashtu, publikimi i akteve rregullatore në faqen zyrtare web të institucionit i bën ato lehtësisht të aksesueshme. Në programin e ciklit të dytë Msc në “E drejtë Penale”, detyrimet përmbyllen me përgatitjen dhe mbrojtjen e një teze diplome, të punuar nga studenti. Në planin mësimor dhe kurrikulën e këtij programi përcaktohet shuma e krediteve të detyrimeve përmbyllëse. Procedura të detajuara që lidhen me mbrojtjen e temës së diplomës parashikohen në Rregulloren e KUB, Kreu XIV “Diplomimi”, nenet 102-107; si dhe Rregulloren e Departamentit, neni 31-32. Procedura mjaft të detajuara parashikon edhe Paketa udhëzuese për mbrojtjen e temës së diplomës. <i>Evidenca nr. 4 “Rregullore e KUB”</i> <i>Evidenca nr. 6 “Rregullore e Departamentit të Drejtësisë”</i> <i>Evidenca nr.163 ‘Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë’</i> <i>Evidenca nr.162 “Urdhër për ngritjen e komisionit të provimit për mbrojtje diplome”</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Departamenti i Drejtësisë nëpërmjet pedagogëve udhëheqës, mundëson mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Bazuar në Rregulloren e Departamentit, ky i fundit është përgjegjës për të përcaktura tematikën e punimeve për mbrojtjen e temës së diplomës. Në semesrin e parë të vitit të dytë të këtij programi studimi Departamenti vë në dispozicion të studentëve temat e përzgjedhura të cilat shërbejnë si orientim për përzgjedhjen e temave individuale. Personeli akademik asiston studentët gjatë gjithë procesit duke

	vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të përgatitjes së mikrotezës së diplomës. <i>Evidenca nr. 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i> <i>Evidenca nr.163 "Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë"</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Përzgjedhja e temave të diplomës realizohet duke u bazuar në fushat e lëndëve ose gruplëndëve që studenti ka zhvilluar si pjesë e kurrikulës së këtij programi. Për fitimin e diplomës së ciklit të dytë në këtë program studimi, parashikohet përgatitja e një teze diplome, të punuar në mënyrë individuale e të pavarur nga studenti. Udhëzuesi për mbrojtjen e diplomës me temë përcakton detaje mbi detyrat e Komisionit të mbrojtjes së diplomës. Komisioni i ngritur për zhvillimin dhe administrimin e procesit të mbrojtjes së tezës së diplomës në këtë program studimi përbëhet nga 3 anëtarë (1 kryetar dhe 2 anëtar) që janë personel akademik efektiv në Departamentin e Drejtësisë. Komisioni administron punimet duke respektuar standartet dhe kriteret e përcaktuara për temat e diplomës. Studentit i krijohet mundësia për të referuar punimin e tij, i përgjigjet pyetjeve të komisionit, i cili duke u mbështetur edhe në vlerësimin e udhëheqësit të temës, vendos për vlerësimin përfundimtar të çdo studenti. Vlerësimi plotësohet në procesverablin përkatës. <i>Evidenca nr.163 "Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë"</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Paketa udhëzuese për mbrojtjen e diplomës përcakton një sërë detyrimesh për udhëheqësit e temës së diplomës. Udhëheqësit e temës së diplomës të miratuar nga strukturat përgjegjëse akademike i mundësojnë studentëve që të kenë konsultimet dhe mbështetjen e duhur gjatë gjithë procesit të përgatitjes së temës për realizimin e punimit të diplomës konform kërkesave të kërkitit shkencor. Udhëheqësi jep mbështetjen dhe konsulencën e nevojshme që ti mundësojë kandidatit të arrijë standartet e kërkuara të kërkitit shkencor. Kjo përfshin ndihmën për strukturën e projektit, metodologjinë, i orienton studentët drejt literaturës që ata duhet të lexojnë në funksion të temës. Për këtë qëllim, udhëheqësi mban takime të rregullta me studentin dhe ndjek ecurinë e punës së tij kërkimore. Udhëheqësi ndihmon dhe orienton studentin edhe në përgatitjen e prezantimit të punimit para Komisionit. Në përfundim të punimit të temës së diplomës së studentit, pedagogu udhëheqës plotëson një formular

	vlerësimi për çdo student që ka nën udhëheqje, në të cilin shpreh mendimin e tij objektiv dhe të pavarur. <i>Evidenca nr.163 "Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë"</i> <i>Evidenca nr.162 "Urdhër për ngritjen e komisionit të provimit për mbrojtje diplome"</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Për shkak të natyrës së tij, në këtë program studimi nuk përfshihen tema që kërkojnë kryerje të matjeve, analizave apo testeve. KUB asiston dhe lehtëson procesin e diplomimit të studentëve të këtij programi duke garantuar mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën nga ana e personelit akademik nëpërmjet pedagogut udhëheqës. Studentëve u mundësohet shfrytëzimi pa pagesë i mjediseve që KUB vë në dispozicion për studentët si laboratorët e informatikës, bibliotekën, përfshirë edhe bibliotekën online.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi i punimit të diplomës realizohet nga Komisioni i Mbrojtjes së Diplomes, i cili përbëhet nga jo me pak se 3 anëtarë. Ky komision ka për detyrë të bëjë vlerësimin individual për çdo student. Për vlerësimin e temave të diplomës, komisionet e vlerësimit konsiderojnë punimin e paraqitur dhe të drejtuar nga pedagogu udhëheqës. Përpara vlerësimit përfundimtar, komisioni kërkon edhe vlerësimin nga udhëheqësi përkatës. Në procesin e vlerësimit komisioni, në përputhje me Udhëzimin për mbrojtjen e temave të diplomave, merr në konsideratë një sërë kriteresh si origjinalitetin e punimit, qasjen kritike të çështjes, dobishmërinë e tij shkencore, cilësinë e të shkruarit si dhe cilësinë e prezantimit. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e thjeshtë e vlerësimit të gjithë anëtarëve të komisionit dhe i bëhet e ditur studentit ose ditën e mbrojtjes së punimit të diplomës, ose një ditë pas prezantimit të saj nga sekretaria mësimore e FDSHP. <i>Evidenca nr.10 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr.163 "Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë"</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve, institucioni pais me diplomë çdo student të këtij programi. Për tu paisur me diplomë, studenti duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e planit mësimor, përfshirë dhe mbrojtjen e testit ndërkombëtar të gjuhës së huaj sipas udhëzimit përkatës. Studenti i cili i ka plotësuar të gjitha detyrimet e programit pajiset nga KUB me Diplomë "Master

Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<i>i Shkencave</i>". Pas përfundimit të studimeve, studenti përveç listës së notave me modulet që ka zhvilluar, merr edhe suplementin e diplomës ku përshkruhen modulet me përmbajtjen e tyre të vulosura. Përmbajtja, forma e diplomës dhe e suplementit të diplomës miratohen nga Senati Akademik i KUB, në përputhje me udhëzimet e MAS dhe regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Diplomave dhe Certifikatave pranë kësaj Ministrie. Elementët përbërës, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. <i>Evidenca nr.11 "Rregullore e Njesisë Kryesore FDSHP"</i> <i>Evidenca nr.13 "Rregullore e Programit të Studimit"</i> <i>Evidenca nr.48 "Model Diplome MSc në E drejtë Penale"</i> <i>Evidenca nr.47 "Diploma Supplement MSc në E drejtë Penale"</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Struktura përgjegjëse për administrimin e dokumentacionit është Sekretariteti Mësimorë e FDSHP. Sekretaria Mësimorë ushtron detyrën dhe kompetencat bazuar në Rregulloren për Sekretarinë Mësimorë. Sekretaria administron dokumentacionin e studentit që në momentin e regjistrimit dhe në vijim, deri në përmbylljen e detyrimeve dhe diplomimit. Sekretaria administron dhe arkivon dosjen e studentit në përputhje me aktet e brendshme rregullatore, legjislacionin në fuqi dhe ligjin për arkivat. Dosja e studentit arkivohet duke u transferuar në zyrën e arkivit të KUB kur studenti diplomohet/transferohet/ç'rregjistrohet. Dosja individuale e studentit arkivohet duke i bashkangjitur edhe fotokopje të diplomës dhe suplementit në dosjen e tij. <i>Evidenca nr.16 "Rregullore e Zyrës së Arkivit"</i> <i>Evidenca nr.82 "Rregullore e Sekretarisë Mësimorë"</i> <i>Evidenca nr.38 "Dosja e Programit të Studimit MSc në E drejtë Penale"</i>
Konkluzione	<i>Institucioni ka bërë pjesë të akteve rregullatore të brendshme si dhe zbaton procedura që i referohen detyrimeve përmbyllëse të studentëve deri në diplomim.</i> <i>Në programin e ciklit të dytë Msc në "E drejtë Penale", detyrimet përmbyllen me përgatitjen dhe mbrojtjen e një teze diplome, të punuar nga studenti.</i>

	<i>Nëpërmjet pedagogëve udhëheqës, studentëve u mundësohet mbështetja, udhëzimi dhe orientimi në procesin e përgatitjes së temës dhe në procesin e diplomimit.</i> <i>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës në përputhje me kriteret ligjore në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	N / A
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N / A
Kriteri 3. Praktikë profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë	N / A

studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione	<i>Kriteret e lidhura me këtë standard janë të pa aplikueshme për këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1			
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit	Programi i studimit Msc në “E drejtë Penale” zhvillohet pranë Departamentit të Drejtësisë të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Politike të KUB. Nga të dhënat e dosjes së vetvlerësimit rezulton se Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit, ka në përbërje të tij 13 anëtarë prej të cilëve, 7 personel akademik me kohë të plotë (PAE) dhe 6 personel akademik me kontratë (PAK), cilët kanë kualifikimin si më poshtë.		
	Titujt Grada	Departamenti i Drejtësisë	
		PAE	PAK

akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Prof.Dr.		1
Prof.As.	1	
Dr/Phd.	5	2
Msc.	1	3
Totali	7	6

Për sa i takon personelit akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi, për gjatë viteve akademike, të dhënat mbi kualifikimin shkencor janë si vijon:

Tituj/ grada	2019-2020		2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.		1		1		1		2		1
Prof. Asoc.	1		1		1	1	2		1	
Dr./PhD.	6	4	5	3	4	5	3	6	3	5
Msc.										
Totali	7	5	6	4	5	7	5	8	4	6

Nga sa më sipër personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në procesin e mësimdhënies gëzon minimalisht gradën shkencore “Doktor”, ose titujt akademik “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”. Për rejedhojë plotëson kriteret ligjore mbi nivelin e duhur të kualifikimit akademik mbi personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi.

Evidenca nr. 116 “Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në “E drejtë penale” fq. 1-10”, tabela 2, tabela 6.1-6.3, tabela 7”.

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Personeli akademik që mbulon programin estudimit përbëhet si nga personel akademik me kohë të plotë, ashtu edhe nga personel akademik me kontratë. Nga të dhënat mbi stafin akademik që mbulon këtë program studimi konkludohet se në programin e studimit Msc në “E drejtë Penale” janë angazhuar (tabela më sipër):

- Për vitin akademik 2019-2020 në total 12 pedagogë , ndër të cilët **7 PAE/ 5PAK.**
- Për vitin akademik 2020-2021 në total 10 pedagogë , ndër të cilët **6 PAE/ 4PAK.**

- Për vitin akademik 2021-2022 në total 12 pedagogë , ndër të cilët **5 PAE/ 7PAK.**
- Për vitin akademik 2022-2023 në total 13 pedagogë , ndër të cilët **5 PAE/ 8PAK.**
- Për vitin akademik 2023-2024 në total 10 pedagogë , ndër të cilët **4 PAE/ 6PAK.**

Për sa i takon mbulimit të ngarkesës mësimore, referuar të dhënave të institucionit, raporti PAE/PAK në mbulimin e ngarkesës mësimore në këtë program studimi, sipas viteve akademike është si vijon:

Viti	Orë total	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2019-2020	920	460	460	50%/50%
2020-2021	920	588	332	64%/36%
2021-2022	920	384	536	42%/58%
2022-2023	920	316	604	35%/65%
2023-2024	920	384	536	42%/58%

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se për tre vite akademike (2021-2022, 2022-2023, 2023-2024) numri i PAE të angazhuar në programin e studimit është më i vogël në raport me numrin e PAK të angazhuar në këtë program.

Për sa i takon ngarkesës mësimore, gjithashtu rezulton se, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, nuk është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë në përputhje me rregullimet e VKM Nr. 418, datë 10.05.2017, ku parshikohet se: "Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi".

GVJ rekomandon që në shpërndarjen e ngarkesës mësimore të rishikohet raporti midis PAE dhe PAK në këtë program studimi, në mënyrë që ngarkesa e realizuar nga PAE i angazhuar në procesin e mësimdhënies të përputhet me kriteret ligjore që i referohen mbulimit të ngarkesës mësimore.

Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq. 1-10, tabela, 12.2".

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Nëpërmjet akteve të brendshme institucioni mundëson qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit për gjithë periudhën e akreditimit. Me qëllim garantimit të stafit akademik të kualifikuar dhe qëndrueshmërinë në detyrë, aktet e brendshme përmbajnë rregullime lidhur me procedurat e rekrutimit të stafit akademik, kohëzgjatjen e marëdhënieve të punës, si dhe të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik. Statuti i KUB në kreun V të tij, trajton çështje të punësimit të personelit akademik dhe atij më kontratë, statusin, kohëzgjatjen e marëdhënieve të punës, hartimin e kontratës së punës etj. Rregullime të ngjashme parashikohen edhe në kreun VIII të Rregullores së KUB. Aspekte mjaft të detajuar të procedurave lidhur me punësimin dhe të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësve, gjenden në Rregulloren e marëdhënieve të punës në KUB e cila ka si objekt: “Përcaktimin e rregullave për kushtet, procedurat, të drejtat dhe detyrimet lidhur me procesin e përzgjedhjes, fillimin, vazhdimësinë dhe mbarimin e marëdhënieve të punës”. Institucioni harton dhe administron kontratat individuale të punës si për PAE, ashtu edhe PAK. Njëkohësisht administron dokumentacionin mbi dosjet personale si për personelin akademik, ashtu edhe për atë ndihmës akademik dhe administrativ. <i>Evidenca nr. 1 “Statuti i KUB”</i> <i>Evidenca nr. 4 “Rregullore e KUB”</i> <i>Evidenca nr. 12 “Rregullore e marëdhënieve të punës në KUB”</i> <i>Evidenca nr. 78 “Kontratë pune FT_tip”</i> <i>Evidenca nr. 79 “Kontratë punë PT-tip”</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet	Referuar Statutit të KUB, punësimi i personelit akademik bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e arsimit të lartë si dhe legjislacionit mbi marëdhëniet e punës. Rregullorja e posaçme për marëdhëniet e punës përcakton kriteret e përgjithshme të punësimit për të gjithë personelin e KUB, ku përfshihen kriteri i shtetësisë ose rezidencës, zotësisë së plotë për të vepruar, kërkesat për nivelin arsimor dhe aftësinë profesionale në përputhje me vendin e punës, njohja e legjislacionit për arsimin e lartë. Për personelin akademik me kohë të plotë dhe kontratë kriteret specifike përcaktohen nga njësia bazë, në përputhje me nevojat e saj, miratohen nga njësia kryesore dhe aprovohen nga Rektori. Për të mundësuar transparencën, kriteret e përzgjedhjes shpallen nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe publikohen në website-in zyrtar të të paktën 10 ditë përpara datës së zhvillimit të konkursit.

dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Përzgjedhja e personelit akademik bëhet me konkurim, për zhvillimin dhe administrimin e të cilit ngrihet një komision ad hoc, i përbërë nga tre anëtarë. Konkursi realizohet në disa faza, nga të cilat faza e parështë ajo e renditjes nëpërmjet dosjes. Faza e dytë përfshin testimin me gojë dhe me shkrim. Për të testuar aftësitë profesionale dhe ato të mësimdhënies së kandidatëve, neni 12/2/b parashikon të drejtën e komisionit ad hoc të kërkojë kandidatëve zhvillimin e një leksioni të hapur. Rregullorja e posaçme “Për marrëdhëniet e punës” parashikon detaje mbi mënyrat e vlerësimit të kandidatëve, emërimit të atyre fitues, sidhe fillimit të marrëdhënies të punës <i>Evidenca nr.1 “Statuti i KUB”</i> <i>Evidenca nr. 4 “Rregullore e KUB”</i> <i>Evidenca nr. 12 “Rregullore e marrëdhënies të punës në KUB”</i> <i>Evidenca nr. 85 “Një praktikë e rekrutimit të stafit akademik në KUB”</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në organikën e Departamentit të Drejtësisë nuk ka personel ndihmës akademik për mbarëvajtjen e këtij programi studimi. Natyra e programit është e tillë që nuk përfshin orë laboratorike. Institucioni ka si pjesë të infrastrukturës së tij edhe laboratorët informatikë të paisur me kompjutera të cilët janë në dispozicion edhe të studentëve të këtij programi studimi. Në këto laboratorë studentët mund të punojmë për përgatitjen e detyrve të kursit, prezantimeve apo detyrimeve të tjera të ngarkuara nga pedagogët. Për mirëmbajtjen dhe administrimin e këtyre laboratorëve institucioni ka vënë në dispozicion personel ndihmës. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore dhe struktura të tjera të shërbimeve në kuadrin e kompetencave të tyre kontribuojnë në mbarëvajtjen emjedisve në funksion të procesit mësimor në këtë program studimi. <i>Evidenca 80 “Relacion mbi infrastrukturën e KUB”</i> <i>Evidenca nr. 116 “Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në “E drejtë penale” fq 11-23, tabela 16”</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e	Zyra e Burimeve Njërëzore administron të gjitha të dhënat lidhur me burimet njerëzore në përputhje me legjislacionin mbi arsimin e lartë, legjislacionin mbi marrëdhëniet e punës dhe aktet e brendshme rregullatore. Kjo zyrë është përgjegjëse edhe për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave mbi personelin akademik, atë ndihmës akademik dhe administrativ të përfshirë në këtë program studimi. Zyra e Burimeve Njërëzore jo vetëm administron të dhënat mbi burimet njerëzore, por i përditëson këto të dhëna në mënyrë të vazhdueshme duke pasqyruar edhe ndryshimet, përfshirë

personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	kualifikimet, lëvizjet paralele, ngritjet në detyrë etj. Nga verifikimi i kryer nga GVJ u konstatua se dosjet e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përmbajnë dokumentacionin e nevojshëm dhe administrohen në përputhje me kriteret ligjore. Si njësia përgjegjëse për administrimin e programit, Departamenti i Drejtësisë gjithashtu harton dhe administron statistika lidhur me stafin akademik si PAE, ashtu edhe PAK të përfshirë në programin e studimit. Në dokumentacionin e Departamentit pasqyrohen të dhëna mbi kualifikimin shkencor, lëndët dhe ngarkesën mësimore për çdo semestër dhe vit akademik, madje edhe të dhëna të detajuara si ato që lidhen me grupmoshën e stafit të angazhuar. <i>Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 1-10".</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Praktika profesionale është pjesë e kurrikulës së programit mësimor MSC në "E drejtë Penale" me një total prej 10 kreditesh. Në këtë program studimi praktika zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë. Praktika vlerësohet me notë, njësoj si detyrimet e tjera. Aspekte rregulluese të zhvillimit të praktikës profesionale parashikohen në Rregulloren e Departamentit (neni 30) ku përcaktohen detaje mbi procedurat dhe përgjegjësitë e Departamentit për realizimin e praktikës profesionale. Departamenti i Drejtësisë është përgjegjës për ndjekjen dhe zhvillimin e praktikës profesionale nga studentët. Përgjegjësi i Departamentit realizon shpërndarjen e studentëve dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe sigurimin e mbarëvajtjes së praktikës. Përcaktimi i institucionit/kompanisë ku studenti do të zhvillojë praktikën mundësohet nga Departamenti, bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura për këtë qëllim. Për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me praktikën profesionale, janë lidhur një sërë marrëveshjesh me institucione publike dhe private. Praktika profesionale zhvillohet në kompani private, institucione publike, studio apo OJF të caktuara nga institucioni ose të propozuara nga studentët. Zhvillimi i praktikës realizohet nën mbikëqyrjen e pedagogut përgjegjës të caktuar nga Departamenti. Gjatë kohës së zhvillimit të praktikës, pedagogu përgjegjës i caktuar nga Departamenti ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me kordinatorin e praktikës së subjektit ku kryhet praktika. Rregullime të hollësishme mbi zhvillimin e praktikës përcaktohen në akte të posaçme të KUB. <i>Evidenca nr. 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i> <i>Evidenca nr. 23 "Model marrëveshje TIP-KUB me IALBisnes, Sipërmarrje, OJF etj"</i>

	<i>Evidenca nr. 27 "Udhëzues për zhvillimin e praktikës profesionale"</i> <i>Evidenca nr. 27.2 "Marëveshje bashkëpunimi TIP për Praktikën Profesionale"</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Për zhvillimin dhe mbikqyrjen e praktikës profesionale Departamenti harton listën e kompanive/ institucioneve ku do të zhvillohet praktika. Marëveshjet e bashkëpunimit të lidhura në nivel institucional kanë në përmbajtje detyrime që i referohen edhe kompanive apo institucioneve ku do të zhvillohet praktika profesionale. Kompanitë apo institucionet ku zhvillohet praktika duhet të caktojnë një person përgjegjës në rolin e kordinatorit pritës i cili asiston studentët gjatë kohëzgjatjes së praktikës. Kordinatori mbikqyr studentët gjatë kohëzgjatjes së praktikës dhe mban lidhje me pedagogun përgjegjës për aspekte që lidhen me mbarëvajtjen e praktikës. Në vlerësimin përfundimtar të praktikës merret në konsideratë edhe vlerësimi i bërë nga kordinatori i caktuar nga subjekti pritës. <i>Evidenca nr. 27 "Udhëzues për zhvillimin e praktikës profesionale"</i> <i>Evidenca nr. 27.2 "Marëveshje bashkëpunimi TIP për Praktikën Profesionale"</i>			
Konkluzione	<i>Personeli akademik që mbulon këtë program studimi përmbush standartet e kërkuara ligjore në lidhje me nivelin e kualifikimit akademik si dhe përputhjen me natyrën dhe përmbajtjen e programit. Institucioni ka hartuar dhe zbaton procedurat e nevojshme që i referohen rekrutimit, promovimit dhe kualifikimit të vazhdueshëm të personelit akademik si dhe garanton qëndrueshmërinë e tij në detyrë.</i> <i>GVJ rekomandon që Institucioni të marrë masat e nevojshme për të mundësuar përmbushjen e standartit mbi raportin midis PAE dhe PAK në përbërjen e departamentit në përputhje me standartet e kërkuara.</i> <i>GVJ rekomandon gjithashtu që Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë përgjegjëse të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës mësimore të këtij programi midis PAE dhe PAK në këtë program studimi, në mënyrë që ngarkesa e realizuar nga PAE i angazhuar në procesin e mësimdhënies të përputhet me kriteret ligjore që i referohen mbulimit të ngarkesës mësimore (70%).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Programi Msc në “E drejtë Penale” zhvillohet në hapësirat dhe infrastrukturën që KUB ka vendosur në dispozicion të procesit të mësimdhënies për programet e studimit që ofron. Hapësirat që i dedikohen edhe zhvillimit të veprimtarisë mësimore në KUB shtrihen në një sipërfaqe prej 2051 m². Prej tyre, për zhvillimin e procesit mësimor në këtë program studimi janë në dispozicion 4 salla leksionesh me sipërfaqe 261m², si dhe 8 salla seminaresh me sipërfaqe 337 m². Në këto mjedise janë ngritur dhe funksionojnë 4 laboratorë nga të cilët, dy janë laboratorë informatike, këta të fundit në një sipërfaqe prej 85 m². Institucioni disponon gjithashtu një sërë mjedisesh në funksion të procesit mësimor si, një sallë biblioteke me sipërfaqe 47m², mjedis për fotokopjime, librari me sipërfaqe 26m², zyrë informacioni për studentët me sipërfaqe 4m² etj. Mjediset e vëna në dispozicion për stafin akademik, atë ndihmës akademik dhe administrativ të cilat përbëhen kryesisht nga zyra, janë në total 211 m². Të gjitha hapësirat janë të paisura me mjetet e nevojshme që mundësojnë zhvillimin normal të aktivitetit mësimdhënës dhe atij mbështetës për stafin akademik dhe studentët. Zhvillimi i procesit mësimor në dy turne në varësi të programeve të studimit, ka mundësuar që kapacitetet që KUB disponon, të plotësojnë normativat ligjore për sipërfaqet e shfrytëzueshme. Mësimi në këtë program studimi zhvillohet kryesisht në orarin e mbasdites. <i>Evidenca nr. 80 “Relacion mbi infrastrukturën e KUB”</i> <i>Evidenca nr. 116 “Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në “E drejtë penale” fq 11-23, tabela 16”.</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e	Të gjitha mjediset mësimore në funksion të procesit mësimor në këtë program studimi janë paisur me mjetet didaktike që mundësojnë përdorimin e teknologjisë, metodave inovative të mësimdhënies si dhe realizimin me sukses të programit të studimit. Si studentët ashtu edhe stafi akademik, kanë akses në këto sisteme. Të gjitha sallat dhe ambientet e mësimdhënies janë të paisura me kopjuterat Lab Top, video projektorë, kamera si dhe tabelat shkrimi. Në të gjitha

procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	ambientet funksionon sistemi i palimituar në internet si dhe sistemi ikondicionimit. Ambientet e zhvillimit të mësimdhënies, por edhe mjediset e tjera në funksion të procesit të mësimdhënies, kanë akses të palimituar në internet. Në godinën ku zhvillohet procesi mësimor funksionon edhe sistemi i Gjenrator-Stabilizuesve për mundësimin e pandërprerë të energjisë elektrike. Godina është gjithashtu e paisur me sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit, shkallët e emergjencës, sistemin e fonisë etj. <i>Evidenca nr. 1 "RVB Master i Shkencave E drejtë Penale"</i> <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 11-23, tabela 16".</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Mjediset në funksion të procesit të mësimdhënies janë të paisura me të gjitha mjetet e nevojshme dhe të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të aftësimit të studentëve në përputhje me objektivat formues të programit Msc në "E Drejtë Penale". Të gjitha mjediset e mësimdhënies janë të paisura me mjete audiovizive, kompjutera si dhe akses të palimituar në internet. Të gjitha paisjet kompjuterike janë të lidhura dhe mundësojnë aksesin në internet. Jo vetëm auditorët e mësimdhënies, por të gjitha mjediset e godinës janë të mbuluara me wi-fi. Pasi të tilla mundësojnë zhvillimin e procesit të mësimdhënies në kushte optimale si dhe përdorimin e metodave interaktive të mësimdhënies, demonstrimin e materialeve si raste nga praktika, dokumentacionin gjyqësor etj, të cilat i shërbejnë aftësimit praktik të studentëve. Mjetet e nevojshme teknologjike u mundësojnë edhe studentëve një pjesëmarrje më aktive në procesin mësimor si p.sh. nëpërmjet prezantimit të detyrave të kursit, eseve etj. <i>Evidenca nr. 1 "RVB Master i Shkencave E drejtë Penale"</i> <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 11-23, tabela 16".</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale	Konsideruar natyrën e programeve të studimit që ofron, KUB ka përshtatur mjediset e mësimdhënies me nevojat akademike dhe ato të formimit profesional të studentëve. Për realizmin e këtij qëllimi, në mjediset e KUB janë ngritur dhe funksionojnë 4 laboratorë, nga të cilët dy janë laborator informatike. Njëri

sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	prej laboratorëve ka 20 complete kompjuterash (PC) dhe laboratorit tjetër ka 50 të tillë. Laboratorët e informatikës mund të përdoren edhe nga studentët e këtij programi studimi. Në mjedisete laboratorëve ata mund të përdorin kompjuterat për marrjen e informacioneve nga interneti, hartimin e detyrave të kursit apo përmbushjen e detyrimeve të tjera të dhëna nga pedagogët. <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 11-23, tabela 16".</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	KUB zotëron mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarive të mësimdhënies dhe veprimtarive të tjera mbështetëse në funksion të procesit mësimor në këtë program studimi. Për shkak të natyrës së këtij programi studimi, i cili synon marrjen e njohurive të thelluara në fushën penale, zhvillimi i praktikave profesionale realizohet jashtë mjedisve të institucionit. Praktika profesionale zhvillohet pranë institucioneve me të cilat KUB ka marrëveshje bashkëpunimi. Për realizimin e praktikave profesionale në këtë program studimi, KUB ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh kryesisht me studio ligjore, por edhe me institucione private edhe shtetërore. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se është mundur lidhja e marrëveshjes me Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Kjo do të mundësojë që studentët e vitit të dytë të këtij programi studimi, ta zhvillojnë praktikën profesionale në mjediset e kësaj gjykate. <i>Shënime në institucion</i> <i>Evidenca nr. 21 "Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me partner kombëtarë dhe ndërkombëtarë"</i> <i>Evidenca nr. 27 "Udhëzues për përgatitjen e praktikës profesionale"</i>
Konkluzione	<i>KUB zotëron mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarive të mësimdhënies dhe veprimtarive të tjera mbështetëse në funksion të procesit mësimor në këtë program studimi.</i> <i>Mjediset në funksion të procesit të mësimdhënies janë të paisura me mjetet dhe paisjet e nevojshme teknologjike për plotësimin e kërkesave të aftësimit të studentëve në përputhje me objektivat formues të programit MSC në "E Drejtë Penale".</i>

	<i>Studentëve dhe stafit akademik të këtij programi u mundësohet akses në të gjitha mjediset dhe mjetet teknologjike që i shërbejnë procesit mësimdhënës të këtij programi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Syllabuset e lëndëve në këtë program mësimor përmbajnë si literaturën bazë, ashtu edhe literaturën ndihmëse. Studentët njihen me literaturën që në fillim të procesit mësimor ku prezantohet edhe përmbajtja e lëndës ose modulit. Nga shqyrtimi i programeve mësimore të lëndëve/moduleve pjesë e dosjes së vlerësimit, konkludohet se burimet e literaturës janë në përshtatje me natyrën e programit dhe përmbajtjen e moduleve. Literatura jo vetëm është pjesë përbërëse e programeve të lëndëve, por pasqyrohet për secilën nga temat e leksioneve. Gjatë takimit me stafin akademik, u pohua se burimikryesor i literaturës bazë janë tekstet mësimore në gjuhën shqipe ose ciklet e leksioneve. Studentëve iu vihen në dispozicion nga pedagogët e lëndëve edhe materiale shtesë në formën e ciklit të leksioneve në format elektronik. Materialet e përgatitura nga pedagogët mund të aksesohen nga studentët edhe nëpërmjet adresave elektronike. Studentët e këtij programi i aksesojnë burimet e literaturës si fizike, ashtu edhe dixhitale pranë bibliotekës së KUB. Në bibliotekë gjenden tekste dhe materiale të tjera si pjesë e fondit fizik të bibliotekës të dedikuar për këtë program studimit. Për sa i takon fondit dixhital, biblioteka e KUB mundëson aksesin në një sërë linqesh dhe burimesh on-line të literaturës që i referohet edhe këtij programi studimi. <i>Evidenca nr. 48 "Lista e teksteve të reja për programin e studimit Msc në "E drejtë penale"</i> <i>Evidenca nr. 89 "Model përmbledhje Cikël Leksioni nga libraria e KUB"</i>

	<i>Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 11-23, tabela 17".</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Çdo vit të ri akademik, titullarët e lëndëve përmirësojnë dhe azhurnojnë përmbajtjen e programeve të lëndëve me zhvillimet e reja të fushës që trajton lënda ose moduli. Në kuadrin e procesit të përditësimit të programeve mësimore, ndryshime pëson edhe literatura, e cila gjithashtu pasqyron risitë në literaturën juridike të fushës. Për këtë qëllim departamentet inciojnë kërkesat për blerjen e literaturës në përshtatje me nevojat e tyre. Në buxhetin e institucionit, pjesë përbërëse e shpenzimeve janë edhe ato të realizuara për pasurimin e fondit fizik të bibliotekës me tituj të rinj. Institucioni parashikon shpenzime edhe për pasurimin e fondit dixhital me bibliotekat on-line si dhe abonimet e tyre. <i>Evidenca nr. 48 "Lista e teksteve të reja për programin e studimit Msc në "E drejtë penale"</i> <i>Evidenca nr.58 "Raport Vjetori Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022"</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka ngritur dhe bërë funksionale bibliotekën e cila është e vendosur nëgodinën ku zhvillohet procesi i mësimdhënies në këtë program studimi. Biblioteka ka një sipërfaqe prej 65-70 m² me një kapacitet prej 80personash. Studentët e këtij programi studimi mund të aksesojnë në bibliotekë tekstet mësimore që janë pjesë e literaturës së lëndëve si dhe ciklet e leksioneve. Gjithashtu në bibliotekë gjendet literaturë e cila i ndihmon studentët edhe në hartimin e detyrave të kursit, temave të diplomave apo detyrimeve të tjera në raport me lëndët. Pjesë e fondit fizik janë edhe materialet e botuara me Prooceding të konferencave apo veprimtarive të tjera shkencore të zhvillura nga institucioni. Përveç fondit fizik, studentët mund të aksesojnë edhe fondin dixhital,i përbërë nga bibliotekat ndërkombëtare on-line ku mundësohet aksesimi në një numër mjaft të gjerë tekstesh dhe artikujsh shkencorë.Nga vëzhgimi në mjediset e bibliotekës ukonstuan kushte të përshtatshme për shfrytëzimin e kapaciteteve të saj nga studentët. <i>Evidenca nr. 91 "Relacion i bibliotekës së KUB"</i> <i>Evidenca nr.58 "Raport Vjetori Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022"</i> <i>Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 11-23, tabela 17".</i> <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i>

Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Bibloteka e KUB është e paisur me literaturë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, si nëpërmjet fondit fizik, ashtu edhe nëpërmjet fondit dixhital të saj. Fondi fizik i biblotekës disponon një numër prej 7150 tekstesh të përbërë si nga libra në gjuhën shqipe, ashtu edhe nga libra në gjuhë të huaj, për të gjitha programet e studimit që ofron institucioni, të cilat janë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik. Pjesë kryesore e fondit fizik të biblotekës janë tekstet mësimore të cilat janë edhe pjesë e literaturës së detyrueshme të programeve të lëndëve. Pjesë e fondit fizik të biblotekës janë edhe librat, revistatose periodikët shkencorë. Pjesë e këtij fondi janë gjithashtu edhe botimet periodike të institucione të tilla të rëndësishme si, Banka e Shqipërisë, Kuvendi etj, një pjesë e të cilave janë mundësuar nëpërmjet dhurimeve. Në fondin fizik të biblotekës gjenden edhe materialet e konferencave shkencore, të botuara në Proceeding ose revista shkencore të botuara nga KUB. Në fondin fizik të biblotekës ka literaturë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, e cila përdoret për qëllimet e programit të studimit Msc në “E Drejtë Penale”. Bibloteka ka gjithashtu burime të pasura me linqe që u rekomandohen studentëve të këtij programi studimi në përputhje me nevojat studimore të programit. <i>Evidenca nr. 48 “Lista e teksteve të reja për programin e studimit Msc në “E drejtë penale”</i> <i>Evidenca nr.58 “Raport Vjetori Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022”</i> <i>Evidenca nr. 80 “Relacion mbi infrastrukturën e KUB”</i> <i>Evidenca nr. 91 “Relacion i biblotekës së KUB”</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Një pjesë mjaft të rëndësishme të fondit të biblotekës së KUB e zë fondi dixhital i biblotekës, i cili përbëhet nga një sërë biblotekash on-line. Një aspekt mjaft i rëndësishëm i rritjes së cilësisë së fondit on-line të biblotekës është abonimi në JSTORE, duke mundësuar kështu rritjen e cilësisë së aksesimit të literaturës bashkohore të dixhitalizuar. Ashtu si fondi fizik, edhe përdorimi i biblotekës on-line mundësohet pa pagesë nga institucioni për të gjithë studentët dhe stafin akademik të KUB. Institucioni ka krijuar mundësi për akses të barabartë për studentët, personelin akademik dhe të interesuarit në funksion të procesit mësimor, si dhe kualifikimit shkencor dhe veprimtarisë shkencore të institucionit. Për studentët mundësohet paisja me kartë

	regjistrimi, si dhe çdo shërbim i nevojshëm mbi kërkimin e literaturës. <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 90 "Marëveshje bashkëpunimi JSTORE/e-bibloteka"</i> <i>Evidenca nr. 91 "Relacion i biblotekës së KUB"</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Bibloteka është e paisur me mjete si karrike dhe tavolina që mundësojnë kohën e qëndrimit dhe studimit në biblotekë, si dhe shfrytëzimin e literaturës. Në biblotekë gjenden edhe paisje të tilla si Lab Top të cilat lehtësojnë punën kërkimore dhe studimore të studentëve. Institucioni ka mundësuar informatizimin e fondit të biblotekës, çka e lehtëson kërkimin e materialeve. KUB ka mundësuar aksesimin në disa bibloteka dixhitale të huaja nëpërmjet sistemit të abonimit. Si të tilla përmendim: jstore.org, academia.edu, gutenberg.org, ebSCO.com/public-libraies etj. Aksesimi i studentëve ndaj këtyre biblotekave është falas. Nëpërmjet adresave zyrtare elektronike, studentëve u mundësohet lehtësisht aksesimi në sistemin e biblotekave on-line, si dhe kërkimi në burime të pasura të literaturës në gjuhë të huaj. Staf i akademik mund të aksesojë biblotekat on-line edhe nga mjediset e zyrave. Institucioni çdo vit rishikon dhe azhuron abonimet në biblotekat on-line. <i>Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 11-23, tabela 17".</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Në KUB, për shkak të diversitetit të programeve të ofruara, mësimi zhvillohet si gjatë orarit të paradites, ashtu edhe mbasdite. Studentët e programit mësimor Msc në "E Drejtë Penale" e zhvillojnë mësimin kryesisht në orarin e mbasditës. Për të mundësuar shfrytëzimin e barabartë të mjediseve të biblotekës, bibloteka qëndron e hapur në orare të zgjatura, nga ora 9.00-20.00 ditën e mërkurë, të enjten dhe të premten. Në ditën e tjera qëndron e hapur gjatë orarit zyrtar. Ky orar mundëson shfrytëzimin e biblotekës edhe për studentët që e zhvillojnë mësimin në orarin e mbasditës, përfshirë edhe studentët e këtij programi studimi. Në këtë mënyrë, mundësohet shërbimi i biblotekës në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët që ndjekin programet e studimit pranë institucionit, pavarësisht nga orari i zhvillimit të mësimit. Nga takimi me studentët u pohua se një pjesë e studentëve të këtij programi e frekuentojnë biblotekën dhe përdorin literaturën e referuar nga pedagogët e lëndëve.

	<i>Evidenca nr. 91 "Relacion i bibliotekës së KUB"</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Fondi fizik dhe ai on-line i bibliotekës përditësohet dhe pasurohet në vijimësi me literaturë bashkëkohore në forma të ndryshme. Si një nga burimet kryesore të pasurimit të bibliotekës, institucioni planifikon fonde për blerjen e literaturës në përputhje me nevojat për literaturë të programeve të studimit si dhe nevojat e stafit akademik. Çdo vit, me vendim të Senatit Akademik alokohet një fond prej 200.000 mijë -300.000 lekësh për blerjen e titujve të rinj. Gjithashtu çdo vit, institucioni parashikon burimet financiare të nevojshme për shtimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj të autorëve të huaj dhe shqiptarë. Institucioni mundëson blerje të reja të literaturës, si për tekstet që shërbejnë si literaturë bazë e lëndëve/syllabuse, ashtu edhe për literaturën plotësuese dhe të rekomanduar. Edhe fondi on-line azhurnohet nëpërmjet rinovimit të abonimeve, për të cilat gjithashtu çdo vit planifikohen burimet e nevojshme financiare. Personi i ngarkuar me administrimin e bibliotekës ndjek dhe raporton për gjendjen dhe cilësinë e fondit fizik dhe atij on-line të bibliotekës. Inisiativa për blerjen e teksteve të reja vjen kryesisht nga pedagogët e lëndës dhe pasqyrohet në kërkesat që departamentet bëjnë për blerje tekste. Në bazë të kërkesave që vijnë nga Departamentet, vijohet me procedurën e blerjeve në funksion të nevojës për përditësimin dhe pasurimin e literaturës së programeve të studimit. Pasurimi i fondit të bibliotekës me literaturë bëhet edhe mbi bazën e donacioneve si p.sh, periodikënga institucione shtetërore, dhurime nga individë etj. <i>Evidenca nr. 91 "Relacion i bibliotekës së KUB"</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi pasqyrojnë edhe literaturën e detyrueshme si dhe atë të këshillueshme, si një nga komponentë e rëndësishëm tësyllabuseve.</i> <i>Burimet e literaturës aksesohen në bibliotekë, e cila ka një infrastrukturë të përshtatshme si dhe disponon, si fondin fizik të literaturës, ashtu edhe atë on-line.</i> <i>Studentët dhe stafi akademik kanë të drejtën e përdorimit në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë të mjediseve dhe shërbimeve të bibliotekës, në përputhje me nevojat shkencore të realizimit të programit të studimit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni administrojnë dhe menaxhojnë të dhënat dhe informacionet që lidhen me studentët nga momenti i parë i regjistrimit, vazhdimin e procesit mësimor, vlerësimet e provimeve deri në momentin e diplomimit. Për këtë qëllim, pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Politike është ngritur dhe funksionon Sekretaria Mësimore e cila është struktura bazë administrative në këtë fakultet. Sekretaria administrojnë të dhënat në lidhje me programet që realizohen nga kjo njësi kryesore. Pranë Sekretarisë Mësimore administrohen regjistrat lidhur me programin e studimit Msc në “E drejtë Penale” si vijon: • Regjistri themeltar i studentëve ku pasqyrohen të dhënat e studentëve; • Regjistri i arritjeve akademike ku pasqyron vlerësimet e marra gjatë procesit mësimor; • Regjistri i të diplomuarve ku evidentohen të dhënat e studentëve që kanë përfunduar studimet. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për mbajtjen dhe administrimin e regjistrave. Regjistri themeltar i studentëve administrohet, jo vetëm në format të shkruar, por edhe në format elektronik. Nga verifikimi i GVJ në Sekretarinë Mësimore u konstatua se regjistrat ruhen dhe administrohen në mënyrë të rregullt. Nga verifikimi rezultoi gjithashtu se Sekretaria Mësimore, për secilin nga studentët administrojnë dosjen personale me të gjitha të dhënat si: kërkesa, dokumenti i identifikimit, dëftesa e pjekurisë, kontratat e lidhura me institucionin, si dhe të dhënat personale (numri i telefonit dhe adresa e emailit). Sekretaria administrojnë gjithashtu edhe dokumentacionin që lidhet me procesin mësimor si, proces verbalet e provimeve për të gjitha lëndët ose modulet që lidhen me këtë program

	studimi. Për të mundësuar ushtrimin eveprimtarisë së Sekretarisë Mësimore në përputhje me kriteret ligjore, institucioni ka hartuar njërrregullore të posaçme, Rregullorja e Sekretarisë Mësimore, e cila zbatohet në nivel institucional. Në këtërrregullore parashikohen në detaje, afatet dhe procedurat e administrimit të dokumentacionit lidhur me studentët dhe procesin mësimor si dhe formati, elementët dhe mënyra e administrimit të regjistrave. <i>Evidenca nr. 5 “Rregullore e njësisë kryesore FDSHP”</i> <i>Evidenca nr. 66 “Rregullore e Sekretarisë Mësimore”</i> <i>Evidenca nr. 94 “Regjistri i të dhënave të studentëve/AMZA”</i> <i>Evidenca nr. 94 “Regjistri i rezultateve/performancë së studentit”</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni administron dhe menaxhon dokumentacionin mbi aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe aktorëve të tjera të angazhuar në programin e studimit. Për këtë qëllim, janë ngritur dhe funksionojnë një sërë strukturash përgjegjëse si Sekretaria Mësimore, Zyra e Protokollit, Zyra e Burimeve Njerëzore etj. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për ruajtjen e çdo dokumenti dhe të dhëne që i referohet studentëve dhe procesit mësimor, si vlerësimet e marra, transferimet, largimet nga programi etj, që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim. Të dhëna në lidhje me studentët dhe arritjet akademike, si dhe personelin akademik që mbulon programin e studimit administrohen edhe nga Departamenti i Drejtësisë. Zyra e BurimeveNjerëzore administron dosjet e personelit akademik, personelit ndihmës akademik dhe atij administrativ të angazhuar në programin e studimit. Informacioni mbi përmbajtjen dhe strukturën e programeve mësimore, stafin e angazhuar në procesin e mësimdhënies për çdo program studimi, si dhe strukturën administrative të institucionit,publikohetdhe në faqen zyrtare të institucionit. <i>Evidenca nr 1 “Statuti i KUB”</i> <i>Evidenca nr.4 “Rregullore e KUB”</i> <i>Evidenca nr. 31 “Raport vjetori i veprimtarive Departamenti i Drejtësisë, viti akademik 2022-2023”</i> <i>Evidenca nr 40 “Paketa e regjistrimit të studentit”</i> <i>Evidenca nr. 86 “Përmbajtje dokumentare e dosjes së stafit FT”</i>

	<i>Evidenca nr. 86 "Përmbajtje dokumentare e dosjes së stafit PT"</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Strukturat përgjegjëse në institucion menaxhojnë dhe administrojnë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin që lidhet me programin mësimor, studentët e këtij programi si dhe personelin akademik të përfshirë në procesin e mësimdhënies. Administrimi në mënyrë tërregullt i dokumentacionit, mundëson që strukturat e ngarkuara me menaxhimin e informacionit të kenë akses dhe të japin informacion çdo herë që kërkohet. Mbi aspektet që i referohen procesit mësimor, marrja e informacionit mundësohet edhe nëpërmjet sistemeve të dedikuara si <i>portali</i>, i cili mundëson komunikimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi veprimtarinë mësimore, leksionet, detyrat e kursit, vlerësimet e lëndëve etj. Një burim i rëndësishëm informacioni ku mundësohet akses në kohë reale, është edhe faqja web e KUB, ku hidhen të dhënat kryesore mbi personelin akademik, strukturën dhe përmbajtjen e programeve dhe informacioni përditësohet në mënyrë të vazhdueshme. https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/ https://kub.portali.kub.edu.al/hyrje
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Institucioni ka vënë në përdorim platformën <i>portal</i>, e cila mundëson shkëmbimin e informacionit dhe komunikimin në kohë realenëpërmjet aksesit on-line midis studentëve dhe pedagogëve. Nëpërmjet kësaj platforme studentët marrin në kohë reale dhe në distancë një sërë informacionesh mbi veprimtarinë mësimore, si dhe komunikojnë me pedagogët e lëndëve për çështje që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Në këtë platformë studentët mund të gjejnë syllabuset e lëndëve, detyrimet në raport me lëndët, leksionet ose materialet që pedagogu ka trajtuar gjatë leksioneve, rezultatet e vlerësimit të lëndëve si dhe çdo informacion mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor. Në rubrikën e Sekretarisë Mësimore studentët mund të marrin informacion mbi njoftimet e sekretarisë, kalendarin e provimeve, rezultatet e provimeve etj. Studentët dhe stafi akademik mund të aksesohen në këtë portal nëpërmjet logimit me adresat zyrtare të emailit. Pedagogët dhe personeli administrativ i KUB zotëron dhe përdor një adresë zyrtare emaili të unifikuar nën domeinin e KUB, nëpërmjet të cilës lehtësohet komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit. Të gjitha pajisjet kompjuterike janë të vendosura në rrjet, i cili kontrollohet nga një main-server. Marrja e informacionit mundësohet edhe nëpërmjet

	faqes zyrtare të KUB, e cila përmban informacion të hollësishëm mbi aspekte të strukturës organizative, programeve të studimit, si dhe personelit akademik. Nga takimi në institucion, GVJ u informua se institucioni po punon për të mundësuar vënien në përdorim të një sistemi të integruar dhe të dixhitalizuar të informacionit, i cili do të mundësojë marrjen e shërbimit në kohë reale dhe në distancë për studentët dhe stafin dhe personalin administrativ. <i>GVJ sugjeron vënien sa më shpejt në përdorim të këtij sistemi për të mundësuar shkëmbime të informacionit dhe komunikim në kohë reale midis stafit akademik, atij administrativ dhe studentëve.</i> https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/ https://kub.portali.kub.edu.al/hyrje
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Platforma e portalit të KUB mundëson jo vetëm komunikimin në kohë reale midis studentëve dhe pedagogëve, por edhe monitorimin e veprimtarisë akademike dhe gjithëkomponentëve të procesit të mësimdhënies. Strukturat hierarkike mund të monitorojnë procesin akademik si dhe përmbushjen e detyrimeve në raport me procesin e mësimdhënies nga ana e pedagogëve. Në këtë mënyrë, strukturat përgjegjëse monitorojnë procesin mësimor që lidhet me këtë program studimi si dhe raportojnë tek autoritetet drejtuese. Konkluzionet e monitorimit janë pjesë e raporteve vjetore, që nga niveli i njësisë bazë deri në strukturat më të larta, ku nxiren edhe konkluzione dhe vendosen objektiva për përmirësimin e mangësive të konstatuara. I tërë aktiviteti i strukturave administrative që manaxhojnë informacion mbi programin e studimit, burimeve njerëzore të angazhuara në këtë program, si dhe aspekteve financiare apo elementëve të tjerë lidhur me programin e studimit, janë gjithashtu të monitoruara. Monitorimi realizohet nga autoritetet drejtuese në përputhje me kompetencat e përcaktuara në aktet e brendshme, si dhe struktura të tjera si NJSBC në kuadrin e proceseve të vetvlerësimit. Strukturat drejtuese marrin informacion të detajuar nëpërmjet raporteve, raporteve vjetore, raporteve të NJSBC etj. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 31 "Raport vjetor i veprimtarive Departamenti i Drejtësisë, viti akademik 2022-2023"</i>

	https://kub.portali.kub.edu.al/hyrje			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacione të hollësishme publikohen dhe bëhen të njohura për publikun në faqen zyrtare të KUB. Në këtë faqe gjenden informacione mbi strukturën institucionale, programet e studimit, stafin akademik, njoftimet etj. Informacionet e publikuara në këtë faqe azhurnohen në mënyrë të vazhdueshme me njoftime, aktivitete shkencore apo evente që lidhen me institucionin. Në këtë faqe mund të aksesohen edhe aktet rregullatore më të rëndësishme të KUB, si Statuti, Rregullorja e KUB, Raporti Vjetor i Veprimtarisë etj. Kjo faqe është ndërtuar me opsionin e kërkimit në të dy gjuhët, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën angleze. Pjesa më e rëndësishme e informacioneve mund të aksesohet edhe në gjuhën angleze. https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale			
Konkluzione	<i>Institucioni administron dhe menaxhon në mënyrë të rregullt dhënat dhe dokumentacionin që lidhet me programin e studimit Msc në "E Drejtë Penale".</i> <i>Institucioni ka vënë në përdorim platformën portali e cila mundëson shkëmbimin e informacionit dhe komunikimin nëpërmjet studentëve dhe pedagogëve.</i> <i>Nëpërmjet kësaj platforme studentët marrin në kohë reale dhe në distancë një sërë informacionesh mbi veprimtarinë mësimore, si dhe komunikojnë me pedagogët e lëndëve për çështje që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor.</i> <i>Institucioni duhet të vërë sa më shpejt në përdorim platformën dixhitale e cila do të mundësojë dixhitalizimin e administrimit të të dhënave dhe një ndërveprim më efikas midis studentëve, strukturave administrative dhe atyre akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni në përputhje me rregullimet e legjislacionit për arsimin e lartë si dhe aktet e brendshme rregullatore, mbështet financiarisht programet e studimit që ofron, si dhe pasqyron gjendjen financiare. Statuti dhe Rregullorja e institucionit kanë ngarkuar struktura të larta si, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit me kompetenca financiare që finalizohen me përgatitjen e pasqyrave financiare dhe miratimin e Raportit Vjetor Institucional. Në përputhje me rregullimet statutores, (neni 35), Bordi i Administrimit me propozim të Senatit, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikqyr zbatimin e tyre. Gjithashtu, ky bord përcakton rregulla për shpërndarjen e të ardhurave si dhe mbikqyr përdorimin e burimeve financiare. Aktet e brendshme rregullatore u kanë dhënë kompetenca në fushën financiare, jo vetëm autoriteteve dhe strukturave të larta si Senati Akademik, Bordi i Administrimit etj, por edhe drejtuesve të fakulteteve apo departamenteve. Në këtë mënyrë, KUBrealizon planifikimin dhe përdorimin e të ardhurave edhe në nivel fakultetesh dhe departamentesh. Hartimi i plan buxhetit është një nga kompetencat që Rregullorja e FDSHP i atribuon Dekanit (neni 10). Më tej, plan buxheti vjetor dhe ai afatmesëm shqyrtohen në Deakanat dhe i përcillen Rektoratit me rekomandimet përkatëse(neni 9).Në kuadrin e hartimit të projekt buxhetit, njësitë bazë propozojnë dhe bëjnë kërkesa për fonde buxhetore në varësi të nevojave lidhur me mbarëvajtjen e programit të studimit. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e Njësië Kryesore FDSHP"</i>
--	--

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	KUB përgatit çdo vit pasqyrat financiare vjetore në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe rregullat dhe standartet mbi kontabilitetin. Për këtë qëllim, është ngritur dhe funksionon një zyrë e veçantë, Zyra e Programimit dhe Raportimit Financiar nën kujdesin e Administratorit. Nëpasqyrat financiare pasqyrohen detaje mbi të ardhurat dhe shpenzimet si dhe të dhëna financiare për secilën njësi kryesore, nivel departamentesh dhe programesh studimi. Në këto pasqyra evidentohen shpenzimet e dedikuara për pagat e personelit akademik, kërkimin shkencor, bibliotekën dhe infrastrukturën. Fondi për botime në funksion të kualifikimit shkencor të stafit ka një vend të veçantë në buxhetin e institucionit. Gjithashtu, për çdo vit akademik parashikohet një zë i veçantë i shpenzimeve për shtimin e fondit të bibliotekës apo abonimeve në bibliotekat on-line. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion evidentohet se realizimi i shpenzimeve dhe planifikimi i buxhetit realizohet sipas departamenteve dhe programeve të studimit. Ndarja e të ardhurave dhe shpenzimeve në nivel departamentesh merr në konsideratë, programet e studimit, numrin e studentëve dhe stafin akademik dhe administrativ të angazhuar. Në këtë mënyrë, institucioni llogarit kostot vjetore të përafërta të shpenzimeve për programet e studimit, departamenteve që mbulojnë këto programe, madje edhe për çdo student. <i>Evidenca nr. 47 "Relacion për Realizimin e Buxhetit 2002 dhe planifikimi 2023 KUB"</i> <i>Evidenca nr 57 "Vendim i BA për mbështetjen financiare për kërkimin shkencor të stafit akademik KUB"</i> <i>Evidenca nr 58 "Raport Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022"</i> <i>Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 11-23, tabela 17".</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	KUB ka ngritur dhe bërë funksional një sistem të mbikqyrjes dhe administrimit të të ardhurave. Çdo zyrë, e cila ka kompetenca të menaxhimit financiar, ka një sistem hierarkik drejtimi, i cili mundëson zbatimin e ligjshmërisë dhe akteve rregullatore në menaxhimin e të ardhurave. KUB realizon, nëpërmjet strukturave të tij, edhe auditimin e brendshëm të gjendjes së tij financiare. Të dhënat dokumentare evidentojnë se KUB ka ngritur struktura të posaçme në fushën e financave që kryejnë auditime të brendshme. Nga të dhënat mbi realizimin e të ardhurave rezulton se në periudhën ushtrimore 2020-2023, të ardhurat nga tarifat e studentëve variojnë nga

	74%-99.2%, të ardhurat nga projektet variojnë nga 0.1%-1%, dhe të ardhurat nga trajnimet dhe shërbimet administrative variojnë nga 0.2%-25% të totalit të të ardhurave. Në kuadrin e shpenzimeve zërin më të rëndësishëm e përbëjnë shpenzimet për pagat. Një rol të rëndësishëm zënë edhe shpenzimet për kërkim shkencor, të cilat zënë 6.4-8.1 të totalit të shpenzimeve. Institucioni zbaton gjithashtu edhe detyrimet që lidhen me vlerësimin e situatës financiare nëpërmjet auditimit të jashtëm. Për sa i takon auditimit të jashtëm, nga dokumentat që institucioni ka vënë në dispozicion evidentohet se auditimi i jashtëm i pasqyrave financiare realizohet nga një kompani e huaj auditimi (Grant Thornton). <i>Evidenca nr. 47 "Relacion për Realizimin e Buxhetit 2002 dhe planifikimi 2023 KUB"</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	KUB harton buxhetin vjetor në bazë të programeve të studimit që ofron, në nivel departamenti, njësie kryesore e deri institucioni. Në këtë mënyrë, hartimi i projekt buxhetit merr për bazë nevojat si dhe propozimet e njësive bazë për fonde buxhetore. Zbatimi i buxhetit realizohet gjithashtu mbi nevojat e departamenteve. Ndarja e shpenzimeve dhe të ardhurave realizohet duke konsideruar programin e studimit, numrin e studentëve si dhe stafin akademik dhe atë ndihmës akademik në mbështetje të programit të studimit. Në këtë mënyrë, institucioni planifikon kostot për secilin nga programet e studimit që ofron. Institucioni informon njësitë bazë mbi ecurinë e zbatimit të buxhetit të miratuar si dhe financimin e shpenzimeve që i referohen mbarëvajtjes së programit të studimit. Nga dosja e vetvlerësimit evidentohet se gjetjet që rezultojnë nga auditimi i jashtëm i pasqyrave financiare të KUB, i paraqiten autoriteteve drejtuese dhe janë pjesë e raporteve të veprimtarisë vjetore të KUB. Si të tilla, ato u bëhen të njohura departamenteve. Një raport i shkurtuar mbi gjetjet e kompanisë ndërkombëtare të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të KUB publikohet në faqen zyrtare të institucionit. <i>Evidenca nr. 47 "Relacion për Realizimin e Buxhetit 2002 dhe planifikimi 2023 KUB"</i> <i>Evidenca nr. 47 "Relacion për Realizimin e Buxhetit 2002 dhe planifikimi 2023 KUB"</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë	Me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë financiare, KUB ka ngritur struktura të cilat kanë si pjesë të kompetencave të tyre

financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.

manaxhimin dhe mbikqyrjen e veprimtarisë financiare. Statuti i KUB (neni 31) parashikon se Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ që garanton mbarrëvajtjen financiare dhe administrative të institucionit. Ky Bord kontrollon veprimtarinë e institucionit që lidhet me menaxhimin financiar dhe ekonomik, si dhe përdorimin e burimeve dhe aseteve të tij. Në aktet rregullatore, institucioni ka parashikuar të drejtën e përdorimit të një sërë burimesh financiare për mbështetjen financiare të programeve të studimit që ofron. Referuar Statutit, sitë tilla janë: të ardhurat që mblidhen nga tarifat e studimit, të ardhurat që krijohen nga shërbime të ndryshme, studime e projekte, si dhe të ardhurat që krijohen nga kontributet dhe donacionet e themeluesve, apo burime të tjera të ligjshme.

Institucioni mund të përdorë gjithashtu të ardhurat e krijuara nga veprimtaritë kryesore dhe dytësore si, bashkëpunimi me të tretët, vendas ose të huaj, të ardhura nga konsulentat dhe shërbimet, sponsorizimet, donacionet, aktivitet tregëtare, apo donacione private të brendshme apo të huaja, në përputhje me legjislacionin shqiptar. Rregullorja e Departamentit i jep njësisë kryesore të drejtën të menaxhohë fondet për kërkim shkencor apo fonde të tjera që gjenerohen nga burime të ligjshme publike ose jo publike, kombëtare ose ndërkombëtare. Departamenti mund të sigurojë të ardhura edhe duke ofruar shërbime për të tretët, apo veprimtari të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin apo aktet e brendshme. Burimi kryesor i realizimit të të ardhurave për këtë program studimi rezultojnë të jenë të ardhurat që vijnë nga tarifat e studimit. Në aspektin e të ardhurave nga trajnimet, një impakt pozitiv në performancën financiare ka patur trajnimi për Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme, ku një rol të rëndësishëm ka luajtur personeli akademik i FDSHP. Në dokumentat e paraqitur, institucioni pohon se nuk ka patur probleme të qëndrueshmërisë financiare dhe vijueshmërisë së programeve të studimit. Me qëllim përmirësimit të cilësisë dhe vijueshmërisë, institucioni ka zbatuar politika të bursave, motivimit financiar dhe rritjes së nivelit të pagave për pedagogët si dhe aplikimit të fondeve për kërkim shkencor.

Evidenca nr.1 "Statuti i KUB"

Evidenca 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"

Evidenca nr. 101 "Program trajnimi për Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme & Çertifikatë"

Konkluzione	<i>Institucioni në përputhje me rregullimet e legjislacionit për arsimin e lartë si dhe aktet e brendshme rregullatore, mbështet financiarisht programet e studimit që ofron, si dhe vlerëson dhe pasqyron gjendjen financiare.</i> <i>Institucioni ka hartuar një bazë të gjerë rregullatore që rregullon funksionimin e sistemit të kontrollit dhe auditimit të brendshëm financiar. Ai zbaton gjithashtu edhe detyrimet që lidhen me auditimin e jashtëm të veprimtarisë financiare.</i> <i>Me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë financiare, KUB ka ngritur struktura që mbikqyrin veprimtarinë e institucionit mbi menaxhimin financiar dhe ekonomik, si dhe përdorimin e burimeve dhe aseteve të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	KUB bazuar në ligjin për arsimin e lartë, Statutin dhe aktet e brendshme, ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë procesin mësimor gjatë gjithëciklit akademik të studimeve. Akte të tilla si Statuti, rregullorja e KUB, rregullorja e Departamentit të Drejtësisë si dhe rregullorja e programit, kanë parashikuar të gjitha aspektet që lidhen me ciklin e studimeve të këtij programi, që nga momenti i regjistrimit të studentëve deri në diplomim. Në aktet e veta rregullatore KUB ka përcaktuar procedurat dhe modalitetet që lidhen me kriteret e pranimin të studentëve në këtë program studimi si, regjistrimi, arritjet akademike dhe

	vlerësimi i dijeve, zhvillimi i praktikës profesionale, transferimi i studimeve si dhe diplomimi. Këto rregullime janë të qarta dhe të detajuara dhe u bëhen të njohura studentëve që në kontaktet e para me institucionin. Për të rritur shkallën e njohjes së tyre nga të interesuarit, institucioni i bën publike procedurat e ciklit akademik në këtë program studimi nëpërmjet botimit në faqen zyrtare. Informacion i detajuar mundësohet për të interesuarit edhe nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese në prag të fillimit të vitit akademik. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e Njësië Kryesore FDSHP"</i> <i>Evidenca nr 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida studentore KUB Viti Akademik 2023-2024"</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga përmbajtja e akteve të brendshme rregullatore të institucionit konkludohet se politikat dhe procedurat që lidhen me ciklin akademik në këtë program studimi zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët dhe kandidatët për student. KUB përcakton në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë, kriteret për pranimin e studentëve. Këto kriterë mundësojnë konkurrim të barabartë dhe përzgjedhje bazuar në meritë. Për të rritur transparencën, KUB i bën të njohura kriteret e pranimit nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare. Publike bëhen gjithashtu edhe kriteret e përfitimit të bursave për kandidatët për student bazuar në rezultatet e maturës shtetërore. Barazi dhe të drejta të barabarta mundësojnë edhe procedurat e zbatuara gjatë ciklit akademik si, ato të përparimit akademik dhe vlerësimit të dijeve, diplomimit, përfitimit dhe përdorimit të infrastrukturës dhe shërbimeve që institucioni mundëson për këtë program studimi. <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr 7 "Rregullore e programit të studimit"</i> https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në	KUB përcakton kriterë për përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit që ofron, duke konsideruar përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë. Bazuar në përcaktimet e ligjore në fuqi, kriteret e përzgjedhjes për secilin program studimi përcaktohen në aktet e brendshme rregullatore. Rregullorja e këtij programi studimit ka

programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	përcaktuar kriteret e përgjithshme të pranimi në këtë program. Për sa i takon kriterëve të veçanta, rregullorja përcakton se atomiratoohen dhe shpallen çdo vit nga KUB dhe i dërgohen strukturave kompetente përgjegjëse (neni 5). Si kriteret e përgjithshme, ashtu edhe ato shtesë për pranimin në programin e studimit, bëhen të njohura për publikun nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare. Gjithashtu ato u bëhen të njohura të interesuarve edhe nëpërmjet fushatave informative që institucioni organizon përpara fillimit të vitit akademik. <i>Evidenca nr 7 “Rregullore e programit të studimit”</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Të gjitha aspektet e ciklit akademik që referohen programit të studimit Msc në “E drejtë Penale”, por edhe programeve të tjera që KUB ofron, janë të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Kriteret e përzgjedhjes së studentëve, përparimit akademik, transferimit dhe njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit, janë objekt i rregullimit të detajuar të akteve të brendshme rregullatore. Rregullorja e programit të studimit nënenin 5 përcakton se pranimi në programin e studimit Msc në “E Drejtë Penale” bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në ligj dhe udhëzimeve të MAS, të cilat përditësohen çdo vit në përputhje me specifikat e programit të studimit nga Fakulteti i Drejtësisë në IALP Kolegji Universitar i “Biznesit”. Kriteri bazë për pranimin e studentëve në këtë program studimi është përfundimi me sukses i studimeve të ciklit të parë “Bachelor”. Kriete shtesë për pranimin në ciklin e dytë të studimeve miratohen dhe shpallen nga KUB dhe i dërgohen MAS si dhe strukturave të tjera kompetente. Rregullorja e programit të studimit, si dhe akte të tjera rregullatore përcaktojnë procedurat dhe kriteret e përparimit akademik, transferimit dhe diplomimit të studentëve në këtë program studimi. Transferimi, njohja dhe ekuivalentimi i studimeve të mëparshme është objekt rregullimi në njëakt të veçantë: Rregullorja për Ekuivalentimin e Studimeve. Kjo rregullore përcakton të gjitha procedurat e aplikimit dhe ekuivalentimit të studimeve, si dhe veprimtarisë së Komisionit të Ekuivalentimit të Studimeve. Objekti i kësaj rregulloreje është standartizimi i procedurave të veprimtarisë së komisionit, si dhe sigurimi i transparencës së procesit për të gjithë të interesuarit. <i>Evidenca nr. 7 “Rregullore e programit të studimit”.</i>

	<i>Evidenca nr39 "Rregullore për ekuivalentimin e studimeve"</i> <i>Evidenca nr. 40 "Paketa e Regjistrimit të studentit"</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara fillimit të vitit akademik si dhe gjatë vazhdimësisë së procesit akademik, institucioni informon studentët mbi kohëzgjatjen, përmbajtjen dhe kriteret që lidhen me programin e studimit. Burimet e informimit që institucioni vë në dispozicion janë të tilla që mundësojnë informimin e gjerë të publikut dhe gjithë të interesuarve. Burim i rëndësishëm i informimit është faqja zyrtare e institucionit ku të interesuarit mund të gjejnë informacion mbi përmbajtjen dhe elementët e programeve tëstudimit, kriteret e pranimi dhe përparimit akademik të studentëve. Në faqen zyrtare mund të aksesohet edhe Guida e Studentit ku janë detajuar të gjitha informacionet mbi programin e studimit. Guidën e Studentit të interesuarit mund ta tërheqin edhe në mjediset e institucionit. KUB përdor edhe një sërë formash të tjera të informimit publik për të interesuarit si, fushata informuese me maturantët, spotet publicitare, shpërndarja e fletë palosjeve etj. Në ditën e parë të fillimit të vitit akademik, Departamenti i Drejtësisë organizon takim informues me studentët ku i informon mbi përmbajtjen dhe kriteret e programit të studimit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre. Veprimtaria informuese shtrihet gjatë gjithë javës së parë të vitit të ri akademik. Forma të tjera informimi që institucioni përdor janë edhe fletëpalosjet, guida studentore, fushata informuese nëpërmjet takimeve me maturantët etj. Informacion të detajuar studentët mund të marrin edhe pranë Sekretarisë Mësimore, sinë fillim të vitit akademik, ashtu edhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit mësimor. <i>Evidenca "RVB Masteri Shkencave E Drejtë Penale"</i> <i>Evidenca nr 105 "Guida studentore KUB Viti Akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr. 104 "Fletëpalosje Informative për Vitin Akademik 2023-2024"</i> https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të	Institucioni harton dhe publikon përpara fillimit të çdo viti akademik kriteret e përgjithshme të pranimi në programet estudimit, në përputhje me rregullimet e përcaktuara në aktet ligjore dhe udhëzimet e MAS. Gjithashtu, për secilin nga programet e studimit, në përputhje me natyrën e programeve, institucioni mund të përcaktojë edhe kriteret të veçanta të pranimi. KUB e ka parashikuar mundësinë e pranimi në

pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	programet e studimit të kategorive të veçanta, përfshirë edhe kandidatë me aftësi të veçanta, pakica dhe shtresa të marginalizuara. Në programin e studimit janë parashikuar kuota të veçanta për personat me aftësi ndryshe, komunitetin rom etj. KUB zbaton edhe politika të sistemit të bursave për studentët me nevoja specifike si studentët me probleme social ekonomike, sportistë apo talente, jetim etj. Në dokumentacionin ku pasqyrohen shpenzimet financiare janë përfshirë edhe pagesat e bursave, jo vetëm për studentët me rezultate të larta të maturës shtetërore, por edhe bursat e studentëve me aftësi të veçanta, pakicave ose shtresave në nevojë. <i>Evidenca nr. 47 "Relacion për Realizimin e Buxhetit 2002 dhe planifikimi 2023 KUB"</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Çdo vit akademik institucioni përcakton kuotat dhe kriteret e pranimit për secilin nga programet e studimit që ofron. Në përputhje me natyrën e programeve, përveç kriterëve të përgjithshme, mund të përcaktohen edhe kriterë të veçanta. Në totalin e kuotave për programet e studimit që KUB ofron, mund të përcaktohen kuota të veçanta edhe për studentë të huaj apo jashtë territorit shqiptar. Duke qënë se programi Msc në "E Drejtë Penale" është një program në gjuhë shqipe, në këtë program mund të regjistrohen edhe studentë nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi etj. Institucioni në totalin e kuotave për këtë program studimi ka parashikuar kuota edhe për këtë kategori. Gjithashtu këta studentë mund të transferojnë dhe ekuivalentojnë kreditet për efekt të transferimit në këtë program studimi. <i>Evidenca nr 106.1 "Propozim i kuotave në MAS 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr 106.2 "Miratim i kriterëve në MAS 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 106.3 "Miratim i kuotave në MAS 2022-2023"</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Që nga momenti i fillimit të veprimtarisë akademike e në vazhdim, KUB ka zbatuar politika të akordimit të bursave. Për këtë qëllim, çdo vit caktohet një fond i veçantë dhe Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit miratojnë kriteret për zbatimin e tyre. Nëpërmjet sistemit të bursave KUB mundëson lehtësimin e ngarkesës financiare për studentët që në vitin e parë të studimeve, bazuar në rezultatet e shkollës së mesme. Bazura në këtë kriter, kategoritë e bursave të ofruara nga KUB janë si vijon: për studentët me mesatare 9.8-10 100% bursë e plotë studimi;

	për studentët me mesatare 9.5-9.79 80% bursë studimi; për studentët me mesatare 9.-9.49 50% bursë studimi; për studentët me mesatare 8.5-8.99 30% bursë studimi; Studentët që e kanë fituar bursën në vitin e parë, mund ta përfitojnë atë edhe në vitet e tjera nëse kanë rezultate të larta në programin e studimit ku janë regjistruar. Çdo vit akademik institucioni i bën të njohura kriteret e dhënies së bursave nëpërmjet shpalljes në faqen zyrtare. Në këtë mënyrë ai zbaton politika të përthithjessë studentëve me rezultate të larta me synim rritjen e cilësisë së programeve që ofron. KUB zbaton edhe politika të sistemit të bursave për studentët me nevoja specifike si studentët me probleme social ekonomike, sportistë apo talente, jetim etj. Nga të dhënat e institucionit, në totalin e studentëve që trajtohen me bursa, ka çdo vit akademik 20-25 studentë të rinj dhe një total prej 90-100 studentë për të gjithë vitet. Institucioni evidenton se shpenzon një buxhet prej 90.-100 mijë euro për sistemin e bursave. <i>Evidenca nr. 47 "Relacion për Realizimin e Buxhetit 2002 dhe planifikimi 2023 KUB"</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në ligjin për arsimin e lartë, Statutin dhe aktet e brendshme, KUB ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë procesin mësimor gjatë gjithë ciklit akademik të studimeve.</i> <i>Të gjitha aspektet e ciklit akademik që i referohen programit të studimit Msc në "E drejtë Penale", por edhe programeve të tjera që ofron KUB, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku si dhe mundësojnë barazi dhe trajtim të barabartë për të gjithë studentët.</i> <i>Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika të mbështetjes së kategorive të veçanta si, stimulimi i rezultateve të larta për studentët që ndjekin programin e studimit, apo mbështetja për shtresat në nevojë nëpërmjet sistemit të bursave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	I gjithë informacioni në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve parashikohet në një sërë rregulloresh në nivel institucional. Kritere dhe procedura që referohen këtij programi studimi përmban në mënyrë të detajuar rregullorja e posaçme e programit të studimit. Në këtë rregullore parashikohen elementë lidhur me objektivat formues të programit, kohëzgjatjen, frekuentimin, kontrollin e dijeve si dhe instrumentat e vlerësimit. Informacion i detajuar gjendet edhe në Kurrikulën e Programit të Studimeve të Ciklit të Dytë Msc në “E drejtë Penale”. Informacioni mund të aksesohet edhe në dokumente informative të tillë si, “Guida e Studentit” e cila përmban informacion mbi të gjitha aspektet infrastrukturore dhe akademike që i referohen programeve të studimit. Sylabusët e çdo lënde përmbajnë edhe komponentët mbi detyrimet që studentët duhet të përmbushin në raport me lëndën, si dhe kriteret e vlerësimit të vazhduar dhe atij përfundimtar. Institucioni ka mundur për studentët e këtij program studimi marrjen e informacionit mbi kriteret e përparimit akademik nëpërmjet një sërë burimesh. Pedagogët e lëndës informojnë studentët në lidhje me detyrimet dhe kriteret e vlerësimit të lëndës që në javën e parë të vitit akademik. Pranë Sekretarisë Mësimore studentët informohen mbi kalendarin e provimeve, vlerësimet e lëndëve, frekuentimin apo numrin e krediteve për kalimin në vitin pasardhës akademik. Ky informacion mund të aksesohet edhe on-line në faqen zyrtare të institucionit dhe në sistemin e portalit ku pasqyrohen njoftimet e sekretarisë. Nga takimi i GVJ me studentët, u konfirmua se studentët informohen ngapedagogu i lëndës si dhe burime të tjera për aspektet që lidhen me komponentët e lëndëve dhe procedurat e përparimit akademik. <i>Evidenca nr. 4. “Rregullore e KUB”</i> <i>Evidenca nr. 7. “Rregullore e Programit të Studimit”</i> <i>Evidenca nr. A. 32.3. “Planet Mësimore të programit të studimit”</i>

	<i>Evidenca 32.4 "Syllabus-et e lëndëve Moduleve të programit të studimit"</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	KUB ka sanksionuar dhe zbaton procedura të transferimit të studimeve dhe njohjessë kualifikimeve të mëparshme të studimeve të pjesshme. Rregullorja e këtij programi studimi parashikon mundësinë e transferimit në këtë program studimi në vite ndërmjetëse nga institucione të tjera të arsimit të lartë vendase ose të huaja. Procesi i transferimit realizohet në përputhje me udhëzimet e MAS dhe aktet rregullatore të institucionit. Për këtë qëllim, është hartuar një rregullore e posaçme, Rregullorja për Ekuivalentimin e Studimeve, e cila trajton procedurat e transferimit të studimeve dhe njohjes së studimeve të pjesshme në të gjitha programet e ofruara nga KUB. Nëpërmjet kësaj rregulloreje, orientohen studentët si dhe bëhen transparente të gjitha procedurat e pranimit të kandidatëve që mbushin kriteret për vazhdimin e studimeve të mëparshme të një programi ose në një program të dytë pranë KUB (neni 1). Një nga elementët e objektit të kësaj rregulloreje është sigurimi i transparencës së këtij procesi për të gjithë të interesuarit. Rregullorja ka parashikuar të gjitha procedurat administrative të procesit të ekuivalentimit që nga momenti i dorëzimit të dosjes, deri në marrjen e vendimit përfundimtar. Rregullorja parashikon gjithashtu, kompetencat dhe veprimtarinë e Komisionit të Ekuivalentimit të Studimeve (KES) në procesin e ekuivalentimit dhe njohjessë studimeve të mëparshme. <i>Evidenca nr. 7. "Rregullore e Programit të Studimit"</i> <i>Evidenca nr. 39 "Rregullore për Ekuivalentimin e Studimeve"</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Institucioni ka përfshirë në aktet e tij rregullatore një sërë parashikimesh mbi mënyrën e vlerësimit të dijeve, sistemin e vazhdueshëm dhe atë përfundimtar të vlerësimit, si dhe mënyrën e konvertimit në notën përfundimtare. Aktet rregullatore qëparashikojnë aspekte rregulluese mbi sistemin e vlerësimit janë: Rregullorja e KUB, Rregullorja e njësisë kryesore FDSHP, Rregullorja e programit të studimit dhe Rregullorja e posaçme për zhvillimin e provimeve. Mënyrat e vlerësimit të dijeve janë gjithashtu pjesë e përmbajtjes së syllabuseve të çdo lënde/moduli me të cilat studentët informohen nga pedagogët që në fillim të procesit akademik Rregullorja e zhvillimit të provimeve përcakton procedurat e zhvillimit të provimeve, përgjegjësitë e personelit akademik, atij ndihmës akademik dhe administrativ në administrimin e

procesit të provimeve, si dhe të drejtat e detyrimit e studentëve. Një kre i veçantë i kësaj rregulloreje ka si objekt mënyrën e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin e studentëve. Kontrolli i dijeve të përvetësuar nga studentët bëhet nëpërmjet vlerësimit vazhdues dhe atij përfundimtar. Vlerësimi vazhdues përfshin angazhimin e studentit gjatë semesrit kur zhvillohet lënda nëpërmjet testeve, detyrave të kursit, projekteve të kursit, eseve, etj, si dhe provimeve të zhvilluara sipas kalendarit të provimeve. Neni 10 përcakton për pedagogët detyrimin tu bëjnë të njohur studentëve që ditën e parë të fillimit të programit të lëndës, format e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin me pikë për secilin nga komponentët vlerësues. Bazuar në të dy komponentët, nota përfundimtare është shumatore e vlerësimit të vazhdueshëm dhe përfundimtar si më poshtë:

- a) Pjesëmarrja, 10 pikë;
- b) Aktivizimi, 10 pikë;
- c) Teste, detyra kursi, 20 pikë;
- d) Provim përfundimtar 60 pikë;

Rregullorja përcakton edhe sistemin e vlerësimit të dijeve dhe shkallën e konvertimit të pikëve në notë si vijon:

Pikët	1-40	41-50	51-60	61-70	71-80	81-90	91-100
Nota	4	5	6	7	8	9	10

Nga takimi me studentët u konstata se ata ishin të informuar mbi procedurat dhe sistemin e vlerësimit të dijeve si dhe konvertimit të vlerësimit në notë.

Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"

Evidenca nr. 5 "Rregullore e njësisë kryesore FDSHP"

Evidenca nr. 7. "Rregullore e Programit të Studimit"

Evidenca 32.4 "Syllabus-et e lëndëve Moduleve të programit të studimit"

Evidenca nr. 64 "Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB"

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe

Në këtë program studimi përmbyllja e detyrimeve realizohet nëpërmjet punimit të diplomës, e cila gjithashtu vlerësohet me notë dhe me kredite ECTS sipas planit mësimor përkatës. Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit janë gjithashtu njëkomponent i rëndësishëm i rregullimit në

diplomimit në programin e studimit.

aktet normative të brendshme. Procedurat, kushtet dhe kriteret që lidhen me përzgjedhjen e temave, punimin e diplomësi dhe vlerësimin, janë pjesë e parashikimeve tërregulloreve në nivel institucional, rregullore të këtij programi studimi si dhe Udhëzimit të posaçëm për përgatitjen e diplomës. Referuar *nenit 52* të Rregullores së njësisë kryesore FDSHP, Departamenti i Drejtësisë shpall sipas datave të përcaktuara temat e diplomës. Departamenti miraton gjithashtu edhe udhëheqësit e temave, të cilët marrin miratimin përfundimtar nga Dekani i FDSHP. Në këtë program studimi udhëheqësi i temës së diplomës duhet të ketë të paktën gradën shkencore "Doktor". Studenti i cili ka përmbyllur të gjitha detyrimet në raport me përgatitjen dhe paraqitjen e diplomës, në përfundim të studimeve paiset me diplomën përkatëse, cila është një dokument zyrtar. Udhëzimi i posaçëm për punimin e diplomës ka përcaktime të detajuara lidhur me procedurat e realizimit të mbrojtjes, si dhe detyrimet e studentëve dhe kompetencat e strukturave të përfshirane në procesin e mbrojtjes si udhëheqësi, Komisioni i Mbrojtjes së Diplomës, etj. Për të garantuar cilësinë dhe për të rritur nivelin shkencor në realizimin e punimeve të diplomës, udhëzimi ka përcaktime të qarta mbi strukturën dhe kriteret e cilësisë në hartimin e përmbajtjes, si dhe etikës së kërkimit. Në udhëzim përcaktohen edhe procedurat e mbrojtjes së temës së diplomës, kriteret e vlerësimit dhe diplomimit. Detajimi dhe qartësia e përmbajtjes së këtij udhëzimi ndihmon dhe orienton studentët gjatë gjithë procesit të përzgjedhjes dhe punimit të diplomës. Gjithashtu pedagogët udhëheqës, në përputhje edhe me detyrimet e përcaktuara në udhëzim, orientojnë dhe mbështesin studentët gjatë këtij procesi. Studentët informohen për mënyrën dhe procedurat e përmbylljes së detyrimeve dhe diplomimit në një tërësi formash të tjera si, java orientuese në fillim të vitit akademik, Sekretaria Mësimore, faqja zyrtare e institucionit, etj.

Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"

Evidenca nr. 5 "Rregullore e njësisë kryesore FDSHP"

Evidenca nr. 7. "Rregullore e Programit të Studimit"

Evidenca nr 32.6 "Udhëzues për përgatitjen e diplomës"

Evidenca nr. 32.8 "Miratimi i temës së diplomës nga dekani FDSHP"

Evidenca nr. 32. 9 "Model Diplome Msc ne E Drejtë penale"

	<i>Evidenca nr. 32. 10 "Diploma Supplement Msc ne E Drejtë penale"</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik, KUB merr të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur me sukses procesin e informimit mbi programet e studimit që ofron. KUB informon të interesuarit në lidhje me programet dhe format e studimit, kriteret dhe procedurat e pranimit, tarifat e studimit, infrastrukturën, shërbimet dhe facilitetet, personelin akademik përgjegjës për secilin nga programet nëpërmjet një sërë formash. Informimi realizohet nëpërmjet njoftimit në faqen zyrtare, njoftimit në rrjetet sociale apo nëpërmjet spoteve televizive, fushatat informuese me maturantët, njoftimet eshpallura në mjediset e brendshme të institucionit etj. Një formë tjetër mjaft e rëndësishme është pjesëmarrja periodike në panairt e punës të tilla si "Work and Study" ku KUB bën të njohur ofertën e tij akademike. Faqja web e institucionit përmban informacion të hollësishëm mbi kriteret apo procedurat e pranimit, si dhe programet mësimore që institucioni ofron. Informacione të detajuara mund të aksesohen edhe në Guidën e Studentit, e cila gjithashtu publikohet në faqen zyrtare. Për të mundësuar informimin, Zyra e Karrierës dhe struktura të tjera organizojnë javën e informimit me maturantët, të cilët informohen në lidhje me të gjithë komponentet e ofertës dhe jetës akademike që institucioni ofron. Me qëllim informimin e gjerë të publikut, KUB publikon fletë palosje si dhe realizon spote publicitare me informacion për programet e studimit. <i>Evidenca 104 "Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca 105 "Guida studentore KUB viti akademik 2023-2024"</i> <i>Evidenca 110 "Program i Panairit Work and Study"</i> <i>Faqaj zyrtare e KUB:</i> https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/
Konkluzione	<i>Institucioni ka hartuar dhe zbaton procedurat të pranimit të studentëve, transferimit dhe njohjen e krediteteve, vlerësimit të dijeve, si dhe diplomimit.</i> <i>Këta komponentë janë pjesë e një bazë të gjerë rregullatore, e përbërë nga një sërë rregulloresh në nivel institucional si dhe rregullore të posaçme që i referohen aspekteve të përparimit akademik deri në diplomim e studentëve.</i>

	Përpara fillimit të çdo viti akademik, KUB merr të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur me sukses procesin e informimit mbi programet e studimit që ofron si dhe komponentë për secilin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	KUB ka një sistem funksional të informimit mbi të gjithë komponentët e mësimdhënies në programet e studimit që ofron. Në një sërë formash, KUB mundëson informimin e studentëve të programit mësimor Msc në “E Drejtë Penale” mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e këtij programi studimi. Një komponent informues është plani mësimor i programit të studimit, i detajuar, i cili përcakton të gjithë komponentët e nevojshëm si: lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje, kreditet për secilën, si dhe semestrin e zhvillimit të lëndës. Rregullorja e këtij programi studimi ka gjithashtu rregullime mbi ngarkesën e lëndëve, kohëzgjatjen dhe kreditet. Programi mësimor Msc në “E drejtë Penale” ka një kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike me një total prej 120 kreditesh. Kalendarin mësimor i shpallur nga institucioni çdo vit akademik përmban: strukturën mësimore ku përcaktohet kohëzgjatja e lëndëve sipas semestrave, periudhën e pushimeve, si dhe sezonet e provimeve. Struktura e vitit akademik afishohet në tabelën e njoftimeve. Studentët njihen me strukturën e vitit akademik edhe nëpërmjet njoftimeve nga Sekretaria Mësimore, të cilat mund ti aksesojnë edhe nëpërmjet sistemit të Portalit. Institucioni publikon informacione mbi kohëzgjatjen dhe strukturën e secilit nga programet që ofron në faqen zyrtare të tij. Në këtë mënyrë, këto informacione bëhen të njohura jo vetëm për studentët, por për gjithë të interesuarit. <i>Evidenca nr. 7. “Rregullore e Programit të Studimit”</i> <i>Evidenca 32.2 “Kurrikula e programit të studimit”</i>

	<i>Evidenca 32.3 "Planet mësimore të programit të studimit"</i> https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/ https://kub.portali.kub.edu.al/hyrje
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Që në fillim të vitit akademik studentët marrin të gjithë informacionin e nevojshëm mbi lëndët/modulet që janë pjesë e programit mësimor si dhe përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Institucioni publikon në faqen web informacion mbi programet mësimore dhe komponentët e tyre për kandidatët për student dhe të interesuarit. Që në javën e parë të vitit akademik, pedagogët e lëndëve informojnë studentët në lidhje me secilën nga lëndët/modulet, përmbajtjen e lëndës, konceptet themelore të saj, sistemin e vlerësimit dhe literaturën. Më tej, gjatë gjithë vazhdimësisë së ciklit akademik studentët e marrin këtë informacion në kohë reale nga një sërë burimesh dhe strukturash të dedikuara si Sekretaria Mësimore, pedagogët e lëndëve, departamenti etj. Këtë informacion studentët mund ta aksesojnë edhe nëpërmjet sistemit të portalit ku titullaret e lëndëve përcjellin syllabuset e lëndëve si dhe informacionine nevojshëm lidhur me lëndët ose modulet. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të përcjella nga institucioni, konstatohet se syllabuset kanë të gjithë komponentët e nevojshëm që i referohen lëndës/modulit si pedagogun përgjegjës, tipologjinë e lëndës, numrin e krediteve, ngarkesën mësimore, konceptet themelore, temat e leksioneve, format e kontrollit të njohurive si dhe provimit përfundimtar. Elementë të programit të lëndës janë gjithashtu edhe literatura e detyrueshme si dhe ajo e rekomanduar. <i>Evidenca 32.3 "Planet mësimore të programit të studimit"</i> 32.4 "Syllabus-et e lëndëve Modulet e programit të studimit" Evidenca 103 "Guida Studentore KUB Viti Akademik 2023-2024" https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/ https://kub.portali.kub.edu.al/hyrje
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Për shkak edhe të larmishmërisë së programeve të studimit që ofron, KUB ka ndërtuar dhe zbaton politika që i referohen punësimit dhe zhvillimit të karrierës së studentëve. Këto politika pasqyrohen edhe në planet strategjike të zhvillimit që institucionit harton. Institucioni harton dhe zbaton plane strategjike jo vetëm në nivel institucional, por edhe për programet e studimit. Në planin strategjik që i referohet këtij programi studimi, pasqyrohet edhe rritja e potencialeve të

	punësimit në bazë të profilit dhe natyrës të programeve të studimit. Për këtë qëllim KUB realizon edhe sondazhe e studime mbi nivelin e punësimit të studentëve në përputhje me profilin e programit të studimit nëpërmjet sistemit të gjurmimit dhe intervistimit të studentëve Alumni. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, luan Zyra e Studentëve dhe e Këshillimit të Karrierës në KUB, cila mundëson ndërmjetësimin midis tregut të punës dhe institucionit. Kjo zyrë çdo vit bën përditësimin e nivelit të punësimit të studentëve. Nëpërmjet identifikimit të nevojave të tregut të punës, kjo zyrë shërben edhe përmirësimit të kurrikulave me qëllim përshtatjen e përmbajtjes së tyre me tregun e punës. Zyra organizon evente dhe aktivitete që nxisin drejt mundësive të punësimit për studentët. Panairi i karrierës “Work and Study” është një nga aktivitetet më të rëndësishëm në këtë drejtim, ku KUB mundëson pjesëmarrjen në mënyrë periodike. Institucioni zbaton edhe politika të tjera me të cilat mbështet dhe orienton studentët drejt tregut të punës. KUB ka lidhur një sërë marëveshje me zyra ligjore, si dhe institucione private dhe shtetërore për zhvillimin e praktikës në këtë program studimi. Këto marëveshje janë një premisë për orientimin dhe mbështetjen e studentëve drejt tregut të punës si dhe ritjen e mundësive të punësimit të studentëve. <i>Evidenca nr 2 “Plani strategjik i zhvillimit KUB 2021-2026”</i> <i>Evidenca nr 2.2 “Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit”</i> <i>Evidenca nr 9 “Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës”</i> <i>Evidenca 21 “Lista e marëveshjeve të bashkëpunimit me partner kombëtarë dhe ndërkombëtarë”</i> <i>Evidenca nr 110 “Program i Panairit Work and Study”</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	KUB ka ndërtuar dhe zbaton një sistem efikas të informimit të studentëve mbi të gjitha aspektet e jetës universitare në institucion. Pjesë e informacionit që studentët marrin është edhe ai mbi llogjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të procesit mësimor. Si pjesë përbërëse e procesit informues, edhe me këtë informacion studentët njihen përpara fillimit të vitit akademik. Të gjitha materialet informuese që institucioni i bën të njohura publikut përmbajnë informacion edhe mbi infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të procesit mësimor. Këto informacione mund të aksesohen në faqen web të institucionit, në Guidën e Studentit.

	Në fillimit të vitit akademik, studentët orientohendhe informohen në lidhje meinfrastrukturën në funksion të procesit mësimor. Ata informohen mbi mjediset e zhvillimit të procesit mësimor, bibliotekën, sekretarinë, laboratorët, zyrat administrative apo ato të departamenteve etj. Për këtë qëllim, veçanërisht për studentët e viti të parë, zhvillohet java informuese ku ata informohen edhe mbi aspektet e infrastrukturës dhe të shërbimeve që institucioni mundëson. Një pjesë e këtij informacioni bëhet i njohur nëpërmjet afishimit në stendat e vendosura në holl, ose në ambiente të dukshme të institucionit. Kështup.sh nëorarin mësimor është përcaktuar edhe salla e zhvillimit të mësimi, si për leksionet, ashtu edhe për seminarët. Studentët informohen edhe në vazhdimësi për çdo komponent të shërbimeve apo infrastrukturës në funksion të programit të studimit. <i>Evidenca nr. 31.5 "Model orari mësimor i programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr. 91 "Relacion i bibliotekës së KUB"</i> <i>Evidenca nr.58 "Raport Vjetori i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022"</i> <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sekretaria Mësimore,në kuadrin e kompetencave të saj, administron informacionin mbi studentët dhe procesin mësimor. Sekretaria mbledh dhe administron dosjendhe të dhënat për studentët, që nga momenti i regjistrimit në program, deri në momentin e diplomimit. Pranë Sekretarisë Mësimore administrohen gjithashtu edhe procesverbalet e notave, datat e provimeve si dhe regjistrat për çdo program mësimor. Regjistri themeltar i studentëve administrohet jo vetëm në format shkresor, por edhe në format elektronik. Studentët mund të marrin nëçdo kohë informacionin e administruar pranë SekretarisëMësimore. Vënia në dispozicion e informacionit realizohet në përputhje me parashikimet e akteve të brendshme regullatore. Studentët mund të aksesojnë informacion edhe nëpërmjet platformës të portalit të KUB, një platformë teknologjike që mundëson për studentët marrjen e informacionit në kohë reale. Aksesit në këtëplatformë për studentët mundësohet nëpërmjet adresave zyrtare të emailit me domenin e institucionit. Nëpërmjet kësaj platforme studentët mund të marrin njoftime si dhe informacion si nga sekretaria ashtu edhe nga pedagogët e lëndëve, për aspektet që lidhen me

	procesin mësimor. Shpërndarja e materialeve në funksion të procesit mësimor nga pedagogët mund të mundësohet edhe nëpërmjet platformës Google Classroom. <i>Evidenca nr.66 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"</i> <i>Evidenca nr. 74 "Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom_KUB"</i> <i>Evidenca nr. 94 "Regjistri i të dhënave të studentëve AMZA"</i> <i>Evidenca nr. 95 "Regjistri i rezultateve të performancës së studentit"</i> <i>Evidenca nr. 96 "Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom_KUB"</i> https://kub.portali.kub.edu.al/hyrje			
Konkluzione	KUB u mundëson studentëve të këtij program informacion mbi komponentët e programit të studimit si dhe logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të procesit mësimor. Informacioni u vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet një sërë burimesh si pedagogët e lëndëve, departamentet, Sekretaria Mësimore. Studentët mund të akseojnë informacion nëpërmjet përdorimit të platformave dhe sistemeve dixhitale të komunikimit si platforma teknologjike portali, Google Classroom, apo faqja zyrtare e KUB.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	KUB nëpërmjet strukturave të tij, disponon dhe administron statistika vjetore mbi numrin e studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi si dhe atyre që janë diplomuar. Administrimi i të dhënave në regjistrat përkatës realizohet në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera nënligjore. Përgjegjëse për administrimin e të dhënave është Sekretaria Mësimore, e cila ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe aktet rregullatore të

institucionit. Në kuadrin e detyrave të saj për hedhjen dhe administrimin e të dhënave lidhur me studentët që ndjekin këtë program studimi, Sekretaria Mësimore administron një regjistër të veçantë, regjistrin e të diplomuarve. Ky regjistër përmban të dhënat e studentëve që kanë përfunduar me sukses programin e studimit dhe janë diplomuar sipas programeve të studimit. Në përputhje me kërkesat ligjore, institucioni raporton në MAS periodikisht të dhënat në lidhje me numrin e të diplomuarve. Nga vëzhgimi i GVJ pranë Sekretarisë Mësimore nuk u konstatuanparegullsi nëadministrimin e regjistrin të të diplomuarve. Sipas të dhënave të institucionit, numri i të diplomuarve në këtë program studimi është si vijon:

Viti akademik	19-20	20-21	21-22	22-23
Të diplomuarit	11	15	9	9

Evidenca nr.66 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"

Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 11-23, tabela 23"

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

KUB disponon dhe administron statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Institucioni administron gjithashtu edhe të dhëna lidhur me numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit për çdo vit akademik, tërheqjet nga programi apo largimet para përfundimit të programit si dhe transferimet nga institucione të tjera brenda ose jashtë vendit. Të gjitha të dhënat që lidhen me ecurinë akademike të studentëve që nga momenti i regjistrimit, e deri në përfundimin me sukses të ciklit akademik, administrohen pranë Sekretarisë Mësimore.

Sekretaria Mësimore administron gjithashtu edhe të dhënat mbi tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të programit, apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Nga vëzhgimi i GVJ pranë Sekretarisë Mësimore u konstatua administrimi në mënyrë tërregullt i të dhënave të studentëve për të gjithë ciklin akademik. Nga të dhënat e institucionit evidentohet si vijon:

Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të transferuarve	Nr i të cregjistruarve	Nr aktual
2019-2020	15	0	0	15
2020-2021	10	0	0	10
2021-2022	14	0	0	14
2022-2023	10	0	0	10
2023-2024	7	0	0	7
Totali	56			

Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 11-23, tabela 21".

Shënime në Institucion

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta

KUB administron informacionin dhe dokumentacionin që lidhet me studentët që ndjekin programet e studimit panë këtij institucioni. Për të mundur përbushjen me sukses të kompetencave të administrimit dhe menaxhimit të dokumentacionit, çdo njësi kryesore e KUB ka Sekretarinë e saj Mësimore. Përgjegjëse për administrimin dhe

dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	menaxhimin e dokumentacionit të studentëve të këtij programi studimi është Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Politike. Me qëllim mirëmenxhimit të të dhënave, një pjesë e të dhënave që u referohen studentëve administrohen jo vetëm në format dokumentar, por edhe elektronik. Ky informacion administrohet nga strukturat kompetente në përputhje me rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar. Përfaqësuesit e institucionit informuan se institucioni po punon për të vënë në zbatim një platformë dixhitale të menaxhimit të informacionit. <i>Evidenca nr.66 “Rregullore e Sekretarisë Mësimore”</i> <i>Evidenca nr. 94 “Regjistri i të dhënave të studentëve AMZA”</i> <i>Evidenca nr. 95 “Regjistri i rezultateve të performancës së studentit”</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Strukturat përgjegjëse të KUB ruajnë dhe administrojnë informacionin mbi të dhënat e studentëve të këtij programi studimi. Informacioni shkresor administrohet në përputhje me rregullat e administrimit dhe arkivimit të informacionit. Informacion mbi të dhënat e studentëve, përveç Sekretarisë Mësimore, disponojnë edhe një sërë strukturash të tjera si departamentet, dekanati, rektorati etj. Aktet e brendshme të institucionit rregullojnë edhe marrëdhëniet hierarkike brenda strukturave, duke përcaktuar për strukturat eprorë kompetenca të vlerësimit dhe kontrollit periodik të informacionit. Rregullorja mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore parashikon se kjo strukturë varet nga Dekanati i Fakultetit, por i përgjigjet në të njëjtën mënyrë edhe kërkesave të autoriteteve më të larta. Kjo rregullore përcakton gjithashtu se Regjistri Bazë i të dhënave të studentëve është objekt kontrolli nga organet e ngarkuara me ligj ose aktet nënligjore. Nëpërmjet akteve të brendshme rregullatore, institucioni rregullon procesin e dhënies së informacionit çdo herë që kërkohet nga autoritetet drejtuese, si dhe vlerësimin dhe kontrollin e saktësisë së tij. Kontrolli i brendshëm i informacionit realizohet edhe në mënyrë periodike gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm nga organet e sigurimit të brendshëm të cilësisë, dhe mëtej, procesit të vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit. <i>Evidenca nr.66 “Rregullore e Sekretarisë Mësimore”</i>

Evidenca nr. 114 "Proces Verbal Verifikimi të dhënash regjistër amze arritje akademike"

Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

Sekretaria Mësimore administron edhe Regjistrin e Arritjeve Akademike të studentëve ku evidentohen të dhënat mbi vlerësimet e studentëve që ndjekin programin e studimit për çdo vit akademik. Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore administrohen dosjet e studentëve ku pasqyrohet edhe informacion mbi notën mesatare të maturës shtetërore. Bazuar në këto të dhëna, institucioni harton dhe administron statistika që i referohen cilësisë së studentëve në hyrje, në fazën e regjistrimit në këtë program studimi, si dhe në dalje në përfundim të ciklit akademik.

Bazuar në këto të dhëna, institucioniharton raporte analitike që i referohen cilësisë dhe rezultateve të vlerësimit të studentëve për secilin nga programet e studimit. KUB ka hartuar raporte edhe lidhur me cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të këtij programi. Këto raporte përdoren si referim edhe në analizën e punës dhe veprimtarisë së Departamentit të Drejtësisë, si njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi. Raporte të tilla shërbejnë njëkohësisht edhe në nxjerrjen e konkluzioneve mbi treguesit që i referohen cilësisë së mësimdhënies dhe marrjen e masave për përmirësimin e treguesve të cilësisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohen të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve në këtë program studimi si vijon:

Viti akademik	Nota mesatare në hyrje	Nota mesatare në dalje, sem I	Nota mesatare në dalje, sem II
2018-2019	7.31	7.6	7.46
	6.99	7.24	8.2
2019-2020	7.4	7.06	8.2
	6.7	7.8	8.5
2020-2021	8.08	7.9	8.43
	6.17	7.59	9.1
2021-2022	7.8	7.6	7.96
	7.8	7.9	9.3
2022-2023	8.14	7.7.	8

		8.2	7.9	8
	Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 11-23, tabela 21"			
Konkluzione	KUB nëpërmjet strukturave përgjegjëse, disponon dhe administron informacionin dhe dokumentacionin që lidhet me studentët që ndjekin këtë program studimi. Administrimi dhe menaxhimi i të dhënave realizohet në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë si dhe aktet e tjera nënligjore. Institucioni harton dhe administron statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të programit, deri në diplomimin e tyre, si dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje. Nëpërmjet akteve të brendshme regullatore, institucioni rregullon procesin e dhënies së informacionit çdo herë që kërkohet nga autoritetet drejtuese, si dhe vlerësimin dhe kontrollin e saktësisë së tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre	KUB ka krijuar mekanizmat e nevojshëm për të mundur angazhimin e studentëve në jetën universitare, si dhe për të tërhequr mendimin e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në organet vendimmarrëse. E drejta për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse të institucionit është pjesë e katalogut të të drejtave të studentëve. Aktet kryesore regullatore si Statuti dhe Regullorja e KUB kanë parashikuar

rregullatore të vetë institucionit.	procedurat e përfaqësimit të studentëve në organet vendimmarrëse të institucionit. Një mekanizëm mjaft i rëndësishëm në këtë drejtim, janë Këshillat Studentorë nëpërmjet të cilave mundësohet përfaqësimi i studentëve në organet drejtuese. Neni 73 i Statutit parashikon se Këshillat e Studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha aspektet me interes të përgjithshëm si, planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtarinë mësimore, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive kulturore dhe sportive etj. Senati Akademik si organi më i lartë vendimarrës përbëhet nga 9 anëtarë të cilët përfaqësojnë njësitë kryesore të KUB, si dhe studentët. Përfaqësuesi i Këshillit Studentor është anëtar i Senatit Akademik. Studentët kanë një përfaqësues edhe në Këshillin e Etikës, NJSBC, GVB etj. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca 11.1 "Anëtarët e Këshillit të Etikës"</i> <i>Evidenca 13.3 "Anëtarët e Senatit Akademik Model Vendimi"</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	KUB mundëson përfaqësimin e studentëve në organet më të rëndësishëm vendimarrës si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Njësia e Sigurimit të Brenshëm të Cilësisë etj. Përfshirja e studentëve ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse është reale dhe mundëson tërheqjen e mendimeve të studentëve si dhe vlerësimin e tyre mbi të gjitha aspektet e jetës universitare. Këshillat e Studentëve shprehin mendime dhe propozime për komponentët me interes të përgjithshëm si, planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtarinë mësimore, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive kulturore dhe sportive në institucion etj. Përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse të institucionit u mundëson atyre të përcjellin shqetësimet e tyre mbi procesin akademik si dhe aspektet që lidhen me jetën studentore. Studentët e shprehin qëndrimin dhe vlerësimin e tyre edhe nëpërmjet pyetësorëve me të cilët vlerësojnë cilësinë e procesit të mësimdhënies, infrastrukturës dhe shërbimeve në funksion të programit mësimor. Pyetësorët e studentëve zhvillohen në të dy semestrat, përpara sezonit të provimeve. Konkluzionet që nxjerr NJSBC nga pyetësorët shërbejnë për marrjen e masave për problematikat e konstatuara nga studentët.

	<i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr 46 "Raport Vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr. 59.2 "Format Vlerësimi i Studentëve IQE"</i> <i>Evidenca 59.4 "Raport i IQE për Studentët 2021"</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Institucioni u mundëson studentëve përfshirjen në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, si dhe reflekton sugjerimet dhe kontributin e tyre. Si pjesë e katalogut të të drejtave të tyre, parashikuar në Statutin dhe aktet e brendshme rregullatore, studentët kanë të drejtë të shprehin vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies dhe programeve të studimit. Tërheqja e mendimit të studentëve mundësohet nëpërmjet përfaqësimit të tyre në organet më të larta vendimmarrëse si Senati Akademik. Senati Akademik është struktura më e lartë e cila bën miratimin përfundimtar të programeve mësimore, si dhe miraton përmirësimet apo ndryshimet e përmbajtjes së tyre deri në 20%. Nëpërmjet përfaqësuesit të tyre në Senat, studentët mund të shprehin mendimin e tyre dhe të japin sugjerime mbi përmirësimin e përmbajtjes së programeve mësimore. Studentët përfaqësohen me një antar edhe në strukturën e NJSBC duke mundësuar shprehjen e qëndrimeve të tyre mbi aspekte të cilësisë të programeve mësimore. Studentëve u mundësohet gjithashtu tërheqja në mënyrë të drejtpërdrejtë e mendimit të tyre, nëpërmjet pyetësorëve, komponent i rëndësishëm i të cilëve është edhe cilësia e programeve mësimore. <i>Evidenca nr 42 "Raport Vjetor i veprimtarive të ZSKK 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr 46 "Raport i NJSBC për Vitin Akademik 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr. 59.2 "Format Vlerësimi i Studentëve IQE"</i> <i>Evidenca 59.4 "Raport i IQE për Studentët 2021"</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e	Nëpërmjet akteve të brendshme, institucioni sanksionon të drejtën e studentëve të shprehin qëndrimin e tyre mbi procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentet shprehin mendimin e tyre mbi procedurën dhe shkallën e vlerësimit të dijeve të tyre, nëpërmjet sistemit të ankimimit. E drejta e ankimimit si një nga të drejtat bazike të studentëve, është pjesë përbërëse e katalogut të të drejtave. Si etillë, aktet e



ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	brendshme, jo vetëm e sanksionojnë këtë të drejtë, por përcaktojnë edhe procedurat e zbatimit në praktikë. Nërregulloret e brendshme ka një sërë parashikimesh mbi sistemin e ankimimit, afatet, procedurat si dhe organet ku mund të drejtohet ankesa. Rregullime të detajuara në këtë drejtim përcakton Rregullorja për Zhvillimin e Provimeve. Rezultatet përfundimtare të vlerësimit u komunikohen studentëve nga pedagogu i lëndës, ose nëpërmjet njoftimit në emailin zyrtar. Nëse studenti ka pretendime mbi rezultatin e provimeve, ai bën një kërkesë me shkrim, jo më vonë se tre ditë nga shpallja e rezultatit. Kërkesa shqyrtohet nga departamentet përkatëse. Nëse është e nevojshme, mund të procedohet edhe me ngritjen një komisioni ad-hoc nga Përgjegjësi i Departamentit, i cili vendos vlerësimin përfundimtar të studentit. Nga takimi i GVJ me studentët, u konfirmua se institucioni u mundëson studentëve mundësinë e ankimimit si dhe reflekton në rishikimin dhe ndryshimin e rezultatit të vlerësimit. <i>Evidenca nr. 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr 7 "Rregullore e Programit të Studimit"</i> <i>Evidenca nr. 64 "Rregullore për zhvillimin e provimeve"</i>			
Konkluzione	<i>KUB ka krijuar mekanizmat e nevojshëm për të mundësuar angazhimin e studentëve në jetën universitare, si dhe për të tërhequr mendimin e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në organet vendimmarrëse. Nëpërmjet akteve të brendshme, institucioni sanksionon të drejtën e ankimimit si dhe u mundëson studentëve të shprehin qëndrimin e tyre mbi procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve.</i> <i>Institucioni u mundëson gjithashtu studentëve përfshirjen në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit si dhe reflekton sugjerimet dhe kontributin e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat

ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet e tij regullatore, institucioni ka procedura, si dhe ka bërë funksionale struktura që së bashku mundësojnë një sistem efikas të informimit, këshillimit dhe mbështetjes së studentëve. Struktura të tilla si: Sekretaria Mësimore, departamenti etj, informojnë dhe orientojnë studentët mbi aspekte që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Në aktet rregullatore të institucionit janë parashikuar procedurat e informimit dhe mbështetjes ndaj studentëve. Procesi i informimit mundësohet që në kontaktet e para me institucionin. Përpara fillimit të procesit mësimor, institucioni mundëson informimin e maturantëve mbi programet mësimore dhe shërbimet në funksion të tyre. Përveç fushatave të informimit, për këtë qëllim, në faqen zyrtare të institucionit publikohet Guida e Studentit, ku pasqyrohen komponentët kryesorë të ofertës akademike të KUB. Faqja zyrtare e KUB është një platformë zyrtare e informimit ku të interesuarit gjejnë informacione mbi aktet rregullatore të institucionit, programet e studimit, personelin akademik, infrastrukturën dhe shërbimet. Kjo faqe përditëson në mënyrë dinamike informacionin. Të dhëna informuese përmbajnë edhe fletëpalosjet, të cilat vihen në dispozicion të të interesuarve dhe opinionit publik. Gjatë gjithë procesit akademik studentët mbështeten dhe orientojnë nga struktura të dedikuara. Një strukturë e rëndësishme në këtë drejtim është edhe Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës. Misioni i kësaj zyre është të jetë sa më afër studentëve duke i mbështetur më këshillim, konsultime, partneritete me qëllim rritjen e tyre profesionale dhe performancë sa më të lartë në tregun e punës. Zyra e Marëdhënieve me Publikun informon studentët mbi aktivitetet që organizon institucioni. <i>Evidenca nr 9 "Rregullore e Studentit dhe e Këshillimit të Karrierës"</i> <i>Evidenca nr.66 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"</i> <i>Evidenca 103 "Guida Studentore KUB Viti Akademik 2023-2024"</i> https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë	KUB mundëson informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve si dhe asistimin nëçështje që lidhen

funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	me procesin mësimor dhe programin e studimit. Për këtë qëllim, një sërë strukturash kordinojnë veprimtaritë midis tyre. Departamenti, si njësi përgjegjëse për administrimin e procesit akademik që i referohet këtij program studimi, nëpërmjet pedagogëve informon studentët mbi komponentët e mësimdhënies dhe procesit mësimor. Sekretaria Mësimore, pranë çdo njësie kryesore ofron shërbime të informimit ndaj studentëve për programet e studimit që mbulon njësi kryesore/ fakulteti. Nëpërmjet paraqitjes fizike studentët mund të marrin informacion në lidhje me aspekte të procesit mësimor gjatë gjithë vitit akademik. Njokohësisht, mund të kërkojnë realizimin e shërbimeve të tilla si: marrjen e dokumentacionit, vërtetimeve etj. Informimi i studentëve nga pedagogët dhe Sekretaria Mësimore mund të realizohet edhe nëpërmjet platformës elektronike të Portalit. Nëpërmjet kësaj platforme studentët aksesojnë të gjitha informacionet nga pedagogët dhe njoftimet dhe informacionet e Sekretarisë Mësimore. Një tjetër platformë e aksesimit të informacionit është faqja web e institucionit, ku gjithashtu gjendet informacion i detajuar mbi të gjithë komponentët e procesit mësimor, jetës akademike, aktiviteteve shkencore si dhe çdo komponent tjetër i ofertës akademike. Si një formë komunikimi dhe shkëmbimi të informacionit mes pedagogëve dhe studentëve, është edhe përdorimi i platformës Google Classroom. Institucioni po punon për përmirësimin e sistemit të dixhitalizuar të informacionit dhe krijimin e një sistemi të integruar të informacionit. Institucioni ka ngritur gjithashtu struktura të posaçme të informimit, orientimit ose këshillimit të studentëve si Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra Mësimore dhe e Kurrikulave, Zyra e Marëdhënieve me Publikun etj. <i>Evidenca nr 1 "RVB Master i Shkencave E Drejtë Penale"</i> <i>Evidenca nr. 74 "Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom_KUB"</i> <i>Evidenca nr. 96 "Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom_KUB"</i> https://kub.portali.kub.edu.al/hyrje https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret	Për tu mundësuar studentëve shërbimin e karrierës, KUB ka ngritur Zyrën e Studentëve dhe e Këshillimit të Karrierës, një strukturë e cila funksionon në nivel institucional. Përveç parashikimeve në rregulloret e brendshme, veprimtaria e zyrës mbështetet në një rregullore të veçantë. Çdo vit

studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	akademik, Zyra e Studentëve dhe e Këshillimit të Karrierës, promovon programet e studimit si dhe orienton dhe mirëpret studentët e rinj. Kjo zyrë u ofron studentëve që ndjekin programet e studimit pranë KUB, shërbimin ekëshillimit të karrierës profesionale dhe orientim në tregun e punës. Për këtë qëllim, zyra ka përgatitur edhe Udhëzuesin e Karrierës, një dokument informativ që u shërben studentëve për përgatitjen në procesin e kërkimit në tregun e punës, komunikimin me punëdhënësit, përgatitjen e CV profesionale etj. Nëpërmjet bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe private si dhe biznese të ndryshme, zyra mundëson realizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me qëllim përmbushjen me sukses të praktikave profesionale. <i>Evidenca nr. 4 “Rregullore e KUB”</i> <i>Evidenca nr 9 “Rregullore e Studentit dhe e Këshillimit të Karrierës”</i> <i>Evidenca nr 41 “Plani Vjetor i Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës”</i>								
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Përveç funksioneve të këshillimit dhe orientimit të studentëve që vijojnë procesin mësimor pranë KUB, Zyra e Studentëve dhe e Zhvillimit të Karrierës ushtron edhe kompetenca të gjurmimit të studentëve pas diplomimit. Zyra ndjek studentët pas diplomimit, kryen kërkime për të evidentuar ecurinë e punësimit të studentëve, si dhe cilësinë e punësimit të tyre. Të dhënat e kësaj zyre mbi shkallën e punësimit të studentëve shërbejnë për të evidentuar përputhshmërinë e programeve të studimit që KUB ofron me tregun e punës dhe marrjen e masave për përshtatjen e mëtejshme të kurrikulës me kërkesat e tregut. Kjo zyrë ka kryer kërkime dhe studime të tregut të punës edhe mbi nivelin e punësimit të studentëve të këtij programi studimi. Nëpërmjet kërkimeve gjurmuese të studentëve Alumni, zyraka hartuar të dhëna statistikore mbi shkallën e përgjithshme të punësimit të studentëve të këtij programi, si dhe shkallën e punësimit sipas profileve për çdo vit akademik. Nga studimi i kryer rezultojë të dhënat si vijojnë: <table><tr><th>Viti Akademik</th><th>Te diplomuar</th><th>Të punësuar në përputhje me diplomën</th><th>Të punësuar jo në përputhje me diplomën</th></tr><tr><td>2019-2020</td><td>11</td><td>10</td><td>1</td></tr></table>	Viti Akademik	Te diplomuar	Të punësuar në përputhje me diplomën	Të punësuar jo në përputhje me diplomën	2019-2020	11	10	1
Viti Akademik	Te diplomuar	Të punësuar në përputhje me diplomën	Të punësuar jo në përputhje me diplomën						
2019-2020	11	10	1						

	2020-2021	15	13	2
	2021-2022	9	8	1
	2022-2023	9	9	0
	<i>Evidenca nr 9 "Rregullore e Studentit dhe e Këshillimit të Karrierës"</i> <i>Evidenca nr 41 "Plani Vjetor i Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës"</i> <i>Evidenca nr 42 "Raporti vjetor i veprimtarive të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës"</i> <i>Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 11-23, tabela 23"</i>			
Konkluzione	<i>Në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet e tij regullatore, institucioni ka procedura, si dhe ka bërë funksionale struktura, që së bashku mundësojnë një sistem efikas të informimit, këshillimit dhe mbështetjes së studentëve.</i> <i>Për tu mundësuar studentëve shërbimin e karrierës, KUB ka ngritur struktura të posaçme që orientojnë studentët në tregun e punës si dhe zhvillimin e karrierës.</i> <i>Këto struktura ndjekin në vazhdimësi karrierën e studentëve edhe pas diplomimit dhe kryejnë kërkime për të evidentuar ecurinë e punësimit të studentëve si dhe cilësinë e punësimit të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Rritja e standarteve akademike është pjesë e vizionit që institucioni synon të krijojë, pasqyruar në strategjitë zhvillimore. Një nga politikat bazë të zhvillimit të cilësisë në KUB, është cilësia në mësimdhënie. Në planin e zhvillimit strategjik për vitin 2021-2026 pasqyrohet vizioni i institucionit për të krijuar një model të arsimit të lartë që kombinon standartet akademike me aplikimet më bashkëkohore. Për përmbushjen e këtij vizioni, KUB ka krijuar infrastrukturën e nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të teknologjive inovative të mësimdhënies. Të gjitha mjediset e mësimdhënies janë të paisura me mjete audiovizive, kompjutera si dhe akses të palimituar në internet. Paisjet kompjuterike janë të lidhura dhe mundësojnë aksesin në internet. Përdorimi i platformave teknologjike si portali, lehtësojnë procesin e mësimdhënies, komunikimin student pedagog si dhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm në funksion të procesit të mësimdhënies si syllabuset e lëndëve, leksionet, literaturën e rekomanduar, detyrat dhe esetë etj. Mësimdhënia në këtë program studimi orientohet në përputhje me qëllimin e programit i cili synon të formojë ekspertë dhe specialistë cilësorë si në aspektet teorike, ashtu edhe në aftësitë aplikative në fushën e së drejtës penale. Në përputhje me objektivat formues të programit, personeli akademik nëpërmjet trajnimeve, nxitet të përdorë metoda inovative të mësimdhënies që aftësojnë studentët, jo vetëm me njohuritë teorike, por edhe me ato praktike. <i>Evidenca nr. 2. "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca 14.1 "Politikat e zhvillimit të cilësisë në KUB"</i> <i>Evidenca 74 "Guida e stafit për përdorimin e platformës Classroom KUB"</i> <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i> <i>Evidenca nr 99 "Trajnimet e Personelit Akademik të FDSHP"</i>

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Cilësia e mësimdhënies është pjesë e standarteve të cilësisë të cilat vlerësohen dhe monitorohen nga strukturat e brendshme të vlerësimit të cilësisë. Aktet rregullatore të institucionit kanë parashikuar sistemin e kontrollit të cilësisë së mësimdhënies që nga organet më të larta hierarkike dhe ngritjen e strukturave përgjegjëse në këtë drejtim. Sigurimi i brendshëm i cilësisë në nivel institucional është detyrë e Senatit Akademik si organi më i lartë vendimarrës. Për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, në nivel institucional funksionon Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në kuadrin e veprimtarisë së saj, në fushën e sigurimit të brendshëm të cilësisë, realizon vlerësime periodike për veprimtarinë mësimore dhe atë kërkimore shkencore. Kjo zyrë vlerëson një herë në vit efikasitetin e veprimtarive mësimore kërkimore, financiare dhe administrative të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Politike pjesë e të cilit është edhe Departamenti i Drejtësisë, njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi. Drejtuesi i Departamentit të Drejtësisë, në kuadrin e kompetencave të përcaktuara në Rregulloren e njësive bazë, mbikqyr veprimtarinë mësimore dhe shkencore të stafit. <i>Evidenca nr. 2. "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca nr 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i> <i>Evidenca nr 14 " Rregullore e Zyrës së NJSBC"</i> <i>Evidenca 46.3 "Format Pyetësori i Studentit KUB"</i> <i>Evidenca 59.3 Raport i IQE për studentët 2021"</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Format dhe metodat e mësimdhënies së stafit akademik janë komponent i vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Si të tilla, ato vlerësohen dhe monitorohen nga strukturat e brendshme të vlerësimit të cilësisë. KUB ka ngritur një sërë mekanizmesh të vlerësimit të cilësisë duke mundësuar përfshirjen dhe shprehjen e opinionit të studentëve në këtë proces. Një nga komponentë e vlerësimit të cilësisë është vlerësimi në fund të çdo semestri i cilësisë së çdo lënde/moduli si dhe aftësisë së mësimdhënies. Mekanizmi kryesor në këtë drejtim janë pyetësorët e studentëve, nëpërmjet të cilëve ata vlerësojnë përmbajtjen e programeve të lëndëve si dhe procesin dhe aftësitë e mësimdhënies. Në këto sondazhe studentët japin vlerësimet e tyre mbi aspekte të procesit të mësimdhënies si aftësia dhe metodat e mësimdhënies, niveli i konkretizimit të teorisë me praktikën, niveli i përdorimit të

	mjeteve didaktike në procesin e mësimdhënies etj. Nëpërmjet sistemit të ankimimit, si një nga të drejtat themelore të tyre, studentët mund të shprehin qëndrimet e tyre jo vetëm mbivlerësimin e dijeve, por edhe çdo aspekt tjetër që lidhet me procesin akademik. <i>Evidenca nr 14 “ Rregullore e Zyrës së NJSBC ”</i> <i>Evidenca 46.3 “Format Pyetësori i Studentit KUB”</i> <i>Evidenca 59.3 Raport i IQE për studentët 2021 ”</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet që vijnë nga proceset e vlerësimit të cilësisë janë pjesë e raporteve që strukturat e sigurimit të cilësisë hartojnë në kuadrin e veprimtarisë periodike të monitorimit. Struktura kryesore në këtë drejtim është NJSBC. Rregullorja e funksionimit të kësaj njësie kasanksionuar parimin e transparencës në lidhje me politikat, veprimtaritë dhe strategjitënë kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Bazuar në këtë parim, këto veprimtari janë transparente dhe bëhen të njohura për studentët dhe gjithë të interesuarit. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin mbi të dhënat personale (neni 6). Rezultatet e vlerësimit që vijnë nga veprimtaritë e monitorimit dhe anketimet, fillimisht i paraqiten rektoratit, dhe më tej fakulteteve dhe departamenteve. Bazuar në rezultatet e raporteve të vlerësimit të cilësisë, departamenti merr masat e nevojshme për përmirësimin e performancës. <i>Evidenca nr 14 “ Rregullore e Zyrës së NJSBC ”</i> <i>Evidenca nr 46.1 “Vendim i SA për miratimin e raportit vjetor të NJSBC”</i> <i>Evidenca 59.3 Rraport i IQE për studentët 2021 ”</i> <i>Evidenca 59.3 Rraport i IQE për Stafin Akademik 2021 ”</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Institucioni përdor një gamë të gjerë të mekanizmave të vlerësimit të cilësisë si sondazhet e studentëve, pyetësorët e stafit, monitorimi nga Departamenti etj. Bazuar në rezultatet e monitorimit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, NJSBCharton raportet e vlerësimit të cilësisë në nivel institucional. Në funksion të konkluzioneve që dalin nga këto raporte, institucioni merr masat e duhura që i shërbejnë përmirësimit të performancës së stafit akademik si, trajnime apo aktivitete që synojnë kualifikimin akademik. Institucioni përdor gjithashtu mekanizma stimulues të personelit me performancë pozitive. Institucioni i jep prioritet stafit me

	performancë pozitive në pjesëmarrjen në projekte shkencore apo veprimtari në kuadrin e programeve të partneritet apo mobilitetit. Vlerësimi i performancës që i referohet cilësisë së mësimdhënies stimulohet nëpërmjet mekanizmave financiarë dhe shpërblyes. <i>Evidenca A. 3.42 "Raport Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022"</i> <i>Evidenca nr 69 "Raport Vjetor i Punës Kërkimore dhe Shkencore dhe Projektet, KUB"</i> <i>Evidenca nr 75 "Plani i aktiviteteve për përmbushjen e rezultateve të pyetësorëve në kuadër të përmirësimit të standarteve të cilësisë në KUB"</i> <i>Evidenca nr 98 "Pjesëmarrjet e e Personelit Akademik në projekte"</i> <i>Evidenca nr 99 "Trajnimet e Personelit Akademik të FDSHP"</i>			
Konkluzione	<i>Rritja e cilësisë së mësimdhënies është pjesë e vizionit që institucioni synon të krijojë, pasqyruar në strategjitë e zhvillimit institucional.</i> <i>Format dhe metodat e mësimdhënies janë komponent i vlerësimit të brendshëm të cilësisë dhe monitorohen nga strukturat e brendshme të vlerësimit të cilësisë.</i> <i>Institucioni nxit përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe promovimin e praktikave më të mira në vlerësimin e performancës së personelit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet	Mbështetur në Statutin, aktet rregullatore si dhe Ligjin nr.80/2015 dt. 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", KUB ka hartuar politika dhe strategji, si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë dhe përmirësimi i

ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	vazhdueshëm i komponentëve të saj, është pjesë e planeve strategjike të zhvillimit të institucionit. KUB ka hartuar dhe pasqyron politikat e tij të sigurimit të cilësisë në dokumenta ku parashikohen parimet dhe standartet e sigurimit të cilësisë. Referuar politikave të sigurimit të cilësisë, katër shtyllat bazë të sigurimit të cilësisë në KUB janë: 1. Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie; 2. Sigurimi i cilësisë në kërkim shkencor; 3. Sigurimi i cilësisë në rekrutimin, menaxhimin dhe zhvillimin e personelit akademik; 4. Sigurimi i cilësisë në proceset e përzgjedhjes dhe orientimit të studentëve; Për zbatimin e politikave të sigurimit të cilësisë dhe monitorimin e cilësisë, KUB ka krijuar edhe strukturat e sigurimit të cilësisë. Strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë: Senati Akademik; Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe Zyra e Kurrikulave. <i>Evidenca nr 1. "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr 2 "Plani Strategjik i Zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca nr 8. "Rregullorja e Zyrës së Kurrikulave"</i> <i>Evidenca nr 14. "Rregullorja e Zyrës së NJSBC"</i> <i>Evidenca nr 14.1 "Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në përputhje me politikat e zhvillimit të cilësisë, institucioni ka zhvilluar sistemin e tij të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Të gjitha strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë duhet të respektojnë standartet, parimet dhe objektivat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional. Senati Akademik i KUB është organi kryesor përgjegjës që garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion në përputhje me standartet shtetërore. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një njësi e pavarur që vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore, kërkimore dhe shkencore. Kjo njësi i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë Rektorit mbi rezultatet e evidentuara. Referuar Statutit të KUB, kjo njësi harton standartet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë, harton dhe organizon pyetësinë me studentët për cilësinë e programeve dhe performancës së pedagogëve, realizon studime gjurmuese mbi cilësinë e punësimit të studentëve. Edhe struktura të tjera si Zyra e Kurrikulave, në kuadrin e kompetencave të tyre kryejnë veprimtari në fushën e cilësisë.

	Zyra e Kurrikulave siguron përputhshmërinë e kurrikulave me kërkesat e legjislacionit për arsimin e lartë. Kjo zyrë mundëson zbatimin e standarteve kombëtare dhe atyre europiane të cilësisë në hartimin dhe zbatimin e kurrikulave. KUB rishikon në mënyrë periodike strukturën e brendshme të cilësisë për të siguruar përshtatshmërinë e saj me strategjinë institucionale të zhvillimit. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr 2 "Plani Strategjik i Zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca nr 14.1 "Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	KUB i ka përdorur instrumentet e nevojshëm të sigurimit të cilësisë si në nivel institucional, ashtu edhe për programet e studimit. Institucioni kryen vlerësimin e jashtëm të cilësisë si dhe akreditimin periodik institucional. KUB i është nënshtruar proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe akreditimit institucional si dhe të programeve të studimit, në përputhje me kriteret e legjislacionit për arsimin e lartë. KUB është liçensuar me Vendimin nr. 651 datë 14.09.2011 "Për Liçensimin e Akademisë Profesionale të Biznesit". Ka realizuar akreditimin institucional në vitin 2012 dhe më tej, akreditimet periodike në vitin 2017 dhe 2022. Me vendim nr. 3 datë 07.01.2022 "Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar i Biznesit" është akredituar institucionalisht për 4 vite akademike deri në vitin 2026. Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E drejtë Penale" është hapur me VKM nr. 651, datë 14.09.2011 "Për liçensimin si institucion i arsimit të lartë mësimor 2011-2012". Akreditimi i parë i këtij programi studimi është bërë me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sporteve nr. 545, datë 13.11.2012. Ky program është riakredituar me vendim nr. 78, datë 27.10.2018 të Bordit të Akreditimit. Ky program është në process të akreditimit periodik. <i>Evidenca nr. 15. "Dokumentacioni mbi liçensimin e programit të studimit"</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara	Në përputhje me aktet rregullatore, institucioni përdor treguesit e duhur të cilësisë për vlerësimin e gjendjes, si dhe identifikimin e anëve pozitive dhe mangësive. Institucioni ka përcaktuar tregues që identifikojnë cilësinë e programit të studimit si mësimdhënia, kurrikula etj, si dhe përcaktojnë arritjet më të mira dhe mangësitë më qëllim përmirësimin e

dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	vazhdueshëm të cilësisë. Programet mësimore i nënshtrohen proceseve të vlerësimit të brendshëm të cilësisë si dhe vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit. Aktet rregullatore të institucionit i japin një hapësirë të gjerë proceseve të sigurimit të cilësisë dhe komponentëve të vlerësimit të cilësisë si mësimdhënia, kërkimi shkencor dhe kualifikimi i personelit akademik. Mbi bazën e vlerësimit dhe analizës së treguesve të cilësisë, institucioni nxit dhe promovon arritjet më të mira në komponentët e programit të studimit. Performanca e punës kërkimore dhe cilësia e mësimdhënies së stafit vlerësohen nëpërmjet promovimit të personelit akademik edhe stimuljeve financiare. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr 14.1 "Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i> <i>Evidenca nr 46 "Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023"</i>			
Konkluzione	<i>Sigurimi i brendshëm i cilësisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i komponentëve të saj është pjesë e politikave zhvillimore në rang institucional.</i> <i>Institucioni ka zhvilluar sistemin e tij të sigurimit të cilësisë, si dhe ka përdorur instrumentet e duhur të sigurimit të cilësisë si në nivel institucional, ashtu edhe për programet e studimit.</i> <i>KUB i është nënshtruar proceseve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë dhe akreditimit institucional në përputhje me kriteret e legjislacionit për arsimin e lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara	Mbikqyrja dhe vlerësimi i cilësisë të programit të studimit është një nga treguesit që institucioni përdor për sigurimin e cilësisë në nivel institucional. Në kuadrin e masave të vlerësimit të cilësisë, KUB përdor një sërë instrumentash për



për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit që ofron. Vlerësimi i cilësisë së programevetë studimit realizohet çdo vit akademik nëpërmjet proceseve të ndryshimit dhe përmirësimit të programeve mësimore të lëndëve/moduleve. Nëse konsiderohet e nevojshme, ndërhyhet edhe në kurrikulat e programeve mësimore. Ky proces përfshin një sërë strukturash si Departamenti i Drejtësisë, Dekanati, Zyra e Kurikulës, NJSBC dhe Senatit Akademik. Departamenti është njësia përgjegjëse për programet të studimit që ofron dhe ka si mision hartimin, rishikimin, përmirësimin dhe zhvillimin e programeve të të gjitha niveleve në fushën që mbulon. Departamenti është gjithashtu përgjegjës për ruajtjen e standarteve të cilësisë së programeve mësimore. Në kuadrin e kompetencave të tij, departamenti inicion proceset e përmirësimit të programit mësimor duke propozuar ndryshimet përkatëse. Zyra e Kurrikulave gjithashtu, kordinon veprimtarinë esaj me njësinë bazë si dhe njësinë kryesore në procesin e hartimit dhe ndryshimit të programeve mësimore dhe kurrikulave. Në kuadrin e mbikëqyrjes së programeve të studimit institucioni ka përdorur edhe metoda të tjera, përfshirë edhe feedbackun që merret nga studentët nëpërmjet anketimeve. Përpara fillimit të sezonit të provimeve NJSBC tërheq mendimin e studentëve edhe mbi cilësinë e programeve mësimore nëpërmjet sistemit të pyetësorëve. Gjetjet dhe konkluzionet që rezultojnë nga këto sondazhe janë pjesë e analizave vjetore dhe u referohen strukturave përkatëse për marrjen e masave konkrete për përmirësimin e programeve të studimit të ofruara. <i>Evidenca nr 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i> <i>Evidenca nr 8 "Rregullore e Zyrës së Kurrikulave"</i> <i>Evidenca nr 28 "Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022"</i> <i>Evidenca nr 31 "Raporti vjetor i veprimtarive Departamenti i Drejtësisë Viti Akademik 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr 46 "Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023"</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra	Institucioni përdor një sërë instrumentash të vlerësimit të komponentëve të cilësisë. Nëpërmjet këtyre instrumentave, institucioni vlerëson programet e studimit që ofron, cilësinë e mësimdhënies si dhe kualifikimin shkencor të stafit akademik, standartet e infrastrukturës etj. Gjetjet dhe konkluzionet që rezultojnë nga proceset e vlerësimit, janë objekt i raporteve të strukturave përgjegjëse për sigurimin e cilësisë. Një sërë

për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	strukturash si NJSBC, departamentet dhe fakultetet hartojnë raporte apo analiza vjetore të veprimtarisë së tyre. Raportet vjetore hartohen gjithashtu edhe në rang institucional. Raporti vjetori i institucionit ka si objekt kryesor të analizojë realizimin e përgjegjësive të njësive përbërëse të KUB për vitin në të cilin realizohet analiza, si dhe të përcaktojë objektivat e zhvillimit për të ardhmen. Një format të ngjashëm gjejmë edhe në raportet e hartuara mbi veprimtarinë e njësive kryesore apo atyre bazë. Në raportet e NJSBC janë evidentuar rezultate që vijnë nga vlerësimi i treguesve të cilësisë, elementët cilësorë dhe mangësitë e konstatuara, si dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë në institucion. Gjetjet e këtyre raporteve shërbejnë për hartimin e planeve të veprimit dhe ndërmarjen e masave konkrete që i referohen përmirësimit të komponentëve të cilësisë. <i>Evidenca nr 3 "Plani i masave të KUB për vitin akademik 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr 28 "Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022"</i> <i>Evidenca nr 30 Evidenca nr 31 "Raporti vjetor i veprimtarive FDSHP Viti Akademik 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr 31 "Raporti vjetor i veprimtarive Departamenti i Drejtësisë Viti Akademik 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr 46 "Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023"</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo	Me qëllim vlerësimin e cilësisë dhe mbarëvajtjes së këtij programi studimi, KUB ka përdorur një sërë metodash dhe instrumentash të drejtpërdrejta të vlerësimit. Këto metoda i referohen si vlerësimit të kurrikulës dhe përmbajtjes së programit të studimit, ashtu edhe vlerësimit të komponentëve të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Departamenti si njësi përgjegjëse bazë për zbatimin e programit të studimit është struktura kryesore që vë në zbatim metodat e drejtpërdrejta të vlerësimit të mësimdhënies. Si metoda të tilla përdoren testimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat ekursit, praktika profesionale etj. Këto metoda pasqyrohen në syllabuset e lëndëve/ moduleve apo kurrikulën e programit mësimor. Për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, institucioni gjithashtu përdor një sërë metodash, si sondazhet e studentëve, vlerësimi i punës nga Departamenti, vëzhgimi i zhvillimit të mësimin në auditor për personelin akademik pa përvojë etj. Në funksion të vlerësimit të cilësisë së programit të



kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	studimit institucioni realizon gjithashtu edhe analiza të vlerësimit të cilësisë së studentëve në hyrje dhe në dalje. <i>Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 11-23".</i> <i>Evidenca 32.3 "Planet Mësimore të programit të studimit"</i> <i>Evidenca 32.4 "Syllabuset e lëndëve Moduleve të programit të studimit"</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Në kuadër të vlerësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit, institucioni përdor edhe një sërë instrumentash të tërthorta të vlerësimit. Programet e studimit që KUB ofron, i nënshtrohen procesit të vlerësimit të brendshëm dhe atij të jashtëm, si dhe akreditimit. Nëpërmjet procesit të brendshëm të vlerësimit, vlerësohet cilësia e programit në të gjithë komponentët e tij. Vlerësimit të brendshëm të cilësisë i nënshtrohen edhe strukturat ndihmës akademike dhe ato administrative. Në kuadër të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, institucioni harton pyetësorët me studentët mbi aspektet që lidhen me cilësinë e programit, mësimdhënien kurrikulën, shërbimet etj. Për të vlerësuar përputhshmërinë e objektivave të programit me kërkesat e tregut të punës, institucioni realizon sondazhe mbi nivelin e punësimit të studentëve. Sondazhe të tilla janë zhvilluar edhe me studentët e këtij programi studimi. <i>Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 11-23".</i> <i>Evidenca 116.23 "Të dhëna për Diplomimin dhe Punësimin e studentëve"</i>
Konkluzione	<i>Nëpërmjet mekanizmave të brendshëm të cilësisë KUB mbikqyr dhe vlerëson në mënyrë periodike programet e studimit.</i> <i>Për vlerësimin e komponentëve të cilësë institucioni përdor një sërë instrumentash të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vlerësimit.</i> <i>Gjetjet dhe konkluzionet që rezultojnë nga proceset e vlerësimit pasqyrohen në raporte ku evidentohen elementët cilësorë dhe mangësitë e konstatuara, si dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë në institucion.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni ka hartuar politika dhe zbaton procedura të vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Politikat e cilësisë KUB i ka pasqyruar në akte të posaçme, të cilat hartohen dhe orientohen me qëllim përputhjen me planet strategjike të zveçillimit. Gjithashtu, në aktet e brendshme rregullatore përcakton modalitetet e përfshirjes dhe kompetencat e aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit të cilësisë. Një sërë strukturash si Senati Akademik, NJSBC, Zyra e Kurrikulave, fakultetet, departamentet etj, ushtrojnë kompetencat e tyre në vlerësimi priodik të komponentëve të cilësisë. Në këtë proces përfshihen edhe studentët, të cilët shprehin mendimin e tyre nëpërmjet pyetësorëve dhe sondazheve. Institucioni nëpërmjet proceseve gjurmuese përpikët të mbajë kontakte dhe të përfshijë në këto procese edhe studentët Alumni. KUB ka mundësuar përfshirjen në proceset e vlerësimit të cilësisë të këtij programi studimi edhe bashkëpunëtorë të huaj si IQE, Grant Thourton etj. <i>Evidenca 2 "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca "Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit"</i> <i>Evidenca 14.1 "Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i> <i>Evidenca nr 59.3 "Raport i IQE për studentët 2021"</i> <i>Evidenca nr 59.3 "Raport i IQE për Stafin Akademik 2021"</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton	Institucioni ka hartuar një bazë të gjerë rregullatore me të cilën rregullon të gjitha aspektet e jetës akademike. Nëpërmjet akteve të brendshme, të përgjithshme ose të posaçme, KUB përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për strukturat, njësitë, studentët si dhe të gjitha palët e angazhuara në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Rregullime të detajuara që i referohen vlerësimit të cilësisë në këtë program studimi parashikon, Statuti dhe Rregullorja e KUB, Rregullorja e

ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	NJSBC, Rregullorja e FDSHP si dhe Rregullorja e Departamentit të Drejtësisë. Edhe në instrumenta të tjere me natyrë të posaçme si Politikat e Zhvillimit të Cilësisë, përcaktohen jo vetëm politikat institucionale të cilësisë, por edhe aktorët përgjegjës për zbatimin e tyre. Nëpërmjet sistemit të raportimeve të veprimtarive, mbikqyrjes dhe monitorimit nga strukturat hierarkike, garantohet përmbushja dhe ushtrimi me përgjegjësi i kompetencave të të gjithë aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit dhe monitorimit periodik të cilësisë. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr 5 "Rregullore e Njësive Kryesore FDSHP"</i> <i>Evidenca nr 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i> <i>Evidenca 14.1 "Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Institucioni nëpërmjet akteve të brendshme përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë bazë dhe kryesore përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, atij ndihmës akademik dhe administrativ, studentët dhe gjithë palët e përfshira në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në aktet rregullatore të brendshme të KUB si Statuti dhe Rregullorja e KUB, përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat konkrete që ka secili nga aktorët në proceset e vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Në rregulloret e njësive kryesore dhe njësive bazë, përcaktohen roli dhe përgjegjësitë e këtyre njësive në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë të programeve të studimit që mbulojnë. Përbërja e njësive të sigurimit të cilësisë si NJSBC nga personel akademik dhe përfaqësues të studentëve, mundëson një bashkëpunim më të mirë të kësaj njësie me personelin akademik dhe studentët në proceset e vlerësimit të programeve të studimit. Ky bashkëpunim ka lehtësuar proceset e vlerësimit të brendshëm të cilësisë si vlerësimi i performancës së stafit, vlerësimi nga studentët i programit të studimit etj. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr 5 "Rregullore e Njësive Kryesore FDSHP"</i> <i>Evidenca nr 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i> <i>Evidenca 65 "Vlerësim performance stfi-TIP"</i>

Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nëpërmjet procesit të sigurimit të cilësisë, KUB synon të evidentojë informacion të saktë dhe të besueshëm lidhur me të gjithë komponentët institucionalë të cilësisë dhe të programeve të studimit. Gjithashtu, institucioni synon të aktivizojë në këtë proces të gjithë aktorët, të cilët kontribuojnë në zhvillimin e programit të studimit si dhe shërbimet dhe mbështetjen institucionale të tij. Në të gjithë veprimtarinë e tij, përfshirë edhe atë të sigurimit të cilësisë, KUB mbështetet në parimet kushtetuese dhe ligjore. Kjo përbën edhe një nga principet e zhvillimit të veprimtarisë, pasqyruar në planetstrategjike të zhvillimit. Si pasojë, ai zbaton dhe respekton në proceset e vlerësimit periodik të cilësisë parimin e barazisë dhe mos diskriminimit, si parime ligjore kushtetuese. Respektimit të këtyre parimeve i shërben edhe përfshirja e strukturave të pavarura si IQE në procesin e vlerësimit nëpërmjet sondazheve dhe më tej hartimit të raporteve dhe rezultateve. <i>Evidenca 2 "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nëpërmjet politikave të tij, institucioni mundëson angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në proceset e vlerësimit të cilësisë në këtë programi studimi. Gjithashtu, bën të mundur që kontributet e tyre në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë të jenë reale dhe me rezultate konkrete. Një nga format e angazhimit të aktorëve të jashtëm, është përfshirja e stafit akademik me kontratë në procesin e mësimdhënies në Programin Msc në "E drejtë Penale". Në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi ka një numër të konsiderueshëm të personelit akademik me kontratë. Anëtarët e personelit akademik me kontratë kanë kualifikime të larta akademike dhe eksperiencën profesionale në fusha që lidhen me përmbajtjen e programit të studimit. Si rrjedhojë, ata kontribuojnë në rritjen e përputhshmërisë së programit me kërkesat e tregut të punës dhe cilësinë e programit. Përfaqësues të stafit akademik me kontratë ishin pjesëmarrës në takimin e GVJ me stafin akademik ku ndanë edhe mendimet dhe vlerësimet e tyre mbi procesin e vlerësimit të programit të studimit. Nëpërmjet marrëveshjeve me kompani të huaja të lidhura në nivel instituciona, KUB ka mundësuar ekspertizën e huaj në proceset që i referohen sigurimit të cilësisë. Një prej tyre është IQE, e cila realizon çdo vit pyetësin e studentëve dhe atë të personelit akademik. Në këtë mënyrë është mundësuar përfaqësimi i ekspertëve të jashtëm në strukturat

	përgjegjëse për sigurimin e cilësisë si NJSBC si dhe kontributi i tyre në proceset e vlerësimit të cilësisë. <i>Evidenca nr 59.3 "Raport i IQE për studentët 2021"</i> <i>Evidenca nr 59.3 "Raport i IQE për Stafin Akademik 2021"</i> <i>Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 1-10, tabela 2, tabela 8".</i>			
Konkluzione	<i>Në aktet e brendshme KUB rregullon angazhimin si dhe përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit të cilësisë.</i> <i>Nëpërmjet politikave të tij të sigurimit të cilësisë, institucioni mundëson që ky angazhim të jetë konkret dhe me rezultate pozitive.</i> <i>Institucioni mundëson gjithashtu angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në proceset e vlerësimit të cilësisë së këtij programi studimi.</i> <i>Përfshirja e të gjithëaktorëve në procesin e vlerësimit të cilësisë realizohet në përputhje me parimin e barazisë dhe mos diskriminimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	KUB pasqyron politikat, strategjitë dhe procedurat që zbatohen në kuadrin e procesit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në planet strategjike të zhvillimit, politikat e sigurimit të cilësisë dhe raportet vjetore të NJSBC. Edhe aktet e brendshme të KUB, si Statuti dhe Rregullorja e KUB, apo akte të tjera rregullatore, kanë parashikime që referohen procedurave dhe strukturave të sigurimit të cilësisë. Tërësia e akte rregullatore të tilla dhe dokumentave të tjerë si, raportet vjetore të veprimtarisë së NJSBC, bëhen publike për studentët dhe gjithë të interesuarit nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të institucionit.

	Veprimtaritë dhe rezultatet që vijnë nga procesi i sigurimit të brendshëm të cilësisë komunikohen fillimisht në Rektorat. Më tej, ato u bëhen të njohura departamenteve apo strukturave drejtuese nëpërmjet sistemit të brendshëm të komunikimit. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në strukturat e sigurimit të cilësisë si, Senati Akademik apo NJSBC. Kjo mundëson që ata të jenë pjesëmarrës në proceset e vlerësimit të cilësisë. Studentët mund të aksesojnë informacion edhe nëpërmjet Guidës së Studentit apomaterialeve të tjera informuese që institucioni publikon për studentët në faqen web. https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Sistemi i sigurimit të cilësisë, ashtu si edhe gjithë veprimtaria e KUB bazohet në disa parime themelore të parashikuara në dokumentat dhe aktet e brendshme regullatore. Një nga parimet bazë të veprimtarisë së institucionit, është parimi i lirisë akademike parashikuar në Statutin e KUB. Në dokumenta të tjerë, institucioni përcakton parimin e ushtrimit të veprimtarisë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi. Plani strategjik i zhvillimit përcakton se KUB e bazon aktivitetin e tij në parimet kushtetuese dhe ligjore. Në të gjithë veprimtarinë e tij, përfshirë edhe atë të sigurimit të cilësisë, KUB mbështetet në parimet kushtetuese dhe ligjore. Mbrojtja e të dhënave personale është një parim ligjor mjaft i rëndësishëm parashikuar në një ligj të veçantë, i cili sanksionon modalitetet dhe detyrimet në ruajtjen e të dhënave personale. Si pasojë, politika dhe procedurat mbi publikimin e materialeve që i referohen veprimtarisë institucionale bëhen në përputhje me rregullat e etikës akademike dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca 2 "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Një sërë strukturash si NJSBC, departamentet dhe fakultetet hartojnë raporte apo analiza vjetore të veprimtarisë së tyre ku evidentojnë çështje që referohen komponentëve të cilësisë. Në nivel institucional, në kuadrin e proceseve të vlerësimit të brendshëm, hartohen raportet vjetore të NJSBC. Në përmbajtjen e këtyre raporteve evidentohen rezultatet që vijnë nga vlerësimi i treguesve të cilësisë, elementët cilësorë dhe mangësitë e konstatuara, si dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë në institucion.

	Gjetjet e këtyre raporteve shërbejnë për hartimin e planeve strategjike të zhvillimit dhe planet e masave për përmirësimin e komponentëve të cilësisë. Këto rekomandime u adresohen strukturave të caktuara me sigurimin e cilësisë, të cilat në kuadrin e strategjive për përmirësimin e cilësisë, hartojnë edhe plane konkrete për masat që do të ndërmeren me qëllim arritjen e objektivave të kërkuara. Gjithashtu edhe raporti i hartuar nga GVB në kuadrin e proceseve të vlerësimit periodik të cilësisë, shoqërohet nga analiza SWOT ku evidentohen pikat e forta, pikat e dobta si dhe rekomandimet për përmirësimin e mangësive. <i>Evidenca 2 "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca nr 3 "Plani i masave të KUB për vitin akademik 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr 46 "Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr 75 "Plani i aktiviteteve për përmbushjen e rezultateve të pyetësorëve në kuadrin e aktiviteteve të përmirësimit të cilësisë"</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Përmirësimi i mekanizmave të cilësisë përbën një nga objektivat strategjike të KUB, pasqyruar në strategjitë institucionale. Institucioni vlerëson efektivitetin e veprimtarive të ndërmara në kuadër të vlerësimit të cilësisë të programit të studimit, si dhe ndërmer masat për përmirësimin e cilësisë. Fillimisht evidentohen gjetjet e këtyre raporteve, të cilat u bëhen të njohura strukturave përgjegjëse për sigurimin e cilësisë. Më tej, rekomandimet e evidentuara shërbejnë për hartimin e planeve strategjike të zhvillimit dhe planet e masave për përmirësimin e komponentëve të cilësisë. Në këtë proces përfshihen një numër sa më i gjerë strukturash, nga niveli institucional deri në nivelin e njësive bazë, si Senati Akademik, NJSBC, fakultetet, departamentet etj. Një kontribut me vlerë në vlerësimin e efektivitetit të veprimtarive të vlerësimit të cilësisë të këtij programi studimi, luan Departamenti i Drejtësisë. Departamenti si struktura përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit, reflekton nëpërmjet marrjes së masave konkrete që lidhen me përmirësimin e kurrikulës, programeve të lëndëve, mësimdhënies apo çdo komponenti tjetër qëi shërben përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. <i>Evidenca 2 "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i>

	<i>Evidenca nr 3 "Plani i masave të KUB për vitin akademik 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr 50 "Plani Vjetori veprimtarive Departamenti i Drejtësisë Viti Akademik 2023-2024"</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni ka mekanizma të informimit të studentëve dhe personelit akademik mbi proceset e sigurimit të cilësisë, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të tyre mbi përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Informimi i studentëve dhe stafit akademik mbi proceset e sigurimit të cilësisë mundësohet së pari nëpërmjet përfshirjes dhe përfaqësimit të tyre në strukturat institucionale të sigurimit të cilësisë si, NJSBC apo Senati Akademik. Në përbërjen e NJSBC aktualisht ka anëtarë të personelit akademik të FDSHP. Përbërja e NJSBC nga personeli akademik dhe përfaqësues të studentëve, jo vetëm mundëson një bashkëpunim më të mirë të kësaj njësie me personelin akademik dhe studentët, por ndikon në shkallën e marrjes së informacionit dhe rritjes së ndërgjegjësimit mbi proceset e sigurimit të cilësisë. Forma të tjera të informimit janë, raportimet deri në nivelin e njësisë bazë mbi konkluzionet dhe rekomandimet nxjerra nga proceset e vlerësimit të cilësisë, publikimi i raporteve dhe informacioneve në faqen zyrtare të institucionit etj. <i>Evidenca 13.1 "Anëtarët e Senatit Akademik Model Vendimi"</i> <i>Evidenca nr. 116 "Tabelat përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë penale" fq 11-23, tabela 24"</i> https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/			
Konkluzione	<i>KUB i pasqyron politikat, strategjitë dhe procedurat që zbatohen në kuadrin e e procesit të sigurimit të brendshëm të cilësisë, në planet strategjike të zhvillimit, politikat e sigurimit të cilësisë dhe raportet vjetore të NJSBC. Bazuar në parimin e transparencës, ato bëhen publike nëpërmjet komunikimeve zyrtare apo publikimit në faqen web të institucionit.</i> <i>Procedurat mbi njoftimet dhe publikimet e materialeve që i referohen veprimtarisë institucionale, marrin në konsideratë rregullat e etikës akademike dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</i> <i>Institucioni vlerëson efektivitetin e veprimtarive të ndërmara në kuadër të vlerësimit të cilësisë të programit të studimit si dhe mer masat për përmirësimin e cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Masteri Shkencave në “E Drejtë penale”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. KUB ka hartuar dhe zbaton një bazë të gjerë rregullatore, e përbërë nga një sërë rregulloresh në nivel institucional si dhe rregullore të posaçme që i referohen aspekteve të përparimit akademik, deri në diplomimim e studentëve, si dhe gjithë komponentëve të jetës akademike në institucion;
2. Mjediset në funksion të procesit të mësimdhënies janë të paisura me mjetet dhe paisjet e nevojshme teknologjike dhe didaktike për plotësimin e kërkesave të formimit të studentëve në përputhje me objektivat formues të programit Msc në “E Drejtë Penale”;
3. Vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucione homologe ndërkombëtare dhe kombëtare si dhe marrëdhëniet e partneritetit me aktorë të rëndësishëm të biznesit, mundëson rritjen e cilësisë së mësimdhënies, lidhjen me tregun e punës si dhe shërbime më cilësore për studentët;
4. Personeli akademik që mbulon këtë program studimi përmbush standartet e kërkuara ligjore në lidhje me nivelin e kualifikimit akademik si dhe përputhjen me kompetencave me natyrën dhe përmbajtjen e programit;
5. Vazhdimësia e të njëjtit personel akademik në Programin e studimit Master Shkencor në “E Drejtë Penale”, si dhe kualifikimi e ekspertiza e tyre, është një tregues pozitiv që reflekton jo vetëm përvojë në fushën e së drejtës, por edhe qëndrueshmëri ndër vite në procesin mësimdhënës;
6. KUB nxit dhe respekton lirinë akademike si një nga parimet më të rëndësishëm në veprimtarinë e personelit akademik;

7. Në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet e tij rregullatore, institucioni ka procedura, si dhe ka bërë funksionale struktura, që së bashku, mundësojnë një sistem efikas të informimit, këshillimit dhe mbështetjes së studentëve;
8. KUB ka krijuar mekanizmat e nevojshëm për të mundësuar angazhimin e studentëve në jetën universitare, si dhe për të tërhequr mendimin e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në organet vendimmarrëse;
9. Nëpërmjet politikave të tij, institucioni ka mundësuar angazhimin dhe ekspertizën e huaj në proceset që i referohen sigurimit të cilësisë si dhe mundëson që ky angazhim të jetë konkret dhe me rezultate positive;

b. Pika të dobta:

1. Ndonëse në tërësinë e saj, kurikula e programit Msc në “E drejtë Penale” synon të japë njohuri në fushën penale, disa lëndë në përmbajtjen e kurikulës nuk përputhen plotësisht me profilin penal të këtij programi studimi si dhe objektivat e programit të studimit për formimin e ekspertëve dhe specialistëve në fushën e së drejtës penale; (*Standarti II.1. kriteri 2*)
2. Ngarkesa mësimore për këtë program studimi, nuk është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë në përputhje me rregullimet e VKM Nr. 418, datë 10.05.2017, ku parashikohet se: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi”; (*Standarti IV.1, Kriteri 2*)

Rekomandime

1. GVJ sugjeron të rishikohet kurrikula e programit me qëllim të zëvendësimit të disa lëndëve që nuk përshtaten ngushtësisht me fushën penale dhe përfshirjes në kurikul të lëndëve me profil të mirëfilltë penal, me qëllim përshtatjen me profilin dhe objektivat e këtij programi studimi;
2. GVJ rekomandon që në shpërndarjen e ngarkesës mësimore të rishikohet raporti midis PAE dhe PAK në këtë program studimi, në mënyrë që ngarkesa e realizuar nga PAE i angazhuar në procesin e mësimdhënies të përputhet me kriteret ligjore që i referohen mbulimit të ngarkesës mësimore;
3. GVJ sugjeron që Institucioni të vërë sa më shpejt në përdorim platformën dixhitale e cila do të mundësojë dixhitalizimin e administrimit të të dhënave dhe një ndërveprim më efikas midis studentëve, strukturave administrative dhe atyre akademike;

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences on "Criminal Law"

a. Strengths and affirmations:

1. KUB has drawn up and implements a broad regulatory base, consisting of a series of regulations at the institutional level as well as special regulations that govern all aspects of academic progress until graduation of students, as well as all components of academic life in the institution;
2. The environments in function of the teaching process are equipped with the necessary technological and didactic tools and equipment to meet the training requirements of students in accordance with the formative objectives of the Master program in "Criminal Justice";
3. The establishment of cooperation relations with international and national counterpart institutions, as well as partnership relations with important business actors, enables the increase in the quality of teaching, the connection with the labor market, as well as better services for students;
4. The academic staff covering this study program fulfills the required legal standards regarding the level of academic qualification as well as the compatibility of competencies with the nature and content of the program;
5. The continuity of the same academic staff in the Master of Science in "Criminal Law" study program, as well as their qualification and expertise, is a positive indicator that reflects not only experience in the field of law, but also stability over the years in the teaching process;
6. KUB promotes and respects academic freedom as one of the most important principles in the activity of academic staff;
7. In accordance with the legal provisions and its regulatory acts, the institution has procedures, as well as functional structures, which together enable an efficient system of information, counseling, and student support;
8. KUB has created the necessary mechanisms to enable the engagement of students in university life, as well as to attract their opinion through participation and representation in decision-making bodies;
9. Through its policies, the institution has enabled foreign engagement and expertise in the processes that refer to quality assurance, as well as enabling this engagement to be concrete and with positive results;

b. Weaknesses:

1. Although in its entirety, the curriculum of the Master of Science program in "Criminal Law" aims to provide knowledge in the criminal field, some subjects in the content of the curriculum do not fully match the criminal profile of this study program as well as the objectives of the study program for formation of experts and specialists in the field of criminal law; (*Standard II.1. criterion 2*)

2. The teaching load for this study program has not been met by more than 70% of the full-time academic staff in accordance with the regulations of VKM No. 418, dated 10.05.2017, which stipulates that: "Full-time academic staff must cover no less than 70% of the teaching load for each study program"; (*Standard IV.1, Criterion 2*)

Recommendation

1. GVJ suggests revising the curriculum of the program to replace some subjects that do not fit closely with the criminal field and to include in the curriculum subjects with a genuine criminal profile, in order to adapt to the profile and objectives of this study program;
2. GVJ recommends that in the distribution of the teaching load, the ratio between the effective academic staff (PAE) and the part-time academic staff (PAK) in this study program should be reviewed, so that the load carried out by the PAE engaged in the teaching process complies with the legal criteria referred to covering the teaching load;
3. GVJ suggests that the Institution put into use as soon as possible the digital platform which will enable the digitization of data administration and a more efficient interaction between students, administrative and academic structures;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

